| Grekan                                    | 2,689                              | V      | 3,411                                       | V      |
| Gorre                                     | 2,324                              | V      | 2,777                                       | V      |
| Fier                                      | 2,505                              | V      | 3,010                                       | V      |
| Frasher                                   |                                    |        | 2,175                                       | IV     |
| Selenice                                  | 2,834                              | V      | 3,301                                       | V      |
| Average Winkler Indeks                    | 2,510                              | V      | 2,927                                       | V      |
| KLASIFIKIMI PERFAQESUES I ZONES VRESHTARE |                                    |        |                                             | 5      |

### Zona Mesdhetare Fushore jugore

#### Qytetet Perfshirese

|          |
|----------|
| Vlore    |
| Himare   |
| Delvine  |
| Sarande  |
| Finiq    |
| Konispol |

| Stacionet Perfaqesuese                    | Rezultatet e Analizes se 20 viteve |        | Rezultatet e Analizes te Vitit me te Nxehte |          |
|-------------------------------------------|------------------------------------|--------|---------------------------------------------|----------|
|                                           | Winkler                            | Rajoni | Winkler                                     | Rajoni   |
| Rade                                      | 2,539                              | V      | 2,929                                       | V        |
| Orikum                                    | 2,360                              | V      | 2,723                                       | V        |
| Himare                                    | 2,197                              | IV     | 2,581                                       | V        |
| Borsh                                     | 2,472                              | V      | 2,855                                       | V        |
| Cuke                                      | 2,298                              | V      | 2,675                                       | V        |
| Xarre                                     | 1,898                              | III    | 2,234                                       | V        |
| Average Winkler Indeks                    | <b>2,294</b>                       | V      | <b>2,666</b>                                | V        |
| KLASIFIKIMI PERFAQESUES I ZONES VRESHTARE |                                    |        |                                             | <b>5</b> |

### Zona Mesdhetare Kodrinore Veriore

#### Qytetet Perfshirese

|           |
|-----------|
| Malesi e  |
| Madhe     |
| Shkoder   |
| Vau Dejes |
| Puke      |
| Lezhe     |
| Mirdite   |
| Mat       |
| Klos      |

| Stacionet Perfaqesuese                    | Rezultatet e Analizes se 20 viteve |        | Rezultatet e Analizes te Vitit me te Nxehte |          |
|-------------------------------------------|------------------------------------|--------|---------------------------------------------|----------|
|                                           | Winkler                            | Rajoni | Winkler                                     | Rajoni   |
| Gojan I vogel                             | 2,194                              | IV     | 2,891                                       | V        |
| Ura e Shtrenjte                           | 2,301                              | V      | 2,725                                       | V        |
| Korthpule                                 | 2,142                              | IV     | 2,614                                       | V        |
| Simon                                     | 2,067                              | IV     | 2,492                                       | V        |
| Klos                                      | 2,170                              | IV     | 2,638                                       | V        |
| Average Winkler Indeks                    | <b>2,175</b>                       | IV     | <b>2,672</b>                                | V        |
| KLASIFIKIMI PERFAQESUES I ZONES VRESHTARE |                                    |        |                                             | <b>5</b> |

### Zona Mesdhetare Kodrinore Qendrore

#### Qytetet Perfshirese

|         |
|---------|
| Kruje   |
| Tirane  |
| Elbasan |
| Cerrik  |

|         |
|---------|
| Gramsh  |
| Kucove  |
| Berat   |
| Polican |
| Kelcyre |

| Stacionet Perfaqesuese                    | Rezultatet e Analizes se 20 viteve |        | Rezultatet e Analizes te Vitit me te Nxehte |          |
|-------------------------------------------|------------------------------------|--------|---------------------------------------------|----------|
|                                           | Winkler                            | Rajoni | Winkler                                     | Rajoni   |
| Kruje                                     | 2,152                              | IV     | 2,530                                       | V        |
| Dajt                                      | 1,796                              | III    | 2,190                                       | IV       |
| Daia                                      | 2,175                              | IV     | 2,769                                       | V        |
| Petrelle                                  | 2,446                              | V      | 2,842                                       | V        |
| Vrap                                      | 2,097                              | IV     | 2,577                                       | V        |
| Gramsh                                    | 2,254                              | V      | 2,720                                       | V        |
| Sinje                                     | 2,039                              | IV     | 2,565                                       | V        |
| Terpan                                    | 2,021                              | IV     | 2,453                                       | V        |
| Average Winkler Indeks                    | <b>2,123</b>                       | IV     | <b>2,581</b>                                | V        |
| KLASIFIKIMI PERFAQESUES I ZONES VRESHTARE |                                    |        |                                             | <b>5</b> |

#### Zona Mesdhetare Kodrinore Juglindore

##### Qytetet Perfshirese

|             |
|-------------|
| Skrapar     |
| Kelcyre     |
| Permet      |
| Gjirokaster |
| Dropull     |

| Stacionet Perfaqesuese                    | Rezultatet e Analizes se 20 viteve |        | Rezultatet e Analizes te Vitit me te Nxehte |          |
|-------------------------------------------|------------------------------------|--------|---------------------------------------------|----------|
|                                           | Winkler                            | Rajoni | Winkler                                     | Rajoni   |
| Polican                                   | 1,341                              | I      | 1,683                                       | III      |
| Corovode                                  | 1,607                              | II     | 1,978                                       | IV       |
| Potom                                     | 2,013                              | IV     | 2,435                                       | V        |
| Kelcyre                                   | 2,410                              | V      | 2,874                                       | V        |
| Permet                                    | 2,156                              | IV     | 2,510                                       | V        |
| Llongo                                    | 2,698                              | V      | 3,127                                       | V        |
| Average Winkler Indeks                    | <b>2,038</b>                       | IV     | <b>2,435</b>                                | V        |
| KLASIFIKIMI PERFAQESUES I ZONES VRESHTARE |                                    |        |                                             | <b>5</b> |

#### Zona Mesdhetare Kodrinore Jugore

##### Qytetet Perfshirese

|             |
|-------------|
| Mallakaster |
| Memaliaj    |
| Selenice    |
| Tepelene    |
| Gjirokaster |
| Himare      |
| Delvine     |

|                                           |         |                                    |                                             |        |
|-------------------------------------------|---------|------------------------------------|---------------------------------------------|--------|
| Finiq                                     |         |                                    |                                             |        |
| Konispol                                  |         |                                    |                                             |        |
|                                           |         | Rezultatet e Analizes se 20 viteve | Rezultatet e Analizes te Vitit me te Nxehte |        |
| Stacionet Perfaqesuese                    | Winkler | Rajoni                             | Winkler                                     | Rajoni |
| Ballsh                                    | 1,809   | III                                | 2,290                                       | V      |
| Tepelene                                  | 2,561   | V                                  | 2,962                                       | V      |
| Brataj                                    | 2,367   | V                                  | 2,819                                       | V      |
| Nivice                                    | 1,921   | III                                | 2,329                                       | V      |
| Kuc                                       | 2,083   | IV                                 | 2,496                                       | V      |
| Muzine                                    | 2,431   | V                                  | 2,857                                       | V      |
| Cerkovice                                 | 2,499   | V                                  | 2,968                                       | V      |
| Konispol                                  | 2,488   | V                                  | 2,914                                       | V      |
| Average Winkler Indeks                    | 2,270   | V                                  | 2,704                                       | V      |
| KLASIFIKIMI PERFAQESUES I ZONES VRESHTARE |         |                                    |                                             | 5      |
| Zona Mesdhetare Paramalore Veriore        |         |                                    |                                             |        |
| Qytetet Perfshirese                       |         |                                    |                                             |        |
| Tropoje                                   |         |                                    |                                             |        |
| Krume                                     |         |                                    |                                             |        |
| Fushe Arrez                               |         |                                    |                                             |        |
| Puke                                      |         |                                    |                                             |        |
| Kukes                                     |         |                                    |                                             |        |
| Diber                                     |         |                                    |                                             |        |
| Mirdite                                   |         |                                    |                                             |        |
| Bulqize                                   |         |                                    |                                             |        |
| Klos                                      |         |                                    |                                             |        |
| Tirane                                    |         |                                    |                                             |        |
| Elbasan                                   |         |                                    |                                             |        |
|                                           |         | Rezultatet e Analizes se 20 viteve | Rezultatet e Analizes te Vitit me te Nxehte |        |
| Stacionet Perfaqesuese                    | Winkler | Rajoni                             | Winkler                                     | Rajoni |
| Lekbibaj                                  | 1,796   | III                                | 2,351                                       | V      |
| Krume                                     | 1,931   | III                                | 2,367                                       | V      |
| Puke                                      | 1,463   | II                                 | 1,829                                       | III    |
| Kukes                                     | 1,959   | IV                                 | 2,375                                       | V      |
| Skavice                                   | 1,419   | II                                 | 1,837                                       | III    |
| Zall Kalis                                | 1,737   | III                                | 2,169                                       | IV     |
| Kurbnesh                                  | 1,511   | II                                 | 1,966                                       | IV     |
| Deje Macukull                             | 1,382   | I                                  | 1,866                                       | III    |
| Shupenze                                  | 1,754   | III                                | 2,208                                       | IV     |
| Shengjergj                                | 1,302   | I                                  | 1,688                                       | III    |
| Shmil                                     | 1,553   | II                                 | 1,978                                       | IV     |
| Average Winkler Indeks                    | 1,619   | II                                 | 2,058                                       | IV     |
| KLASIFIKIMI PERFAQESUES I ZONES VRESHTARE |         |                                    |                                             | 4      |
| Zona Mesdhetare Paramalore Jugore         |         |                                    |                                             |        |
| Qytetet Perfshirese                       |         |                                    |                                             |        |

|          |
|----------|
| Prrenjas |
| Pogradec |
| Maliq    |
| Pustec   |
| Devoll   |
| Korce    |
| Erseke   |
| Permet   |
| Skrapar  |

| Stacionet Perfaqesuese                    | Rezultatet e Analizes se 20 viteve |        | Rezultatet e Analizes te Vitit me te Nxehte |          |
|-------------------------------------------|------------------------------------|--------|---------------------------------------------|----------|
|                                           | Winkler                            | Rajoni | Winkler                                     | Rajoni   |
| Prrenjash                                 | 1,767                              | III    | 2,211                                       | IV       |
| Pogradec                                  | 1,383                              | I      | 1,793                                       | III      |
| Sheqeras                                  | 1,496                              | II     | 1,965                                       | IV       |
| Bilisht                                   | 1,599                              | II     | 2,285                                       | V        |
| Korce                                     | 1,442                              | II     | 1,914                                       | III      |
| Erseke                                    | 1,255                              | I      | 1,656                                       | II       |
| Barmash                                   | 1,344                              | I      | 1,760                                       | III      |
| Average Winkler Indeks                    | <b>1,470</b>                       | II     | <b>1,941</b>                                | III      |
| KLASIFIKIMI PERFAQESUES I ZONES VRESHTARE |                                    |        |                                             | <b>3</b> |

#### Zona Mesdhetare Malore Veriore

##### Qytetet Perfshirese

|                |
|----------------|
| Malesi e Madhe |
| Shkoder        |
| Tropoje        |
| Vau Dejes      |

| Stacionet Perfaqesuese                    | Rezultatet e Analizes se 20 viteve |        | Rezultatet e Analizes te Vitit me te Nxehte |          |
|-------------------------------------------|------------------------------------|--------|---------------------------------------------|----------|
|                                           | Winkler                            | Rajoni | Winkler                                     | Rajoni   |
| Vermosh                                   | 875                                | I      | 1,275                                       | I        |
| Rapshe                                    | 1,667                              | II     | 2,113                                       | IV       |
| Boge                                      | 1,475                              | II     | 1,989                                       | IV       |
| Vrith                                     | 1,339                              | I      | 1,782                                       | III      |
| Kukaj                                     | 1,783                              | III    | 2,285                                       | V        |
| Dragobi                                   | 1,617                              | II     | 2,026                                       | IV       |
| Average Winkler Indeks                    | <b>1,459</b>                       | II     | <b>1,912</b>                                | III      |
| KLASIFIKIMI PERFAQESUES I ZONES VRESHTARE |                                    |        |                                             | <b>3</b> |

#### Zona Mesdhetare Malore Lindore

##### Qytetet Perfshirese

|             |
|-------------|
| Krume       |
| Fushe Arrez |
| Mirdite     |
| Kukes       |
| Diber       |

### Bulqize

#### Librazhd

| Stacionet Perfaqesuese                    | Rezultatet e Analizes se 20 viteve |        | Rezultatet e Analizes te Vitit me te Nxehte |          |
|-------------------------------------------|------------------------------------|--------|---------------------------------------------|----------|
|                                           | Winkler                            | Rajoni | Winkler                                     | Rajoni   |
| Iballe                                    | 1,336                              | I      | 1,794                                       | III      |
| Domgjon                                   | 1,618                              | II     | 2,095                                       | IV       |
| Shishtavec                                | 1,214                              | I      | 1,596                                       | II       |
| Bushtrice                                 | 1,861                              | III    | 2,405                                       | V        |
| Kurbnesh                                  | 1,205                              | I      | 1,631                                       | II       |
| Peshkopi                                  | 1,633                              | II     | 2,101                                       | IV       |
| Selishte                                  | 1,485                              | II     | 1,978                                       | IV       |
| Bulqize                                   | 1,582                              | II     | 2,065                                       | IV       |
| Klenje                                    | 1,106                              | I      | 1,520                                       | II       |
| Average Winkler Indeks                    | <b>1,449</b>                       | II     | <b>1,910</b>                                | III      |
| KLASIFIKIMI PERFAQESUES I ZONES VRESHTARE |                                    |        |                                             | <b>3</b> |

#### Zona Mesdhetare Malore Juglindore

##### Qytetet Perfshirese

|  |          |
|--|----------|
|  | Prrenjas |
|  | Pogradec |
|  | Maliq    |
|  | Pustec   |
|  | Diber    |
|  | Elbasan  |
|  | Gramsh   |
|  | Skrapar  |
|  | Korce    |
|  | Devoll   |
|  | Kolonje  |

| Stacionet Perfaqesuese                    | Rezultatet e Analizes se 20 viteve |        | Rezultatet e Analizes te Vitit me te Nxehte |          |
|-------------------------------------------|------------------------------------|--------|---------------------------------------------|----------|
|                                           | Winkler                            | Rajoni | Winkler                                     | Rajoni   |
| Dardhe                                    | 1,547                              | II     | 2,014                                       | IV       |
| Voskopoje                                 | 973                                | I      | 1,405                                       | II       |
| Korite                                    | 1,540                              | II     | 1,956                                       | IV       |
| Grabove e Siperme                         | 1,231                              | I      | 1,754                                       | III      |
| Liqenas                                   | 1,584                              | II     | 2,044                                       | IV       |
| Bishnice                                  | 1359.54                            | I      | 1,839                                       | III      |
| Stravaj                                   | 1,506                              | II     | 1,967                                       | IV       |
| Average Winkler Indeks                    | <b>1,391</b>                       | II     | <b>1,854</b>                                | III      |
| KLASIFIKIMI PERFAQESUES I ZONES VRESHTARE |                                    |        |                                             | <b>3</b> |

#### Zona Mesdhetare Malore Jugore

##### Qytetet Perfshirese

|  |          |
|--|----------|
|  | Dropull  |
|  | Permet   |
|  | Libohove |


Kelcyre

Tepelene

Himare

Delvine

| Stacionet Perfaqesuese                    | Rezultatet e Analizes se 20 viteve |        | Rezultatet e Analizes te Vitit me te Nxehte |          |
|-------------------------------------------|------------------------------------|--------|---------------------------------------------|----------|
|                                           | Winkler                            | Rajoni | Winkler                                     | Rajoni   |
| Dardhe                                    | 1,547                              | II     | 2,014                                       | IV       |
| Voskopoje                                 | 973                                | I      | 1,405                                       | II       |
| Korite                                    | 1,540                              | II     | 1,956                                       | IV       |
| Grabove e Siperme                         | 1,231                              | I      | 1,754                                       | III      |
| Liqenas                                   | 1,584                              | II     | 2,044                                       | IV       |
| Bishnice                                  | 1359.54                            | I      | 1,839                                       | III      |
| Stravaj                                   | 1,506                              | II     | 1,967                                       | IV       |
| Average Winkler Indeks                    | <b>1,391</b>                       | II     | <b>1,854</b>                                | III      |
| KLASIFIKIMI PERFAQESUES I ZONES VRESHTARE |                                    |        |                                             | <b>3</b> |



|                                                                                  |                |                                                             |       |           |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|
|  | Document Name: | Raport: Percaktimi i Zonave te Prodhimit te Rushit per Vere | Page: | 20 of 160 |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|

### 3.2 SHPERNDARJA GJEHAPSINORE E TREGUESVE TE PERBERJES SE TOKES

Kultivimi i vreshtit, si një nga degët më të rëndësishme të bujqësisë, varet ngushtë nga kushtet mjedisore, veçanërisht nga lloji dhe cilësia e tokës. Toka përbën bazën mbi të cilën zhvillohet gjithë sistemi jetësor i hardhisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin e rrënjëve, përthithjen e ushqyesve, qëndrueshmërinë e bimës dhe cilësinë përfundimtare të frutit. Marrëdhënia midis vreshtit dhe tokës është aq e thellë, sa që në shumë rajone të botës tiparet e verës përshkruhen sipas “terroirit” – një kombinim unik i tokës, klimës dhe praktikave bujqësore që i japin rrushit identitetin e tij të veçantë. Një tokë e përshtatshme për vresht duhet të jetë e shkrifët, me kullim të mirë, të mos mbajë ujë në sipërfaqe, dhe të ketë përmbajtje të moderuar lëndësh ushqyese, pasi një teprice ushqimi çon në rritje vegjetative të tepërt dhe ul cilësinë e rrushit.

#### ***Tokat gëlqerore***

Këto toka karakterizohen nga përmbajtje e lartë e karbonatit të kalciumit dhe një strukturë të thatë, por të qëndrueshme. Ato kanë kullim shumë të mirë dhe ruajnë nxehtësinë gjatë ditës, duke mundësuar pjekje të ngadaltë dhe të qëndrueshme të rrushit. Rrushi i rritur në toka gëlqerore jep verëra me aciditet të ekuilibruar, aromë të theksuar dhe jetëgjatësi të madhe

#### ***Tokat argjilore***

Tokat argjilore kanë strukturë të imët dhe janë të pasura me lëndë ushqyese, por me kullim të dobët. Ato mbajnë shumë lagështi dhe ngrohen ngadalë, çka ndikon në pjekje të vonuar dhe përqendrim të lartë të sheqerit në rrush. Verërat që burojnë nga këto toka kanë trup të plotë, strukturë të dendur dhe aromë intensive

#### ***Tokat ranore***

Tokat ranore janë të lehta, me ajrosje dhe kullim shumë të mirë, por me përmbajtje të ulët ushqyesish. Ato ngrohen shpejt në pranverë dhe krijojnë kushte të favorshme për fillim të hershëm të vegjetacionit. Rrushi i kultivuar në këto toka prodhon verëra të lehta, me trup të butë dhe aromë delikate, të përshtatshme për konsum të menjëhershëm.

#### ***Tokat me gurë dhe zhavorr***

Të njohura për kullimin e shkëlqyer dhe aftësinë për të ruajtur nxehtësinë, këto toka i detyrojnë rrënjët të depërtojnë thellë në kërkim të ujit dhe ushqyesve, duke forcuar strukturën e bimës. Verërat që rrjedhin nga këto toka kanë aromë të pasur, ekuilibër të mirë acidik dhe shije minerale.

#### ***Tokat vullkanike***

Të pasura me minerale si magnez, hekur, sqfur dhe silic, tokat vullkanike u japin rrushit një karakter të fortë mineral dhe aromë të veçantë.


Rrushi nga këto toka përdoret për verëra me strukturë të fortë, trup të plotë dhe nuanca komplekse aromatike

Analiza hapësinore e treguesve të tokës tregoi një larmë të gjerë në vetitë e tokës në zonën e studimit, gjë që lidhet me karakteristikat e tokës dhe faktorët e formimit të saj, si topografia, materiali dhe kushtet klimatike. Këta tregues ndryshojnë dukshëm nga pjesët e sipërme drejt pjerrësive të ulëta perëndimore, dhe kjo diferencë është veçanërisht e theksuar në thellësinë e tokës, teksturën dhe vlerat e pH-së.

Sipas treguesve të tokës që lidhen me kriteret ekologjike për nevojat e vreshtarisë, rezultatet e paraqitura për teksturën e tokës tregojnë se tokat argjilore janë dominuese, edhe pse nuk janë të preferuara për kultivimin e hardhisë. Nga ana tjetër, tokat ranore–argjilore (loamy soils), të cilat kanë veti tipike të përshtatshme për vreshta, janë të kufizuara në sipërfaqe dhe shpërndarje.

Analiza gjeohapsinore ne kombinim me treguesit te tokes nga 1000 sondimet ne terren dhe te dhenat e perpunuara te QTTB Fushe Kruje vleresoi si kategorizim S1 (shume e pershtatshme ) (89%)

Ne Harten e meposhtme jepet zonimi i zones se studimit ne lidhje me indeksimin e treguesve te tokes per vreshtari.



**Figure 13 : Hartat e Treguesve te Tokes -Vreshtari:**

### 3.3 SHPERNDARJA GJEHAPSINORE E KARAKTERISTIKAVE TOPOGRAFIKE


Vlera e pjerrësisë ka dy ndikime kritike:

- (1) një ndikim pozitiv, nëpërmjet ekspozimit ndaj rrezatimit diellor, dhe
- (2) një ndikim kufizues, kur terreni bëhet shumë i pjerrët, duke vështirësuar mekanizimin (Stanchi et al., 2013).


Në zonën e studimit u përcaktuan tre klasa të pjerrësisë, në përputhje me kriteret e qëndrueshmërisë ekonomike për vreshtari (Chen, 2011; Acharya dhe Yang, 2015), siç paraqiten në Tabelën 6.

Rezultatet treguan se rreth 25% e zonës së studimit rreth 7,200 km<sup>2</sup> (718,700 ha) ishte shumë e përshtatshme (S1) dhe (S2) e përshtatshme, ku terracimi është i kufizuar dhe mekanizimi mund të zbatohet gjerësisht.


Nga ana tjetër zonat me lartësi mbi 1000m të klasifikuara si të papërshtatshme referuar tabelës 6 përbejnë 50% të sipërfaqes së territorit.




**Figure 14 :** Hartat e Treguesve Topografike -Vreshtari: (a) Harta e indeksit të Lartësisë mbi Nivelin e detit ; (b) Harta e Indeksit të Pjerrësisë



**Figure 15 :**Harta e Indeksit te Lartesisë mbi Nivelin e Detin (m)



**Figure 16 : Harta e Indeksit te Pjerresive %**



**Figure 17:** Harta e Pershtatshmerise Topografike

#### 4. ZONAT E VRESHTAVE TE VERES ME KARAKTERISTIKA HOMOGENE NE SHQIPERI

Në këtë studim, vlerësimi i përshtatshmërisë për vreshtari (Figura 18) tregoi se rreth 7334km<sup>2</sup> (25.6%) e zonës së studimit është shumë e përshtatshme (S1) për kultivimin e vreshtave dhe mund të ndahet në tre nënklasa: A, B dhe C.

Këto zona karakterizohen nga kushte optimale klimatike, pedologjike dhe topografike.

Rreth 14309 km<sup>2</sup> (49.94%) e zonës së studimit u vlerësua si e përshtatshme (S2), por me vlerë më të ulët krahasuar me rajonin e mëparshëm. Ndërsa klasa moderuarisht e përshtatshme (S3) zinte 7007 km<sup>2</sup> (24.5%) të zonës së studimit.

Zona e fundit (N1) ishte shumë e kufizuar, me një sipërfaqe prej rreth 0.01%

Ky studim ofron një model vlerësimi dhe njohuri të reja për zgjedhjen e vendeve të përshtatshme për vreshtari ekonomike, të ndërtuara mbi qasje GIS (Sistemi Informativ Gjeografik) dhe vlerësim shumëkriterial (MCE), duke marrë parasysh kushtet klimatike, pedologjike dhe topografike.

Kjo qasje do të jetë e dobishme për fermerët, duke ndihmuar në zhvillimin e prodhimit, rritjen e efikasitetit, dhe largimin nga zonat që kërkojnë procese të kultivimit intensiv.

Për pasojë, kuptimi i ndryshueshmërisë hapësinore të këtyre faktorëve siguron bazën për një karakterizim të qëndrueshëm dhe të vlefshëm të çdo rajoni vreshtarie.


Variablat kryesore mjedisore, siç u treguan në analizat e mëparshme, luajnë një rol vendimtar në përshtatshmërinë e tokës për kultivimin e vreshtave.

Faktori i lartësisë ka një ndikim të rëndësishëm, pasi ndikon si në parametrat klimatikë, ashtu edhe në karakteristikat pedologjike të tokës.

Në përgjithësi, zonat shumë të përshtatshme (S1) janë të përqendruara në qendrore te zones se studimit ku klima dhe toka janë të favorshme dhe nuk shfaqin kufizime të dukshme.

Në të kundërt, pjesa më e ulët (pra, zona perëndimore e studimit dhe ajo jugore) karakterizohet nga klimë më e pafavorshme dhe pjellori fizike e kimike më e dobët e tokës; për këtë arsye, prodhimi i rrushit është i mundur vetëm nëse zbatohet ujitja dhe shoqërohet me plehërim shtesë.

Për më tepër, përvojat pozitive të fermerëve në zonat S1 dhe S2 në pjesën qendore të zonës së studimit konfirmojnë rezultatet e këtij kërkimi, duke treguar se prodhimi cilësor i rrushit dhe verës mund të arrihet në kushte të tilla specifike mjedisore.




**Figure 18.** Harta e Pershtatshmerise per Vreshtari : (a) harta e pershtatshmerise klimatike, (b) harta e pershtatshmerise topografike, (c) harta e pershtatshmerise se treguesve te tokes

## 5. STRUKTURA VARIETORE DHE KLONEVE TE VRESHTAVE NE TERRITORIN E SHQIPERISE SI DHE KARAKTERISTIKAT FIZIKO-KIMIKE DHE NDJESORE TE RRUSHIT DHE VERERAVE TE PRODHUARA

### 5.1 GJENDJA E VRESHTARISE

#### 5.1.1 SITUATA E VRESHTARISE NE SHQIPERI

Kultivimi i vreshtarisë është një nga aktivitetet më tradicionale nga jugu e deri në veri të vendit që daton mijëra vjet më parë. Pas ndryshimeve politike që ndodhën në vend në vitet 90, që u shoqërua me rënien e plotë e sistemit të bujqësisë kolektive dhe fragmentim të bujqësisë shqiptare, vreshtaria pësoi shumë dëmtime. Sipërfaqja e mbjellë ra ndjeshëm në vitet '90 (nga mbi 20 mijë ha në vitet '80 në më pak se gjysmën e tyre), shumë vreshta u shpërbënë, bashkë me keto ndryshoi edhe funksionimi dhe organizimi i linjave përpunuese të rrushit. Pas reformës kultivuesit privatë nisën të mbjellin vreshta të vegjël familjarë, por performanca produktive e hardhive të reja të mbjella në vitet e para të tranzicionit u karakterizua nga disa kufizime, të tilla si madhësia e vogël e fermës dhe efikasiteti i ulët në përdorimin e inputeve. Që nga viti 2000, sipërfaqja e kultivuar dhe prodhimi i rrushit nga vreshtat është rritur, duke e kthyer tashmë në një biznes të prodhimit të verës në rritje që dominon në të gjitha zonat e Shqipërisë. Në vitin 2022 krahasuar me vitin 2000, prodhimi i rrushit të vreshtave është rritur 3.6 herë (nga një bazë e ulët prej 35,522 tonësh në vitin 2000 në 128,356 tonë në vitin 2022).





**Figura 20.** Sipërfaqja me vreshta në Shqipëri sipas INSTAT .

Sipërfaqja totale me vreshta në vitin 2024 është 9840 ha, me një rënie rreth 11 % krahasuar me vitin 2021, i cili rezulton viti me sipërfaqen më të madhe pas vitit 1990 me rreth 11057 ha.(INSTAT). Qarku me sipërfaqen më të madhe rezulton ai i Fierit, i ndjekur nga qarku i Elbasanit, Beratit dhe Korçës, ndërsa qarku me sipërfaqen më të vogël rezulton të jetë ai i Kukësit.

Rënia e sipërfaqes së vreshtave është shoqëruar me uljen e prodhimit, i cila nuk ka ndjekur të njëjtin ritëm. Në dy vitet e fundit (2023;2024), rënia e prodhimit arriti në rreth 16% krahasuar me vitet 2021 dhe 2022 që rezultojnë dhe vitet me prodhimin më të madh. Kjo rënie e prodhimit është shkaktuar edhe nga

ndikimi i ndryshimeve të klimës, e cila po ndikon në uljen e prodhimit dhe cilësinë e tij në shumë vende të rajonit dhe të botës.

Rreth 65 % e prodhimit të rrushit nga vreshtat në Shqipëri prodhohet në qarkun e Fierit (27.7%), Elbasanit (16.1%), Beratit (10.9 %) dhe Durrësit (10.3%). Qarku me prodhimin më të ulët është ai i Kukësit (rreth 0.7%).



Kultivimi i rrushit në vendin tonë bëhet në mënyrë tipike në dy lloje kultivimi: me vreshta dhe pjergulla. Rrushi i pjergullave kultivohet kryesisht për nevojat vetjake (i freskët ose i përpunuar në formën e verës dhe pijeve alkoolike).

Prodhimi nga pjergullat në vitin 2024 ishte 74942 ton, edhe ky me një rënie rreth 10% krahasuar me vitin 2021, ku prodhuesit më të mëdhenj janë qaqet e Elbasanit (16.7%), Vlorës (14. 9%), Fierit (12.1%), Beratit (10%), Tiranë (9.8%), Dibër (8.1%), duke përfunduar me qarkun e Gjirokastrës (me vetëm 0.95%), sipas INSTAT.

Sipas raportimit të studimeve të mëparshme (sipas Sustainable Development of rural areas in Albania –Sector Analyses – 2017.2192.7- 001.00, plani per IPARD 2021-2027, raporti maj 2021), pak më shumë se një në dhjetë fermerë (35,666 fermerë nga 320,000 ferma në Shqipëri) kanë vreshta. 26,607 fermerë kanë më pak se 0.30 ha vreshta, 8,277 fermerë midis 0.31-0.50 ha. Fermerët me vreshta më të mëdha se 0.50 ha janë 2,850 me një sipërfaqe përkatëse vreshtash prej 3,217.00 ha, numri i fermave që kanë më shumë se 1.0 ha vreshta është 749 me një sipërfaqe përkatëse vreshtash prej 1,453.00 ha, dhe numri i fermave më të mëdha që kanë më shumë se 2.00 ha vreshta është 154 me një sipërfaqe përkatëse vreshtash prej 657.00 ha. Studimi raporton se shumica e fermave që prodhojnë rrush janë të vogla, dhe shumë prej tyre merren me përpunimin në fermë, duke prodhuar raki dhe verë, të cilat janë burim i rëndësishëm të ardhurash.

Industria e përpunimit të rrushit (veçanërisht e prodhimit te veres) filloi të rizhvillohej pas ndryshimeve politike te viteve 90, por me nje ritëm më të ngadaltë se rritja e sipërfaqes. Në fillimet e saj shumica e përpunimit realizohej në nivel ferme, duke pasur si synuar tregun e brendshëm, kryesisht direkt te konsumatori, për shkak edhe të traditës ku blerja direkt nga prodhuesi konsiderohet si një garanci për cilësinë. Prodhuesit më të mëdhenj kanë si destinacion baret dhe resorantet, në të cilat me kalimin e viteve raporti i konsumit të verës ndaj rakisë ka ndryshuar në raport të konsumit të verës.

Industria e përpunimit të verës në Shqipëri po zhvillohet, duke rritur edhe cilësinë e verës së prodhuar falë eksperiencës së fituar dhe përfitimit të njohurive dhe eksperiencës nga profesionistë të huaj që vijnë nga vende me traditë në prodhimin tregëar të verës (kryesisht Italia),por përsëri sektori i përpunimit të rrushit në verë është larg plotësimit të kërkesave të tregut në rritje.

Pavarësisht zhvillimit pozitiv në kultivimin e vreshtave, prodhimi i verës në Shqipëri është relativisht i vogël në krahasim me potencialet e tij. Për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme, konkurrencës nga vendet më të zvuilluara dhe informalitetit, ky sektor ka kaluar më shumë vështirësi në rrugën e formësimit të tij.

Sipas raportimeve te studimeve të mëparshme (Report for the viticulture and ëine sector in the Eastern Balkans 2022) Shqipëria është vendi që prodhon sasinë më të vogël të verës, në raport me prodhimin e rrushit në rajonin e Ballkanit. Referuar studimit p.sh. Kosova megjithëse ka një sipërfaqe vreshti rreth 3.6 herë më të vogël se Shqipëria, prodhon gati tre here më shumë sasi vere.

**Tabela .** Sipërfaqet, prodhimi dhe rendimenti i vreshtave, vera e prodhuar në vendet e Ballkanit në vitin 2022

| Vendi              | Siperfaqja vresht(ha) | Sasia e prodhimit (kv) | Sasia e veres se prodhuar (l) | Rendimenti i rrushit (kv/ha) | Përqindja e verës nga rrushi |
|--------------------|-----------------------|------------------------|-------------------------------|------------------------------|------------------------------|
| Shqipëria          | 12'010                | 1'941'900              | 2'562'000                     | 161.69                       | 1.319%                       |
| Kosova             | 3'370                 | 220'800                | 8'025'000                     | 65.52                        | 36.345%                      |
| Maqedonia e Veriut | 28'210                | 2'444'900              | 78'827'000                    | 86.67                        | 32.241%                      |
| Mali izi           | 2'990                 | 237'100                | 10'206'000                    | 79.30                        | 43.045%                      |
| Bosnia Hercegovina | 4'580                 | 384'400                | 5'777'000                     | 83.93                        | 15.029%                      |
| Serbia             | 19'840                | 1'597'200              | 30'625'000                    | 80.50                        | 19.174%                      |

**Burimi:** Report for the viticulture and ëine sector in the Eastern Balkans 2022

Më shumë se gjysma e fermerëve, për shkak të traditës dhe lehtësisë së procesit të ruajtjes, përpunojnë më shumë se 60% të rrushit në raki dhe 31% e fermerëve përpunojnë në raki më shumë se 2/3 e rrushit (më shumë se 70%).

Sidoqoftë, kohët e fundit duket se po gjen rrugën drejt një zhvillimi të ngadaltë por të qëndrueshëm. Prodhimi i verës ka pësuar luhatje të mëdha në vite (megjithëse nuk ka raportime të qëndrueshme periodike). Raportime të mëparshme ngrejnë dyshime se një pjesë e verës që prodhohet në Shqipëri shitet në rrugë joformale (pothuajse e gjithë vera e prodhuar në ferma, por edhe një pjesë e verës së prodhuar/shitur nga kantinat e verës), kështu që vlerësimet nga autoritetet tatimore nuk japin të dhëna të sakta për vëllimin e verës së prodhuar dhe të shitur (AASF. 2019. Studim mbi sektorin e verës).

Pas një rritjeje të ndjeshme midis viteve 2000 dhe 2013 (rritje e prodhimit të verës 5 herë, nga 7413 ton në vitin 2000 në 38,000 ton në vitin 2013), prodhimi i verës ra në mënyrë drastike në 23,300 ton në vitin 2014 që vazhdoi pothuajse e njëjtë deri në vitin 2019. Nga viti 2019 dhe në vijim rritja ka qenë e evidente. Sipas raportimeve që citojnë Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në vitin 2022 (kantinat e rregjistruara), vendi prodhoi 3,03 milionë litra verë, 46.4 për qind e së cilës u eksportua, kryesisht në vende të tjera evropiane.

Sikurse u theksua më lartë, përpunuesit e verës mbështeten në tregun e brendshëm, duke tentuar të bëhen pjesë e tregut të jashtëm. Një ndihmesë të madhe krhas rritjes së cilësisë, ka dhënë rritja e turizmit. Mentaliteti i turistëve është të konsumojnë në vend dhe të zbulojnë kulturën vendase, veçanërisht ushqimin dhe verën. Krahas kosumit në vend, rritja e fluksit të turistëve, shërben dhe për promovimin e verës cilësore dhe shijes së prodhuar në Shqipëri, në vendet nga vijnë turistët.

Edhe pse industria e verës është në rritje, Shqipëria ka një deficit të qartë tregtar në verë.

**Tabela . Bilanci tregtar i verës Shqipëtare (në mijë USD)**

| Partnerët         | Bilanci 2020 | Bilanci 2021 | Bilanci 2022 | Bilanci 2023 | Bilanci 2024 | Eksportet 2024 | Importet 2024 |
|-------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|----------------|---------------|
| <b>Bota</b>       | -10,054      | -15,907      | -499         | -19,907      | -23,624      | 399            | 24,023        |
| <b>Gjermani</b>   | 0            | -3           | -34          | 193          | 313          | 393            | 80            |
| <b>Serbia</b>     | -373         | -1,092       | -981         | -1,080       | -1,080       | 6              | 1,086         |
| <b>Argjentina</b> | 0            | 0            | 0            | 0            | -4           | 0              | 4             |
| <b>Austria</b>    | 0            | 0            | 0            | 0            | -3           | 0              | 3             |
| <b>Belgjika</b>   | 0            | 0            | 0            | 82           | 0            | 0              | 0             |
| <b>Kili</b>       | 0            | 0            | 0            | 0            | -7           | 0              | 7             |
| <b>Franca</b>     | -1,158       | -1,869       | 0            | -3,545       | -4,603       | 0              | 4,603         |
| <b>Gjeorgjia</b>  | -19          | -58          | 0            | -98          | -140         | 0              | 140           |
| <b>Greqia</b>     | -8,391       | -12,184      | -429         | -14,847      | -17,084      | 0              | 17,084        |
| <b>Hollanda</b>   | -18          | -4           | 0            | 0            | -48          | 0              | 48            |
| <b>Zealanda</b>   | 0            | 0            | 0            | 0            | -4           | 0              | 4             |
| <b>Portugalia</b> | 0            | 0            | 0            | -16          | -11          | 0              | 11            |
| <b>Sllovenia</b>  | 0            | 0            | -37          | 0            | 0            | 0              | 0             |
| <b>Spanja</b>     | -96          | -26          | -267         | -334         | 0            | 0              | 334           |
| <b>Maqedonia,</b> | 0            | -672         | -421         | -559         | 0            | 0              | 559           |
| <b>Anglia</b>     | 0            | 0            | 0            | 0            | -27          | 0              | 27            |
| <b>SHBA-të</b>    | 0            | 0            | -8           | -20          | 0            | 0              | 20            |

**Burimi:** [https://agriculture.ec.europa.eu/data-and-analysis/markets/trade-data/tradecountryregion/trade-value\\_en](https://agriculture.ec.europa.eu/data-and-analysis/markets/trade-data/tradecountryregion/trade-value_en)

Sikurse vrehet në tabelë, edhe pse eksportet e verës kanë pësuar një rritje modeste, për shkak të kërkesës në treg dhe rritjes së importeve, ka rezultuar një deficit tregtar në rritje.

Për sektorin e verës, ky bilanc është i rëndësishëm, pasi evidenton potencialin që ekziston për të zëvendësuar importet (ka një kërkesë të paplotësuar dhe madje në rritje për verë në Shqipëri) dhe gjithashtu për të përfutur nga tregu në rritje i turizmit, nëse do të ndiqeshin përmirësime të cilësisë dhe efikasitetit në nivelin e prodhimit të fermës/rrushit dhe nivelin e përpunimit.

|                                                                                  |                |                                                             |       |           |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|
|  | Document Name: | Raport: Percaktimi i Zonave te Prodhimit te Rushit per Vere | Page: | 32 of 160 |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|

### 5.1.2 SITUATA E VRESHTARISE NE BOTE

Vreshtaria gjatë dekadave të fundit, në nivel botëror ka patur një tendencë rënie të sipërfaqes së mbjellë me vreshta, ndërsa prodhimi në raport me sipërfaqen ka pasur një rritje të lehtë. Sipërfaqja e vreshtave vazhdoi rënien e saj në vitin 2024 duke arritur në 7.1 milion hektarë në nivel botëror (sipas OIV), duke u tkurrur me 0.6% me vitet e mëparshme. Kjo shënon vitin e katërt radhazi të rënies, të nxitur nga zhvendosjet e vreshtave në rajonet kryesore të kultivimit të vreshtave në të dy hemisferat, duke prekur si vreshtat për përdorime vere ashtu edhe ato për tavolinë apo tharje.

Edhe prodhimi i verës për të dytin vit radhazi arriti në vlerat më të ulta historike në nivel global, si pasojë e kushteve ekstreme klimatike dhe presionit pasues nga sëmundjet që ndikuan rëndë në vreshtat në të gjithë botën. Ashtu si në vitin 2023, këto rrethana u përkeqësuan më tej nga presionet ekonomike dhe të tregut. Në vitin 2024, prodhimi total ra në 225.8 milionë hektolitra - më i ulëti në më shumë se 60 vjet - me një rënie prej 4.8% krahasuar me vitin 2023.

Peizazhi i vreshtave të Bashkimit Evropian (BE) shënoi një rënie të përgjithshme prej 0.8% në vitin 2024, duke arritur në total në 3.2 milionë hektarë. Rritjet modeste të raportuara në Itali, Rumani dhe Greqi nuk i kompensuan prerjet e vreshtave të vërejtura në vendet e tjera të BE-së.

Prodhimi i verës së prodhuar në Bashkimin Evropian në vitin 2024 vlerësohet në 138.3 milionë hl, që shënon një rënie prej 3.5% krahasuar me vitin 2023. Kjo përfaqëson vëllimin më të ulët të prodhimit të regjistruar që nga fillimi i shekullit, madje edhe pas vitit 2017 (141.5 milionë hl). Të dhënat e vitit 2024 nxjerrin në pah ndikimin e rëndësishëm të ndryshimeve klimatike në rajonet e verës së BE-së, me vreshtat që përballen me një gamë të gjerë situatash klimatike, si thatësi të rëndë dhe stres hidrik, reshje të mëdha dhe stuhi shkatërruese.

Spanja përfaqëson vreshtarinë më e madhe në botë, ka arritur në 930 000 ha në vitin 2024 dhe është ulur me 1.5% (ekuivalente me 14 500 ha) krahasuar me vitin 2023. Prodhimi i saj i verës e rendit në vendin e tretë në pozicionin global, me një vëllim prodhimi prej 31.0 milionë hektolitra në vitin 2024. Kjo shifër përfaqëson një rritje prej 2.6 milionë hektolitra (+9.3%) krahasuar me vitin 2023, megjithëse mbetet 11.1% nën mesataren pesëvjeçare.

Franca renditet e dyta në nivel global me sipërfaqen e vreshtave, por shënoi një rënie prej 0.7%, duke arritur në 783000 ha. Ajo ruan vendin e dytë në renditjen botërore për sasinë e verës së prodhuar në vitin 2024 një vëllim prej 36.1 milionë hektolitra, duke shënuar një rënie të konsiderueshme prej 11.1 milionë hektolitra (-23.5%) nga viti 2023 dhe 17.9% nën mesataren e saj pesëvjeçare. Kjo përfaqëson prodhimin më të ulët që nga viti 1957 (32.5 milionë hektolitra).

Italia vazhdoi trendin e saj pozitiv në rritjen e sipërfaqes me vreshta, duke arritur në 728 000 ha, ndër shtatë vreshtat më të mëdha në botë. Ajo përfaqëson prodhuesin më i madh të verës në nivel global, por edhe një nga vendet e pakta që regjistroi një nivel mesatar prodhimi në vitin 2024, me 44.1 milionë hektolitra, që përfaqëson një rritje të dukshme prej 15% nga niveli historikisht i ulët i prodhimit të vitit 2023. Megjithatë, vëllimi i vitit 2024 është ende 6% nën mesataren pesëvjeçare. Kushtet e pafavorshme të motit ndikuan në shumicën e rajoneve italiane të verës, veçanërisht në veri të saj, ku një pjesë e konsiderueshme e vreshtarisë u prek nga breshëri.

Nga vendet europiane Rumania dhe Greqia shënuan rritje të sipërfaqeve të vreshtave (përkatesisht 187 000 ha, +0.1%/2023 dhe 93 000 ha, +0.4%/2023). Në të gjitha vendet e tjera kryesore të kultivimit të vreshtave në BE, u regjistruan rënie të sipërfaqes me vreshta: -5.1% në Portugali (173 000 ha), -0.4% në Gjermani (103 000 ha), -7.3% në Bullgari (60 000 ha) dhe -1.0% në Hungari (60 000 ha).

Jashtë BE-së, Moldavia ruajti pozicionin e saj si vreshtaria më e madhe në Evropën Lindore me 115 000 ha, ndërsa Rusia raportoi një rritje të sipërfaqes prej 2.2%, duke arritur në 108 000 ha.

Kina përfaqëson vendin e tretë në botë për nga madhësia e vreshtave, që vlerësohet në 753 000 ha në vitin 2024 (-0.4%/2023), duke u stabilizuar vitet e fundit pas një periudhe zgjerimi të konsiderueshëm nga viti 2000 deri në vitin 2015 (nga 300 000 ha në 770 000 ha). Kina është prodhuesi më i madh i verës në Azi, me një vëllim rreth 2.6 milionë hektolitra në vitin 2024, duke shënuar një rënie prej 17.0% krahasuar me vitin e kaluar.

|                                                                                  |                   |                                                             |       |           |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|
|  | Document<br>Name: | Raport: Percaktimi i Zonave te Prodhimit te Rushit per Vere | Page: | 33 of 160 |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|

SHBA-të, prodhuesi i katërt më i madh i verës në botë, me një sasi të vlerësuar prej 21.1 milionë hektolitra në vitin 2024, duke shënuar një rënie prej 17.2% nga viti 2023 dhe 15.5% nën mesataren pesëvjeçare, përfaqësojnë vreshtarinë e gjashtë në botë për nga sipërfaqja, që vlerësohet në 385 000 ha (-0.7%/2023). Ky është viti i njëmbëdhjetë radhazi që sipërfaqja me hardhi ka rënë që nga kulmi i saj në 453 000 ha në vitin 2013.

Turqia renditet vreshtaria e pestë më të madhe në botë në vitin 2024, me një sipërfaqe prej 402 000 ha, të dedikuar kryesisht për prodhimin e rrushit të tryezës dhe të tharë, megjithëse ka pasur një trend negativ në dhjetë vitet e fundit, duke humbur 20% të sipërfaqes së vreshtave të saj.

India ka zgjeruar ndjeshëm vitet e fundit sipërfaqet me vreshta, me një normë mesatare vjetore rritjeje prej 4.5% që nga viti 2019. Në vitin 2024, sipërfaqja totale me hardhi vlerësohet të arrijë në 185 000 ha. Vreshta të tjera të mëdha në Azi, kryesisht të specializuara në prodhimin e rrushit të tryezës dhe rrushit për t'u tharë, janë në Iran (122 000 ha), Uzbekistan (121 000 ha) dhe Afganistan (100 000 ha).

Vreshtaria e Australisë vlerësohet në 159 000 ha, në përputhje me mesataren e vëzhguar gjatë pesë viteve të fundit. Prodhimi i verës në Australi është i barabartë me 10.2 milionë hektolitra në vitin 2024, duke përfaqësuar një rritje prej 5.3% nga vëllimi historikisht i ulët i vitit 2023, por duke mbetur 16% nën mesataren pesëvjeçare.

Konsumi global i verës në vitin 2024 vlerësohet në 214.2 milionë hektolitra, me një rënie prej 3.3% nga niveli tashmë i ulët i vitit 2023. Kërkesa në rënie në tregjet kryesore, së bashku me çmimet mesatare të larta, të nxitura nga vëllimet e ulëta të prodhimit dhe efektet e zgjatura të inflacionit të kaluar, e bënë vitin sfidues. Tregtia ndërkombëtare e verës në vitin 2024, u ndikua nga vëllimet e ulëta të prodhimit dhe çmimet mesatare të larta të eksportit. Vëllimi total i eksportit mbeti relativisht i ulët në 99.8 milionë hektolitra, që barazohet me vitin 2023, por që është 5% nën mesataren pesëvjeçare. Vlera e eksportit të verës arriti në 35.9 miliardë euro, ku çmimi mesatar i eksportit ruajti rekordin më të lartë të vendosur në vitin 2023 prej 3.60 euro për litër.

Nga kjo analizë e zhvillimit të vreshtarisë dhe verëtarisë në botë, kuptohet se me çfarë sfidash përballët zhvillimi i vreshtarisë dhe sektori i industrisë së verës në vendin tonë, por edhe mundësi midis potencialit të madh natyror dhe kufizimeve aktuale strukturore. Zhvillimi i mëtejshëm i sektorit kërkon një qasje të integruar që të shfrytzojë avantazhet dhe të përpiqet që të shfrytëzojë mundësitë për tu bërë pjesë e tregut botëror. Vera shqiptare do të duhet të orientohet në bashkimin e traditës me inovacionin dhe në promovimin inteligjent të origjinës shqiptare si një burim autenticiteti dhe cilësie. Ne duhet të përfitojmë nga eksperiencia e vendeve lider në sektorin e vreshtarisë dhe verëtarisë, si dhe në mekanizmat që këto vende përdorin për të shfaqur autenticitetin e produkteve të tyre.

Krahas investimit në progresin teknologjik të prodhimit dhe rritjes së cilësisë duke shfrytëzuar pasurinë gjenetike të varieteteve autoktone me karakteristika dhe veçori konkurruese dhe mundëi për të arritur standarde ndërkombëtare, përdorimi i çertifikimeve të origjinës dhe të cilësisë (PDO, PGI, DOC etj.), me krijimin e emërimit “Protected Designation of Origin – Albania, është një nga hapat e rëndësishëm për krijimin e identitetit kombëtar të verës dhe për ta çuar përpara sektorin.

Këtij qëllimi i shërben edhe ky studim, i cili nëpërmjet krijimit të hartave të zonave homogjene të vreshtave në të gjithë territorin shqiptar, do t'u shërbejë prodhuesve si bazë për përfshirjen në skemat e cilësisë që janë aktive në Bashkimi Evropian (BE) dhe mund të zbatohen edhe sipas ligjit shqiptar, siç janë Treguesit Gjeografikë të Mbrojtur, Emërtimi i Origjinës së Mbrojtur, termi tradicional, si dhe emërtimi i nën-zonave që mund të përmenden në etiketimin e verërave.

Njohja e skemave të cilësisë është e rëndësishme për sektorin e verërave shqiptare në kontekstin e integritetit të tregut vendas në atë evropian, si dhe perspektivat e ardhshme të integritetit të plotë. Kjo për shkak se një pjesë e konsiderueshme e verërave të BE-së, është në këto skema cilësie, të cilat kanë një ndikim pozitiv në zgjedhjet e konsumatorëve të verërave dhe orientojnë zgjedhjet e tyre. Sipas BE-së, këto produkte paraqesin një pikë të fortë dhe një avantazh konkurrues të rëndësishëm për grupet e prodhuesve dhe janë pjesë integrale e trashëgimisë kulturore dhe gastronomike të vendeve.

Situata aktuale e verërave shqiptare, pa verëra me emërtime si: Treguesit Gjeografikë të Mbrojtur ose Emërtimi Origjinës së Mbrojtur, është disavantazhuese në krahasim me verërat e BE-së.

## 5.2 ZONAT VRESHTARE ME KARAKTERISTIKA HOMOGENE

Zonat homogjene janë hapësira gjeografike ku kushtet natyrore (klima, toka, relievi) dhe faktorët njerëzorë (tradita, kultivarët, praktikat e punimit) janë të ngjashme dhe të qëndrueshme, duke krijuar potencial të veçantë për prodhimin e rrushit me cilësi dhe tipar të caktuar. Në terminologjinë ndërkombëtare kjo lidhet me konceptet e “terroir” ose “zona vreshtare”.

Çfarë është termi “terroir”? Etimologjia tregon një prejardhje latine të termit terroir nga territorium = territor, “terroir” vjen nga frëngjishtja “terre” që do të thotë “tokë”, por në verëtarin ajo ka shumë kuptime të mundshme me të cilat mund ta interpretojmë. Të gjitha këto përkufizime kanë një fije të përbashkët: lidhja me vendin e prodhimit, të “originës”, “specifiteti” dhe “tipiciteti”. Termi terroir përdoret gjerësisht si një unifikim i mendimeve dhe filozofive të ndryshme që ekzistojnë në lidhje me vreshtin dhe territorin në raport me verën. Ka vende me një traditë të lashtë të prodhimit të verës si Franca që njeh cilësinë e verërave si të lidhura ngushtë me territorin e originës për shkak të terroirit, ndërsa të tjerë që janë kryesisht vendet e reja të rritjes së rrushit si Amerika dhe Australia, të cilat e konsiderojnë varietetin e rrushit si faktorin kryesor që përcakton cilësinë e verërave. Filozofi të tjera e cila e konsideron konceptin e ndërveprimit midis hardhisë dhe mjedisit si krijues të cilësisë së verërave. Terroir përfshin të gjitha faktorët natyrorë dhe njerëzorë që ndikojnë në karakterin dhe cilësinë e një vere të prodhuar në një vend të caktuar.

Në mënyrë të përmbledhur: Terroir = Toka + Klima + Topografia + Tradita njerëzore

**Terroir:** *teresia territoriale ku karakteristikat natyrore të tokës, nëntokës, relievit dhe klimes - përbëjnë një grup unik faktorësh që i japin produktit që rezulton nëpërmjet bimëve ose kafshëve, karakteristika specifike. Njerëzit i kanë përshtatur teknikat e tyre të prodhimit këtyre kushteve të veçanta të mjedisit natyror, duke synuar të përmirësojnë rezultatin cilësor të produktit të përfutur në këtë vend, duke i dhënë atij veçanti dhe ekskluzivitet.*

Dhe është pikërisht ky koncept i terroir që është gurrthemeli mbi të cilin e mbështesin mbrojtjen e prodhimeve të tyre në tregun global vendet me traditë si Franca, Italia, Spanja etj., që në fakt duhet të synohet dhe nga prodhuesit tanë në tregun global.

Identifikimi dhe karakterizimi i terroirëve varet nga njohja e parametrave mjedisorë, funksionimit të hardhisë së rrushit dhe karakteristikave të produktit përfundimtar, por që mund të ndryshojë në një farë mënyre me evolucionin e praktikave njerëzore dhe materialit bimor që përdoret si rezultat i eksperimentimit të vazhdueshëm. Meqenëse koncepti i terroirëve mbështetet në potencialin e brendshëm agronomik të mjedisit dhe është i pandashëm nga karakteristikat dhe “identiteti” i produktit përfundimtar bujqësor, të gjitha studimet për të përcaktuar kufijtë e terroirëve duhet të përfshijnë hartëzimin e karakteristikave përkatëse mjedisore në mënyrë që të merren njësi mjedisore relativisht homogjene, si dhe një studim të reagimit të kulturës ndaj këtyre njësive të përcaktuara (Morlat, 2001, Vaudour, 2003).

Një zonë konsiderohet të ketë potencial vreshtar nëse lejon rritjen e rrushit cilësor për të paktën një lloj prodhimi (p.sh. rrush tavoline ose verë, verëra cilësore, verëra të gazuara shkurëzuese, verë nga rrushi i tejpjekur, etj.). Kur bëhet fjalë për llojet e verërave, një zonë konsiderohet e përshtatshme për prodhimin e verërave cilësore nëse siguron pjekjen e plotë të rrushit, me një cilësi të qëndrueshme nga viti në vit. Në shprehjen e cilësisë së verës bashkohen dy “lloje” cilësie: e lindur dhe e fituar. E para i referohet të gjithë faktorëve që lidhen me hardhinë dhe agro-ekosistemin në të cilin është kultivuar dhe i dyti përfshin të gjithë faktorët njerëzorë që veprojnë në prodhimin dhe transformimin e rrushit (Scienza 1992). Meqenëse teknikat e prodhimit të verës dhe sistemet e menaxhimit janë mjaft të njohura dhe të standardizuara, për të marrë verëra tipike është e nevojshme të evidentohet dhe të vepohet duke

përmirësuar pjesën e cilësisë së lindur. Për ta bërë këtë, është e rëndësishme të studiohet sistemi hardhi-terroir për të kuptuar dhe interpretuar ndërveprimin e një hardhie me një mjedis kultivues specifik. Megjithatë, një vlerësim i ndikimit të terroirit në shprehjen vegetative-prodhuese të bimës kërkon klasifikimin sipas rëndësisë dhe shkallës së ndikimit të çdo variable në produktin përfundimtar.

Janë një sërë variablash që ndikojnë në përshtatshmërinë vreshtare të një zone të caktuar, ku mund të përmendim variablat makro-mjedisore, të cilat përcaktojnë mjedisin e jetesës së vreshtit, që nuk ndryshojnë, ku përfshihen natyra e shkëmbit amnor, profili pedologjik, përbërjen skeletike të tokës, teksturën, përmbajtjen e karbonateve, pjerrësinë, pozicioni gjeografik, lartësinë mbi nivelin e detit, ekspozicioni, forma e relievit (geomorfologjia) etj.

Të tjerë variabla janë ato që ndryshojnë në hapësirë dhe kohë gjatë gjithë vitit dhe midis viteve. Ndër këto lloj variablash mund të përmendim temperaturën dhe lagështinë e ajrit, rrezatimin diellor, reshjet, lagështinë dhe temperaturën e tokës, drenazhimi etj.

Krahas tyre janë edhe variablat e matshëm në nivel bimësh, që përbëjnë bazën e sjelljes dhe funksionimit të saj. Për shembull, përmendet statusi ushqimor, furnizimi me ujë, ekuilibri fotosintetik, hershmëria, aspektet fiziologjike etj.

Për të arritur në një ndarje të zonave vreshtare ka shumë metodologji studimi, por që kovergjojnë në tre aspekte themelore.

Së pari veçohet natyra ndërdisiplinore e studimit. Duke pasur parasysh variablat e shumtë në lojë, janë të nevojshme bashkordinimi midis klimatologut, pedologut, enologut, agronomit të vreshtarisë dhe informaticienëve, të cilat janë plotësuese me njëra-tjetrën.

Së dyti është studimi i ndërveprimit midis varietetit/varieteteve të hardhisë dhe mjedisit. Për të vlerësuar potencialin e një mjedisi të caktuar nuk mjafton vetëm përshkrimi i karakteristikave të tokës dhe klimës së vendit, por është e nevojshme të vlerësohet reagimi që japin varietetet e kultivuara në atë mjedis. Në praktikë synohet të vlerësohet përshtatja e hardhisë në mjedisin e kultivimit.

Dhe e treta është analiza ndijore e mikro-vinifikimeve të marra nga vreshtat kryesore, e cila na lejon të vlerësojmë rezultatin dhe nivelin e ndërveprimit vreshta-terroir në produktin përfundimtar.

Një dallim tjetër që është i rëndësishëm për t'u raportuar janë nivelet e ndryshme të zonimit në lidhje me kompleksitetin e mjedisit dhe faktorët që veprojnë mbi të dhe me madhësinë e territoreve të studiuara që mund të jenë:

- makrozonimi, që i referohet një pjese të madhe të territorit, duke filluar nga madhësia rajonale në kombëtare ose komunitare, e cila ka një qëllim të përgjithshëm njohës që synon identifikimin e zonave makro izoklimatike
- mezozonimi, që ka si objekt studimin e një njësie më të vogël prodhuese dhe administrative se ai i mëparshmi, si p.sh. Emërtimi i origjinës
- mikrozonimi, që zbatohet në një kontekst biznesi

Zonimi paraqitet jo vetëm për të vlerësuar përshtatshmërinë vreshtare të një zone të caktuar, por edhe për të gjetur faktorët kufizues dhe për të përmirësuar nivelin e tyre shprehës, nëpërmjet rritjes së njohurive mbi variablat që përcaktojnë cilësinë e verërave.

## 5.2.1 MATERIALI DHE METODAT

Për arritjen e objektivave të studimit janë përdorur të dhëna dhe informacione nga disa burime. Fillimisht është grumbulluar informacion mbi historikun, të dhëna statistikore, studime dhe raportime mbi vreshtarinë dhe verëtarinë në Shqipëri. Mbi bazën e këtij informacioni, në bashkëpunim edhe me QTTB Vlorë, u organizua puna në terren në dy drejtime kryesore: marrjen e të dhënave nga monitorimi i vreshtave në terren dhe intervista në kantinat e verës, duke u munduar të jenë përfaqësuese të gjithë territorit të vendit.

## 5.2.2 MONITORIMI AGRONOMIK I VRESHTAVE

Duke marrë për bazë kadastrën e vreshtave të menaxhuara nga Qendra për Transferimin e Teknologjisë Bujqësore të Fushë-Krujës (QTTB- Fushë-Krujë), fillimisht u përcaktuan zonat ku do të përzgjidheshin vreshtat udhëzuese mbi të cilat do të kryhej monitorimi. Kadastra që na u vu në dispozicion, përveç se identifikon vreshtat me sipërfaqe të konsiderueshme dhe pozicionin e tyre në hartën e Shqipërisë, jep të dhëna edhe për strukturën varietore dhe shpërndarjen e tyre.

Pas përcaktimit të zonave, është shkuar në terren dhe pas kontakteve me fermerë, pronarë të kantinave, zotërues të vreshtave (pronarë apo qiramarrësit e vreshtave), është shpjeguar qëllimi i studimit dhe në vreshtat që është dakortësuar mundësia për të vizituar dhe monitoruar ciklin vjetor të prodhimit, është bërë etiketimi i bimëve përfaqësuese dhe janë marrë të dhëna për realizimin e dy objektivave:

- Përcaktimin e strukturës varietore dhe ndikimin e mjedisit në kalimin e fazave fenologjike, prodhimtarinë dhe cilësinë e prodhimit;
- Dhe fillimin e punës për identifikimin e strukturës klonale të vreshtave sipas ndarjes së zonave homogjene në territorin e Shqipërisë.

Për të studiuar përshtatshmërinë e kultivarëve/kloneve në zonat homogjene dhe për të kuptuar më mirë parametrat e tokës dhe klimës që rregullojnë sjelljen e bimëve, gjatë periudhës së studimit në të gjithë vreshtat që u quajtën vreshta pilot eksperimentale, u bënë vëzhgime për të dhëna fenologjike, për të përcaktuar kohën e çeljes së sythave, lulëzimit, fillimit të pjekjes (të njohur si verasion) dhe pjekjes së plotë, apo të vjeljes.



|                                                                                  |                |                                                             |       |           |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|
|  | Document Name: | Raport: Percaktimi i Zonave te Prodhimit te Rushit per Vere | Page: | 37 of 160 |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|

Për t'i hapur rrugë identifikimit të kloneve, që në fillim, gjatë etiketimit të bimëve, është kërkuar që brenda vreshtave ekzistuese me kultivarë autoktone, të vrojtoheshin me kujdes diferenca të mundshme midis bimëve përgjatë ciklit vjetor dhe mbajtja e shënimeve, me qëllim evidentimin e bimëve kandidatë për klon dhe për të bërë karakterizimin e varieteteve në nivel morfologjik, duke u bazuar në parametrat e parashikuar në "RESOLUTION OIV-VITI 702-2023". Për të përcaktuar vreshtat eksperimentale, grupi i punës është munduar që të bashkërendojë edhe me kantinat, të cilët kanë qenë edhe vetë të interesuar për këtë studim, jo thjesht se ato pranonin të bashëpunonin. Në shumicën e rasteve kanë qenë vreshtat e kantinave si parcela eksperimentale të përfshira në studim. Kjo mënyrë organizimi na lejonte për të pasur sa me shumë informacion se ku ishte zona ku këto kantina blinin rrushin për verë (përveç rrushit që prodhonin vetë).

Në vreshtat e përzgjedhur, janë marrë të dhënat për distancat e mbjelljes dhe është sugjeruar që të ruhet pak a shumë i njëjti numër mesatar të bistakëve/metër linear (në systemin kordon).

Në momentin e fillimit të pjekjes dhe më pas në mënyrë periodike deri në pjekjen e plotë janë marrë mostra rrushi për të përcaktuar përqindjen e shëqerit, aciditetin total dhe pH.

Në bimët që kanë manifestuar diferenca të natyrës biomorfologjike, janë marrë mostra të majës së lastarit, gjetheve të para dhe gjetheve të rritura, për të bërë vlerësimin ampelografik.

Në kohën e vjeljes së rrushit, janë marrë mostra bistakësh dhe janë bërë matje biometrike të bistakut dhe të kokrrës, krahas analizave kimike në laborator.

### 5.2.3 INTERVISTAT NË KANTINA DHE MARRJA E MOSTRAVE TË VERËS

Në shumicën e studimeve të ngjashme të realizuar për ndarjen zonale në vende si Italia, Franca, Spanja etj., për të arritur në përcaktime të sakta të zonave homogjene, krahas studimit agronomik të kryer në një periudhë kohore minimalisht tre vite rresht, janë kryer mikrofinifikime të rrushit të prodhuar në parcelat eksperimentale, për të evidentuar deri tek vera e prodhuar diferenca që mund të jenë tregues të ndërveprimit midis hardhisë dhe mjedisit. Në pamundësi për të realizuar një metodologji të tillë, ne hartuam një pyetësor për kantinat dhe i përfshimë edhe ato si grupe interesi në këtë studim, ku krahas informacionit për varietetet e rrushit që kultivonin dhe përpunonin, teknologjinë e përdorur për përpunim, nivelin e organizimit dhe disponimit të pajisjeve, aparaturave dhe personelit të kualifikuar, kemi marrë mostra të verës së prodhuar nga këto kantina, me qëllim kryerjen e analizave kimike dhe organoleptike. Është insistuar që mostrat e verës të merren vetëm për verën e prodhuar në mënyrë sa më natyrale, dhe kryesisht për varietetet autoktone të pakubazuara. Qëllimi nuk është të evidentohet se kush prodhohen verëra të shkëlqyera, por për varietetet individuale të përpunuara me ndërhyrje minimale teknologjike dhe korrigjuese. verëra "natyrale" që janë sa më shprehëse të jetë e mundur të bashkëveprimit midis varietetit të rrushit dhe terroir-it.

Verërat e përpunuara sipas të njëjtit standart, dhe të ruajtura në vinotekë me klimë të kontrolluar deri në grumbullimin e plotë nga të gjitha kantinat, janë pajisur me një kod përfaqësimi dhe janë çuar për analizat sensorale në një panel test të njohur, shumë të organizuar dhe standartizuar.

Objektivi i vlerësimit shqisor është të përcaktojë karakteristikat e verërave të përfutuara nëpërmjet të njëjtës praktikë vinifikimi, përmes punës së një paneli degustues prej minimalisht pesë personash dhe të udhëhequr nga një udhëheqës paneli, një specialist i njohur me teknikat dhe procedurat e analizës shqisore dhe i aftë për të përpunuar të dhënat e mbledhura.

Para fillimit të vlerësimit të verërave, paneli, përgjithësisht i përbërë nga teknikë vreshtarie, enologë dhe prodhues vere, ju nënshtrua një faze trajnimit dhe kalibrimit mbi parametrat e ndryshëm për të përshkruar verërat, me qëllim standardizimin e fjalorit dhe shkallës së intensitetit.

Vlerësimi shqisor është një fazë shumë e rëndësishme sepse na lejon të dallojmë karakteristikat shqisore të lidhura me verërat nga terroir të ndryshëm. Në rastin tonë studimor ai shërben për të bërë një klasifikim dhe diferencim të mundshëm midis zonave të ndryshme të kultivimit dhe të varieteteve që këto kantina përfaqësojnë.

#### 5.2.4 INTERPRETIMI DHE RAPORTIMI I TË DHËNAVE

Sasia e madhe e të dhënave të mbledhura duhet të organizohet për të ofruar mjete për të kuptuar dhe interpretuar territorin. Nëpërmjet përpunimit statistikor të të dhënave të marra nga vreshtat udhëzuese shtrihen për analogji në zona të ndryshme, duke lejuar identifikimin e njësive profesionale në të gjithë zonën e studiuar. Përmes programeve specifike statistikore, llogariten dhe krahasohen të dhënat e marra për të përcaktuar një renditje hierarkike të ndikimit të variablave. Nga këto tregues dhe indekse të llogaritura, mund të krijohen harta profesionale, harta tematike, hartave të përdorimit të tokës, deri në një manual përdorimi të tokës që përfshin të gjithë punën e zonimit.

Gjendjen për ndarjen zonale të apo që përfshin zbulimin e disa parametrave vegjetativo-prodhues që mund të jenë tregues të ndërveprimit midis hardhisë dhe mjedisit të konsiston në studimin e ndërveprimit midis hardhisë dhe mjedisit. Brenda Njësive të Peizazhit të identifikuar dhe të përshkruara falë hetimeve të mëparshme, vreshtat përfaqësuese janë zgjedhur për t'u përdorur si vreshta udhërrëfyese. Këto vreshta duhet të jenë sa më homogjene për sa i përket menaxhimit, sistemeve të trajnimit, nënshartesave të përdorura dhe moshës; më pas, nëse është e nevojshme, bëhet standardizimi i ngarkesës së sythave për bimë për të rregulluar nivelet e prodhimit. Studimi agronomik përfshin zbulimin e disa parametrave vegjetativo-prodhues që mund të jenë tregues të ndërveprimit midis hardhisë dhe mjedisit. Këta parametra kanë të bëjnë me ngarkesën e prodhimit, pjellorinë, gjendjen ushqyese, vazhdimësinë e fazave të ndryshme fenologjike të hardhisë dhe kinetikën e pjekjes. Më pas kryhen analiza kimike në mostrat e mbledhura nga rrushi i destinuar për kryerjen e mikrovitamineve të veçanta të kryera sipas procedurave të standardizuara. Së fundi, vera i nënshtrohet analizave kimike dhe ndijore.

### 5.3 REZULTATET DHE DISKUTIME

#### 5.3.1 ZONAT E KULTIVUARA DHE PËRHAPJA E VRESHTAVE SIPAS VARIETETEVE

Nga evidentimi i njësive të prodhimit të vreshtave sipas varieteteve të regjistruara në kadastrën e vreshtave të menaxhuara nga Qendra për Transferimin e Teknologjisë Bujqësore të Fushë-Krujës, janë evedentuar në total 73 varietete hardhie, nga të cilët 51 prej tyre janë për prodhim vere dhe 22 me rrush tavoline apo përdorime për përpunim pije alkoolike. Nga varietetet e përshtatshme për prodhimin e verës, rezultojnë 17 varietete autoktone dhe 34 varietete të huaja (të regjistruara si varietete me origjinë të huaj).

Referuar të dhënave të kadastrës (Tabela ) sipërfaqja e vreshtave që përdoren për prodhimin e verës zënë në total rreth 91.3% të vreshtave. Nga sa është arritur të konstatohet gjatë përzgjedhjes së vreshtave eksperimentale pilot, sipërfaqja e vreshtave për prodhim rrushi për tavolinë është duke u rritur, pasi ka konvertim të vreshtave që përdoren me përdorim të dyfishtë, me varietete që përdoren vetëm me destinacion tregun për konsum të freskët.

**Tabela** Numri i njësive prodhuese të vreshtave dhe sipërfaqet sipas kultivarëve kryesorë

| Kultivarët            | Numri i njësive të prodhimit | Sipërfaqja (Ha) | %    |
|-----------------------|------------------------------|-----------------|------|
| <b>Shesh i Zi</b>     | 10,609                       | 2719.6          | 37.6 |
| <b>Shesh i Bardhë</b> | 5,293                        | 1352.1          | 18.7 |
| <b>Merlot</b>         | 2,539                        | 735.3           | 10.2 |

|                    |               |                |            |
|--------------------|---------------|----------------|------------|
| Victoria           | 818           | 229.6          | 3.2        |
| Hibrid             | 816           | 185.5          | 2.6        |
| Tokai              | 670           | 154.6          | 2.1        |
| Vranac             | 575           | 140.8          | 1.9        |
| Sangiovese         | 343           | 114.8          | 1.6        |
| Kallmet            | 358           | 111.6          | 1.5        |
| Riesling           | 332           | 101.4          | 1.4        |
| Muskat             | 284           | 87.1           | 1.2        |
| Italia             | 315           | 81.3           | 1.1        |
| Cabernet Sauvignon | 276           | 81.6           | 1.1        |
| Debinë e Bardhë    | 306           | 71.8           | 1          |
| Pamid              | 243           | 51.8           | 0.7        |
| Tempranilo         | 357           | 45.3           | 0.6        |
| Vlosh              | 130           | 32.9           | 0.5        |
| Të rjerë           | 4,292         | 932.7          | 12.9       |
| <b>Totali</b>      | <b>28,556</b> | <b>7,229.8</b> | <b>100</b> |

Burimi: QTTB Fushë-Krujë. (2021)

Nga vreshtat për prodhim vere varietetet autoktone zënë 78.1% e sipërfaqes totale të vreshtave për prodhim vere. Vetëm dy varietete, Shesh i zi dhe Shesh i bardhë së bashku zënë 62.6 % (përkatësisht 43.54% dhe 19.06%) të sipërfaqes së vreshtave për verë, ose 89.3 % të sipërfaqes që zënë varietetet autoktone (62.14 % Sheshi i zi dhe 27.19 % Sheshi i bardhë).

Nga varietetet e huaja, Varieteti Merlot është i përhapur në të gjitha rrethet dhe zë sipërfaqen më të madhe, me 12.34% në raport me vreshtat për verë, i ndjekur nga Sangiovese 2.23 %, Tokaj 2.08%, Vranac 1.81 %, Kabënet Sovinjon 1.51 %, Riesling 1.49 %, etj.

Raporti i sipërfaqeve të varieteteve për prodhim vere të kuqe me ato për verë të bardhë është 71.6:28.4, me një tendencë për rritjen e sipërfaqeve me vreshta për verë të bardhë.

Analiza e bërë në lidhje me sipërfaqet e vreshtave dhe varietetet, u bë jo vetëm për të ndërtuar hartën e vreshtave eksperimental, por edhe për të kuptuar se ku janë të përhapura këto varietete dhe raportin që kanë me vreshtat në total dhe me territorin ku ato shtrihen.

Nga analizimi i raportimeve të marra nëpërmjet pyetësorëve në kantinat e verës, rezulton se për verën e prodhuar, raporti midis sasisë së verës së kuqe me atë të verës së bardhë është 62:37, ndërsa vera e prodhuar nga varietete autoktone zë 49.05 % të verës që prodhojnë kantinat në tërësi. Kantinat prodhojnë mesatarisht 57.5% të rrushit që përpunojnë në vreshtat e tyre, ndërsa 42.4 % të rrushit e blejnë në zonën përreth kantinës.

Sa i takon zonës ku janë të përhapur, varietetet e rrushit rezulton se Sheshi i bardhë, është i përhapur në të gjithë vendin, por përqëndrimin më të madh e ka në Qarqet Fier, Tiranë, Elbasan, Berat, Durrës dhe Vlorë, ku janë mbi 60% e sipërfaqes. Qarku i Dibrës dhe i Kukësit renditen me sipërfaqet më të vogla përkatësisht 0.2 dhe 0.5 %.

Renditja në rang Bashkishë tregon se Bashkitë Tiranë, Lushnjë, Belsh, Durrës, Berat, Vlorë dhe Fier kanë 55.6 % të sipërfaqes totale me Shesh të bardhë. Ndërsa në Bashkitë e Korçës, Maliqit, Pukës dhe Bulqizës sipërfaqet janë shumë të vogla.

Edhe Sheshi i zi shtrihet në të gjitha Qarqet e vendit, ku Qarku i Fierit, Vlorës, Beratit, Tiranës Elbasanit dhe Durrësit kanë rreth 80.8% të sipërfaqes, me përqëndrimet në Bashkitë e Vlorës, Fierit, Beratit, Tiranës, Lushnjës, Durrësit, Roskovecit, Kurbinit dhe Mallakastrës, që kanë rreth 61 % të sipërfaqes totale që ka Sheshi i Zi. Në Bashkitë Devoll, Korçë, Tropojë, Skrapar, Vau i Dejës, Has, Bulqizë dhe Tepelenë

|                                                                                  |                |                                                             |       |           |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|
|  | Document Name: | Raport: Percaktimi i Zonave te Prodhimit te Rushit per Vere | Page: | 40 of 160 |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|

janë vetëm 1 % e sipërfaqes. Në Bashkinë e Pogradecit dhe të Pukës sipërfaqja me Shesh të zi është e papërfillshme.

Nga varietetet e huaja Merloti është i kultivuar në të gjitha qarqet e vendit, me dominimin në Qarqet Gjirokastrë, Durrës dhe Fier ku janë rreth 62 % e sipërfaqes, me dominimin në Bashkitë e Durrësit, Përmetit, Lushnjës dhe Vlorës ku janë rreth 45 % e sipërfaqes.

Varieteti Kallmet është i përqëndruar në Qarkun e Shkodrës (57 %) dhe Lezhës (40 %), me sipërfaqet më të mëdha në Bashkitë e Mirditës (33.3%), Shkodrës (31.7%) dhe Malësisë së madhe (20.5 %). Për shkak të veçorive të cilësisë së këtij varieteti në prodhimin e verës, po gjen përhapje edhe jashtë zonës së tij, në të gjithë vendin.

Varieteti Debinë e bardhë shtrihet në Qarkun e Gjirokastrës (91.3%) dhe të Korçës (8.7 %), kryesisht në Bashkitë Përmet (79.7%), Kolonjë (8.7%), Këlcyrë (6 %) dhe Gjirokastrë (3.2%).

Varieteti Vlosh, shtrihet në Qarkun Fier (55%), Gjirokastrë (30.7%) dhe Vlorë (9.8%), I pozicionuar më shumë në Bashkinë Fier (46.9%), Memaliaj (20.9%), Vlorë (9.8%) dhe Tepelenë (7.7%).

Serina e zezë shtrihet në Qarkun Korçë (50%), Gjirokastrë (19.4%), Berat (12.9 %), Fier (8.3 %) dhe Tiranë (4 %), e sipërfaqes, me përqëndrimet në territoret e Bashkisë Korçë (39.3%), Gjirokastrë (19.1%), Poliçan (12.2 %) dhe Pogradec (9.3 %).

Serina e bardhë shtrihet në Qarkun Korçë (50.9%), Dibër (19.1 %), Fier (13.5 %), Vlorë (11.2 %) dhe Tiranë ( 3.5 %), e përqëndruar në Bashkinë Korçë (50.9%), Klos (11.2%), Vlorë (11.2 %), Fier (9.8 %, Mat (4.7 %) dhe Tiranë ( 3.5 %).

Varieteti Debinë e zezë shtrihet në Qarkun Korçë (53.9 %), Gjirokastrë (26.6 %) dhe Fier (15 %), me përqëndrimet në territoret e Bashkisë Kolonjë (53.9 %), Përmetit (19.9%) dhe Lushnjës (12.8 %), të sipërfaqes që zë ky varietet.

### 5.3.2 VLERËSIMI I NDËRVEPRIMIT TË VARIETETEVE TË HARDHIVE ME MJEDISIN

Është i njohur fakti se zhvillimi periodik i bimëve ka një varësi të ngushtë me kushtet klimatike dhe mjedisore dhe që specie të ndryshme, por edhe varietete të ndryshme brenda të njëjtës specie kanë reagime të ndryshme ndaj të njëjtës mjedis. Kërkimet shkencore në lidhje me këtë ndërvare si të çojnë të njohja e mirë e fiziologjisë së bimës dhe e elementëve mjedisor. Proceset fiziologjike janë shumë të ndërlikuara pasi janë rezultat i bashkëveprimit të një sërë dukurish fizike, kimike, biologjike etj, janë procese jetësore nëpërmjet të cilave bimët rriten dhe zhvillohen gjatë gjithë ciklit jetësor të tyre. Në drufrutorët dhe në veçanti tek hardhia, studimet eksperimentale për të kutuar mekanizmat fiziologjike, nënkupton që fazat e ndryshme të zhvillimit të hardhisë, nga çelja e sythave deri në vjelje.

Në secilën prej këtyre fazave mjedisi ka një veprim të veçantë, prandaj vëzhgimi i fenologjisë kur synohet të përcaktohen zona homogjene për kultivim, shërben si tregues i drejtpërdrejtë i përshtatjes së varietetit me mjedisin.

Te hardhia, fazat fenologjike si çelja e sytheve, lulëzimi, formimi i frutit dhe pjekja varen ngushtë nga temperatura, drita, lagështia e tokës dhe struktura gjenetike e varietetit. Vëzhgimi i këtyre fazave është thelbësor për të kuptuar përshtatjen e varieteteve në mjediset të ndryshme. Fenologjia është ‘sensore’ natyrale e ndryshimeve midis mikrozonave më të ngushta, por edhe për ndryshimet klimatike. Vëzhgimi shumëvjeçar i fazave fenologjike ndihmon të kuptohet nëse një zonë po ndryshon, po bëhet më e ngrohtë, më e thatë apo më e lagësht — dhe si ndikon kjo në pjekjen e rrushit.

|                                                                                  |                   |                                                             |       |           |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|
|  | Document<br>Name: | Raport: Percaktimi i Zonave te Prodhimit te Rushit per Vere | Page: | 41 of 160 |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|

Fazat fenologjike ndryshojnë edhe në distanca të vogla për shkak të mikroklimës. Vëzhgimi i kalimit të fazave fenologjike të varieteteve të hardhisë përbën bazën shkencore për klasifikimin e zonave të kultivimit, përcaktimin e mikrozonave për verëra të origjinës së mbrojtur dhe zhvillimin e një vreshtarie të qëndrueshme e cilësore.

Fenologjia bashkon biologjinë e bimës me gjeografinë e prodhimit, duke krijuar urën midis natyrës dhe cilësisë së verës.

Për këto arsye vëzhgimi i fazave kryesore fenologjike, si çelja e sythave, lulëzimi, fillimi i pjekjes dhe pjekja e plotë, kanë qenë aktiviteti kryesor në terren për vlerësimin agronomik dhe realizimin e studimit.

### 5.3.3 ÇELJA E SYTHAVE

Çelja e sythave është një fazë vendimtare e ciklit të rritjes së hardhisë. Së bashku me lëvizjen e lëngjeve/lotimin, ajo shënon fillimin e sezonit të ri vegjetativo-prodhues dhe na paraqet një sërë sythash që hapen dhe lastarë që zgjaten. Kjo fazë ndikohet dhe kontrollohet nga stimuj të jashtëm dhe të brendshëm. Ndër faktorët e jashtëm ndikimin më të madh e ka tempetarura.

Sythat për të ndërprerë gjendjen e tyre të qetësisë dimërore kanë nevojë të marrin një sasi të caktuar temperaturash të ulëta, ka është quajtur „nevojë për ftohtësi“ dhe llogaritet si shumë tepmeratuash në orët me temperaturën minimale nën + 7° C. Niveli optimal për këtë shumë temperaturash ndryshon në kultivarë të ndryshëm. Arritja e temperaturave të nevojshme bën që të ndryshojnë proceset biokimike dhe biologjike që lidhen me daljen e sythit nga qetësia, duke bërë që qetësia e brendshme të hyjë në një fazë që quhet „pas gjumit“, ku sythi nëse ka kushtet e duhura mund të çeli normalisht. Në kushtet e vendit tonë nevoja për ftohtësi të dimrit plotësohet në kultivarët e përhapur, ndërkoh që periudha pas gjumit, që njihet dhe si qetësi jo e detyrueshme zgjat në varësi të kushteve mjedisore me ndikimin më të madh të temperaturave.

Nëse lëvizja e limfës dhe lotimi varen nga temperatura e tokës, çelja e sythave varet me shumë nga ecuria e temperaturës së ajrit. Shumica e autorëve janë të mendimit se çelja e sythave fillon në pranverë kur temperatura mesatare e ajrit stabilizohet në 10oC. Rritja e temperatures së ajrit përshpejton çeljen e sythave.

Nevoja për dritë dhe ngrohtësi është e ndryshme në kultivarë të ndryshëm. Sipas disa studiuesve të hardhisë (Huglin, Negerul, etj), koha e çeljes së sythave është karakteristikë me bazë gjenetike. Është vërtetuar se kultivarët me origjinë nga vendet më të ftohta (gjerësi më të madhe gjeografike) çelin sythat në temperatura më të ulta, 4-5 oC. Ndërsa kultivarët me origjinë nga vendet e Mesdheut i çelin sythat kur temperatura arrin 9-10oC.

Krahas këtyre faktorëve, në kohën e çeljes së lastarëve ndikojnë edhe ndërhyrjet agronomike. Disa nga këto praktika ndikojnë në krijimin e kushteve të favorshme për rritjen e temperturës (kullimi, punimi i tokës etj), të tjera në faktorët që lidhen me natyrën fiziologjike (koha dhe mënyra e krasitjes, trajtime kimike për kalimin e qetësisë dimërore etj).

Të dhënat e regjistruara në parcelat e zgjedhura si parcela eksperimentale na kanë dhënë rezultate ineresante. Nga krahasimi i datave të çeljes së varieteteve të ndryshme, në të njëjtën zonë, rezulton së ekziston një lidhje e fortë midis kohës së çeljes dhe varietetit. Me sa duket kjo është karakteristikë e lidhur me bazën e trashëgueshme.

Nga varietetet e vrojtura i pari që ka filluar çeljen e sythave ka qenë Perla Csaba, i cili njihet si varietet me çelje dhe pjekje të hershme. Në Vlorë, ky varietet çeli në periudhën 10-15 mars, duke pasur ndryshime në 2-4 ditë me kohën e çeljes në sarandë, Fier, Lushnje, Kavajë Durrës etj, ndërsa në kjo diferencë rritej në 5-8 ditë krahasuar me Vlorën në Berat, Tiranë, etj.

Nga varietetet autoktone me çelje më të hershme rezulton të jetë Sheshi i bardhë, i cili në zonën e Sarandës, këtë vit çelja ka ndodhur në 12-20 mars, duke pasur ndryshime në 2-4 ditë me kohën e çeljes në Vlorë, Fier, Lushnje, Kavajë Durrës etj, ndryshime me rreth 5-8 ditë me zonat e Gjirokastrës, Përmetit, Beratit, Peqinit, Tiranës Kurbinit dhe Shkodrës. Me diferenca më të larta me kohen e çeljes se hardhive

krahasuar me Sarandën (10-14 ditë) kanë rezultuar zonat e Leskovikut, Librazhdit, Prrrenjasit, Matit, Burrelit, Mirditës Malësisë së Mbishkodrës etj. Në disa zona diferenca ka shkuar deri në 20 ditë më vonë (Pukë, Kukës, Has, Dibër e Korçë).

Për shkak të faktorëve që përmendëm më lartë në të njëjtën zonë ka pasur diferenca në çeljen e hardhisë edhe me disa ditë diferencë. Kjo më shumë e ndikuar nga pozicioni i vreshtit, duke u vonuar në fundet e shpateve, në kundërtimet nga veriu apo në zona ku ka qarkullim të vogël të ajrit për shkak të konfigurimit të terrenit. Ajo që është vërejtur është se lloji i tokës ka ndikuar më pak në afatet e çeljes se lastarëve. Me sa duket ndikim më të madh në çeljen e hardhisë ka temperatura e ajrit, sesa ajo e tokës.

Me një diferencë 4-5 deri një javë më vonë janë në çelje pothuajse shumica e varieteteve të tjera, duke i renditur Debinë e bardhë, Shesh i zi, Kallmet, Serinat, dhe duke përfunduar me Vloshin që ka pasur çeljen më të vonuar, në dhjetëditshin e fundit të marsit.

Krahasuar me vitet e mëparshme çelja e hardhive ka qenë me gati dhjetë ditë më herët. Kjo u ndikua nga një fillim i hershëm i rritjes së temperaturës, por u shoqërua më pas me ngrica të vonshme me disa gradë nën zero (2-4 °C) në fillim të muajit prill, duke rezultuar fatale për disa zona dhe disa nga varietetet më të ndjeshme.

Nga vëzhgimet u konstatua se më të dëmtuar kanë qenë varieteti i Sheshit të bardhë (që ishte dhe në një fazë më të avancuar, Sangiovese, Vranac, etj).



*Vreshta të dëmtuara nga ngricat e 6-7 Prillit 2025*

Ky fenomen natyror që po ndodh me frekuenca gjithmon e më të shpeshta në vitet e fundit janë pasojë e ndryshimeve klimatike, ndaj të cilave duhet të mbrohet prodhimi në zonat e kultivimit duke përmirësuar praktikatat agronomike.

#### 5.3.4 LULËZIMI

Disa ditë pas çeljes së sythave, kur lastari i ri arrin në 8-10 cm gjatësi, mbi të dallohen qartë 5-6 gjethe të vogla dhe lulërit në trajtë topthi e me ngjyrë të gjelbër. Me avancimin e rritjes së lastarëve këto lulëri

|                                                                                  |                |                                                             |       |           |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|
|  | Document Name: | Raport: Percaktimi i Zonave te Prodhimit te Rushit per Vere | Page: | 43 of 160 |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|

vazhdojnë rritjen deri sa lulet arrinë zhvillimin e tyre të plotë të gjithë elementëve duke kaluar në fazën e rëndësishme edhe sa i takon prodhimit, që është faza e lulëzimit. Kjo është një fazë jashtëzakonisht e ndjeshme, që zakonisht ndodh gjatë muajit maj, në varësi të varietetit të zonës dhe kushteve klimatike. Lulëzimi fillon me hapjen e petlave të lules dhe mbaron me përfundimin e pllenimit, proces që shoqërohet me fillimin e rritjes së mureve të vezores e cila shndërrohet në frut.

Fillimi i fazës së lulëzimit konsiderohet momenti kur në mbi 25% të bimëve të një kultivari, kanë çelur më shumë se 5 % e luleve. Lulëzimi i plotë është kur mbi 80 % e luleve kanë çelur.

Koha e lulëzimit është e ndryshme në kultivarë të ndryshëm. Ajo madje ndryshon edhe brenda bimëve të njëjtë kultivar, po kështu, është e ndryshme edhe për lulëritë e së njëjtës bimë në varësi të pozicionit të lulërisë, etj.

Faza e lulëzimit është shumë e shkurtër, në varësi të temperaturës së ajrit ajo zgjat 4-5 ditë deri në një javë për secilën lule individuale, por vazhdon për një periudhë më të gjatë në të gjithë vreshtin, pasi lulet nuk hapen njëkohësisht. Suksesi i lulëzimit varet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë temperaturën, lagështinë dhe erën, të cilat të gjitha mund të ndikojnë në fekondim dhe për këtë arsye në sasinë dhe cilësinë e të korrave.

Në temperaturë 25-30°C, lulëzimi kryhet me shpejtësi. Rënia e temperaturës në kohën e lulëzimit shoqërohet me anomali në pjalmim dhe pllenim sepse formohet pjalm me fertilitet të ulët, përpasojë lidhin më pak kokrra, veshulet kanë pjekje jo uniforme dhe shqetësime të tjera që ndikojnë negativisht në sasinë dhe cilësinë e prodhimit.

Edhe erërat e ngrohta dhe lagështira e ulët e ajrit prishin shtratin fiziologjik të mbirjes së pjalmmit, për pasojë pengojnë pllenimin dhe lidhjen e frutave. Temperaturat mbi 30°C japin të njëjtin efekt.

Moti me shira dhe lagështirë të lartë ajrore sjell shpëlarjen e krezës së pistilit dhe uljen e përqëndrimit të enzimave që ndikojnë në mbirjen e pjalmmit dhe rritjen e mëtejshme të gypit pjalmik, përpasojë nuk kryhet pllenimi.

Rezultatet e marra nga monitorimi i vreshtave të përzgjedhura, përperiudhën e lulëzimit evidentuan faktet shkencore të përmendura më lartë. Për të njëjtat kushte ambientale ecuria e lulëzimit ka qenë e tillë: varieteti Perla Csabaka qenë i pari në lulëzim, në periudhën 27 prill deri 3 -4 maj në zonën e Vlorës, (3-5 ditë pas rrushit Çelek) nga kultivarët e hardhisë së butë europiane. Me tre-katër ditë më pas kanë lulëzuar Sulltanina e bardhë dhe Kardinal. Me nga një ditë diferencë kanë vijuar Traminer gri, Korith i bardhë, Madled Blland dhe pas tyre Panse Prekoce, Dimjat, Shasella d'ore dhe Stambollesh, që lulëzimin e plotë e kryen në datat 7-8 maj.

Në lulëzim të plotë në datën 10 maj në zonën e Vlorës kanë qenë varietetet Kallmet, Debinë e bardhë, Debinë Përmeti, Alikote, Pino gri, Syrah, Pulës etj. Me dy deri tre ditë diferencë kanë avancuar me lulëzimin varietetet Shesh i bardhë, Shesh i zi, Debinë Leskoviku, Merlot, Kabërne Souvignon, Cërruje, Kryqëz, Ciliegio, Barbera, Trebiano, Debinë e zezë, Servant, Lambruska etj.

Në periudhën 12-16 maj kanë lulëzuar Serina e zezë, Kleret i bardhë, Mereshnik, Tajgë e zezë, të ndjekur me dy deri tre ditë diferencë nga varietetet Kotekë e zezë, Vlosh, Papaskë e zezë, Dimërak, Malvasia etj.

Duke e krahasuar me periudhën e lulëzimit të raportuar në vite, rezulton se lulëzimi i vreshtave për vitin 2025 ka qenë me rreth 10-15 ditë më i hershëm, fakt që tregon jo vetëm se si po ndryshon klima, por edhe nevojën imediate për të marrë masa dhe për të reaguar me praktika agronomike që zbusin efektet negative të këtyre ndryshimeve.

Kur krahasojmë periudhën e lulëzimit të vreshtave në zona të ndryshme të vendit, nga të dhënat e vreshtave eksperimental, rezulton se lulëzimi nuk ka ndjekur të njëjtën distancë kohore në diferenca midis zonave të ndryshme, krahasuar me kohën e çeljes së lastarëve. Me sa duket koha e lulëzimit është ndikuar më shumë nga regjimi i temperaturës. Duke qenë faktori me ndikim më të madh në zhvillimin e faktorëve fiziologjikë të bimës, diferenca e temperatave në zona të ndryshme të vendit, për shkak të pozicionit dhe relievit, ka ndikuar në intensitetin e zhvillimit të lasatrit dhe të lulërive. Studiues të ndryshëm, në kohë të ndryshme janë munduar të gjejnë lidhjet që ekzistojnë midis variablave që ndikojnë në lulëzim, duke analizuar të dhëna për 20 vite rresht monitorime të kohës së lulëzimit. Sipas raportimeve ata kanë gjetur korrelacione që marrin për bazë shumën temperatave mesatare mbi 15 °C (Einkler), të

tjerë i referohen temperaturave maksimale (Huglin), por që në thelb korrelacioni na jep një datë të përafërt dhe kërkon validime dhe korrigjime.

Nga analiza e vrojtimeve në të gjitha vreshtat eksperimentale, lulëzimi i vreshtave ka ndodhur afërsisht në një periudhë rreth 48-60 ditë pas çeljes së sythave. Duke krahasuar p.sh. dy varietetet më të përhapura të Sheshit, në zonën e ulët deri 300 m mbi nivelin e detit, diferenca në kohën e lulëzimit ka qenë 3-4 ditë (12-15 maj), e cila krahasuar me lulëzimin në zonat më të ftohta ku çelja e sythave ka pasur një diferencë deri 25 ditë, lulëzimi i tyre ka ndodhur jo më vonë se 20 ditë diferencë (28-30 maj në Kukës). Si fazë e rëndësishme që lidhet me drejtëpërdrejtë me prodhimin, në aspektin praktik është e nevojshme të njihet koha kur lulëzimi ndodh, për çdo varietetet dhe në çdo zonë kultivimi, pasi kjo fazë përkon me fazën kur shumë sëmundje shkaktojnë dëme të mëdha (vrugu, hiri) dhe duhen monitoruar e kontrolluar.

### 5.3.5 FILLIMI I PJEKJES

Është faza kur kokrra e rrushit është rritur dhe fillon të ndryshojë ngjyrën tek kultivarët që përmbajnë antociane (tek kultivarët e zi) në cipën e kokrrës ose me zbutjen e kokrrës tek kultivarët që përmbajnë flavone (tek kultivarët e bardhë). Për rrushin e kuq kjo është e lehtë për t'u vënë re, ndërsa për rrushin e bardhë, megjithëse dhe në ta ndodh ndryshimi i ngjyrës, ka edhe një ndryshim në fortësi, në një gjendje të re më të butë. Dallimi në praktikë i kohës e fillimit të pjekjes është bërë në kokrrat e fundit të bistakut, të cilët sipas literaturës (Carbonneau, A., 1999) janë treguesit më të mirë të fillimit dhe fundit të fillimit të pjekjes (véraison), gjë që na lejon të marrim datën e mesme.

Kohëzgjatja e periudhës së lulëzim- fillim i pjekjes, sipas studiuesve, është qartësisht më pak e ndjeshme ndaj klimës sesa periudha e shpërthimit të sythave dhe lulëzimit. Kjo fazë zakonisht ndodh 30-70 ditë pas lulëzimit (në varësi të kultivarit, kundrejtimit dhe zonës së kultivimit). Përpjekjet për ta lidhur kohën e pjekjes me një datë fikse pas lulëzimit ka dështuar në shumicën e rasteve. Kjo pasi periudha e rritjes së kokrrës krahas regjimit të temperaturave, ndikohet shumë edhe nga niveli i lagështisë.

Temperatura luan një rol të rëndësishëm në rritjen dhe zhvillimin e kokrrave. Studime të hershme kanë treguar se temperaturat e larta gjatë fazës së rritjes së kokrrave, kishin një efekt depresiv me një reduktim të numrit të farave. Klieëer dhe Lider (1968) zbuluan gjithashtu se diferenca shumë të larta të temperaturave (30° ditë/15° natë) kishin një efekt negativ në krahasim me regjimin termik më të butë (20° ditë/15° natë). Duke krahasuar një numër të madh regjimesh termike të aplikuara në varietetin Cabemet-Sauvignon është vërejtur se regjimi 25° ditë/20° natë jep kokrra më të mëdha, se regjimi 35° ditë/30° natë. Ndikim të madh në proceset e rritjes së kokrrave dhe fillimin e pjekjes ka lagështia. Studime të bëra për ndikimin e lagështisë konvergojnë drejt disa pikave:

- Midis lulëzimit dhe lidhjes së frutave, thatësira zvogëlon numrin e kokrrave për shkak të efektit negativ në pllenim, duke ulur dhe rendimentin, por pa pasur ndikim në ndryshimin e përmbajtjes së sheqerit.
- Pas lidhjes së frutave deri në fillim të pjekjes, mungesa e lagështisë ndikon negativisht në shtimin qelizor dhe rritjen e kokrrave, duke zvogëluar peshën e kokrrave dhe rendimentin.
- Gjatë pjekjes, efektet e thatësirës ndihen menjëherë pas periudhës së fillimit të pjekjes me zvogëlim të peshës së kokrrave, zvogëlim i sheqerit, pastaj thatësira ka një efekt pozitiv për rritjen e sheqerit.
- Prania e lagështirës ajrore në nivele optimale gjatë fazës së rritjes së kokrrave dhe pjekjes, sjell rritjen e rendimentit, shoqërohet me një pamje më të mirë organo-leptike të rrushit, përmbajtje të lartë të sheqerit, ngjyrës, puhizës dhe aromave të veçanta.

Për të evidentuar ndikimin e këtyre parametrave të klimës në këtë studim do të duheshin të dhëna të viteve të përparshme, për të bërë krahasimet dhe për të përcaktuar ndoshta edhe për shkallën e ndikimit të tyre. Prandaj në përgjithësi studime të kësaj natyre zgjasin për periudha mbi tre vjeçare.

Nga vëzhgimi në terren fillimi i kohës së pjekjes për varietetin Shesh i zi, rezultoi se në zonën e Konispolit, Finiqit dhe Delvinës, fillimi i pjekjes ishte në 10-15 korrik, në zonën e Vlorës (Dukat fushë, Panaja,

|                                                                                  |                   |                                                             |       |           |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|
|  | Document<br>Name: | Raport: Percaktimi i Zonave te Prodhimit te Rushit per Vere | Page: | 45 of 160 |
|----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|

Trevllazër, Bishan), në datat 11-18 Korrik, në zonën e Fierit, Roskovecit, Divjakës Lushnjës, Patosit, etj kishte një diferencë 2-3 ditë më vonë nga rajoni i Vlorës. Në zonën e Përmetit, Gjirokastrës, Tepelenës, Mallakastrës, Poliçanit, Elbasanit, Tiranës, Kurbinit, Malesisë së madhe, etj, pjekja filloi rreth datave 17-25 korrik. Fundi i korrikut dhe fillimi i muajit gusht ishte periudha e fillimit të pjekjes për rajonet e Kukësit, Dibrës, Pukës dhe Korçës për varietetin Shesh i zi.

Vlen të theksohet se fillimi i pjekjes, sikurse edhe pjekja e plotë më pas, edhe brenda të njëjtës zone klimatike ka pasur diferenca. Në vreshtat e ngritur në toka skeletike, ranore, me ekspozicion nga jugu, juglindja dhe jugperëndimi, dhe me pak ngarkesë prodhimi fillimi i pjekjes ka qenë më i hershëm se në toka argjilore, toka të thella, me kundrejtje nga veriu, në vreshta me prodhim të lartë dhe zhvillim vegjetativ të fuqishëm. Diferencat midis tyre kanë qenë deri në 7-8 ditë nga njëra tjetra.

Pjekja karakterizohet nga ndryshime të thella biokimike që ndodhin në përmbajtjen e kokrës, nga të cilat më të verifikueshme janë rritja graduale e përmbajtjes së sheqerit dhe zvogëlimi i përmbajtjes së acideve. Këtë e ka trguar edhe analiza kimike e frutave, e bërë në fillim të pjekjes deri në pjekjen e plotë.

Grumbullimi i sheqernave është procesi më i rëndësishëm i pjekjes së rrushit. Kjo jo vetëm sepse sheqeri është baza nga ku rrjedh alkoli, por edhe pse me sheqernat e prodhuara nga procesi fotosintetik, varet edhe formimi i shumë komponentëve të tjera që lidhen me cilësinë, si polifenolet, antocianinat, taninat etj. Disa aroma nuk akumulohen në kokërr nëse niveli i sheqerit në kokërr nuk arrin një shkallë të caktuar sheqeri.

Periudha e pjekjes luan kështu një rol të rëndësishëm në akumulimin e sheqernave. Në kohën e fillimit të pjekjes në kokërr fillon të rritet niveli i sheqerit, në të njëjtën kohë, aciditeti, i cili ishte në maksimum, ulet me shpejtësi. Studimet kanë treguar se format e sheqernave që depozitohen në frut janë glukozë dhe fruktozë, ndërsa sakaroza është forma e transportit të sheqernave të prodhuara nga fotosinteza drejt organeve në rritje dhe për në fruta.

Në fillimet e pjekjes përmbajtja e sheqernave në frut është në nivelet e 50-60 gr/litër, ndërsa ajo e aciditetit 25-30 gr/litër. Me avancimin e pjekjes, kur fillimi i pjekjes është në 50% e bistakëve përmbajtja e sheqerit arrin në 100-115 gr/litër ndërsa aciditeti 18-20 gr/litër. Në pjekjen e plotë (pjekjen fiziologjike) niveli i sheqerit shkon 210-215 gr/litër, ndërsa aciditeti 5-7 gr/litër, ndërkohë që me kalimin në tejpkje sheqeri mund të arrijë 230-260 gr/litër, dhe aciditeti mund të ulet deri në 2.5-3 gr/litër.

Në fillimet e pjekjes, ritmet e grumbullimit të sheqernave janë të larta. Ato mund të arrijnë deri në 80 gr/litër në një javë. Kjo zgjat për rreth 15 ditë, duke filluar uljen e ritmit dhe grumbullimit gjithnjë e më pak deri në përfundim të pjekjes. Rritja ose pakësimi i ritmit të grumbullimit të sheqerit ndikohet nga luhatjet e temperaturës. Në zona me luhatje më të madhe të temperaturës ditë-natë, ka grumbullim më të madh të sheqerit në kokërr. Për këtë arsye kodrat, ku luhatjet e temperaturave janë më të larta, janë më të favorizuara se fushat.

Temperaturat e larta kanë ndikim pozitiv në rritjen e sheqerit, por është i njohur mirë fakti se potenciali aromatik i shumë varieteteve të rrushit, përgjithësisht i rrushit për verë të bardhë, kërkon një klimë të ftohtë dhe të butë me pjekje të ngadaltë. Për këto varietete rrushi, temperaturat e larta kanë një efekt të negativ në përmbajtjen e linaloolit, një përbërës i aromave.

Krahas temperaturave, reshjet gjatë periudhës së pjekjes ndikojnë negativisht në grumbullimin e sheqernave dhe cilësinë e verës. Po ashtu ato vonojnë edhe pjekjen. Thatësira deri në nivele të pranueshme ndikon në përmirësimin e cilësisë. Nga ana tjetër temperaturat shumë të larta të shoqëruara me mungesën e lagështisë në këtë fazë, ndikojnë negativisht në formimin e komponentëve të aromave, duke ndikuar negativisht në cilësinë e verës.

Roli i gjethes në procesin e pjekjes është i rëndësishëm. Gjethja është organi më i rëndësishëm i bimës për sintetizimin e lëndës organike të domosdoshme për rritjen, zhvillimin, frutifikimin, si dhe të proceseve biologjike e fiziologjike të lidhura me to. Sipërfaqja gjethore e vreshtit duke filluar me fillimin e vegjetacionit vjen duke u rritur në mënyrë progresive deri në momentin e pjekjes. Në fazat e para kur lastarët dhe gjethet janë ende të pazhvilluar mirë raporti midis sasive të lëndëve organike të prodhuara dhe atyre që konsumojnë për zhvillimin e tyre, është në favor të konsumit. Nëpërmjet ndërhyrjeve agroteknike të rrallimit të lastarëve, të gjethëve dhe sjetullorëve, mbahet nën kontroll ekuilibri midis vegjetacionit dhe prodhimit cilësor. Ndërhyrjet e bëra më menaxhimin e vegjetacionit, krahas krijimit të

|                                                                                  |                |                                                             |       |           |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|
|  | Document Name: | Raport: Percaktimi i Zonave te Prodhimit te Rushit per Vere | Page: | 46 of 160 |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|

kushteve më të mira për ajrosjen dhe parandalimin e sëmundjeve, kanë në thelb ekspozimin më të mirë të masës vegjetative ndaj ndriçimit diellor. Intensiteti i ekspozimit të gjethëve madje dhe i bistakëve të hardhisë ndaj rrezeve të diellit, ka treguar për ndikimin e dukshëm të saj në përbërjen e një sërë komponentësh të frutit si përmbajtja dhe llojet e sheqernave, acideve, dhe të metabolitëve dytësor që ndikojnë në shijen, ngjyrën dhe aromat e verës.

Studimet kanë treguar se sipërfaqja e gjethëve për njësi të masës së frutave është më pak e rëndësishme sesa fotosinteza totale, e cila varet shumë nga rrezatimi lokal. Brenda parametrave normal, sipërfaqja e gjethëve mund të jetë më e vogël në vendet ku rrezatimi diellor është i lartë, gjë që është e dobishme edhe për uljen e transpirimit që lidhet me rreziqet në rritje të thatësisë, ndërsa në zona me intensitet më të ulët të ndriçimit dhe rrezatimit, sipërfaqja gjethore, në raport me prodhimin duhet më e lartë. Gjithashtu mund të ketë edhe distanca të ndryshme mbjellje dhe sisteme të mbajtjes së vreshtave në funksion të arritjes së intensitetit të ndriçimit.

Intensiteti i ndriçimit ndikon përveç arritjes së niveleve të sheqerit edhe në nivelin e aciditetit, madje edhe të raporteve midis acideve. Kështu nëse acidi tartik ndikohet pak nga temperatura; dhe nga drita, acidi malik është shumë më i ndjeshëm si ndaj temperaturës ashtu edhe ndaj dritës. Studimet tregojnë se ekspozimi në diell i bistakëve dhe mushti i rajoneve të nxehta janë shumë më pak të pasura me acid malik sesa bistakët në hije dhe mushti i rajoneve të ftohta. Kjo për shkak të stimulimit të enzimës së degradimit të acidit malik nga nxehtësia. Ndikimi i energjisë në acidin tartik nuk është zbuluar.

Acidet organike kontribuojnë ndjeshëm në përbërjen, stabilitetin mikrobiologjik dhe kimiko-fizik, si dhe cilësitë shqisore të të gjitha verërave.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm, që është matur gjatë analizave tona të rrushit është pH- shi. Ai është një tregues pa dimensione dhe shpesh duket abstrakt dhe teorik pasi përcaktohet matematikisht si logaritmi negativ me bazën 10 të përqendrimit të joneve të hidrogjenit të shoqëruara me molekulat e ujit:  $\text{pH} = -\log_{10} [\text{H}_3\text{O}^+]$

pH luan një rol themelor në prodhimin e verës, gjithashtu për qëllime të përzgjedhjes mikrobike gjatë fermentimit alkoolik, pasi majat përshtaten dhe funksionojnë më mirë rreth një pH prej 3, ndërsa bakteret lulëzojnë kryesisht rreth një pH prej 4. Kështu, në një musht me aciditet të lartë dhe një pH të ulët rreth 3, majat do të favorizohen gjatë procesit të fermentimit, ndërsa në një pH të lartë, për shembull, bakteret e acidit laktik, bakteret e acidit acetik dhe familje të tjera që përzihen me majat do të favorizohen. Kështu, fermentimi nuk do të jetë "i pastër", me rrezikun fillestar të fermentimeve të përziëra të majasë dhe baktereve, duke rezultuar në verëra përgjithësisht "të pista", me efekte qartësisht negative në cilësi dhe finesë ekspresive. Ky rrezik, i cili në vitet veçanërisht të nxehta, me pH që tenton drejt vlerave të larta, çon në mënyrë të pashmangshme në një ulje të cilësisë së aromave. Mushtrat e rrushit me pH të ulët dhe aciditet të lartë total garantojnë pastërtinë e fermentimit duke ruajtur një aftësi të theksuar natyrore për t'i bërë ballë kohës.

Krahas elementëve të klimës që përmendëm më lartë në raportin e grumbullimit të sheqerit dhe afatet e pjekjes ndikojnë edhe ngarkesa e prodhimit dhe cilësitë e varietetit. Në vreshta me ngarkesë të madhe, sasia e sheqerit të grumbulluar është e ulët, ndërsa niveli i aciditetit ngelet i lartë. Raporti i ngarkesës së prodhimit me cilësinë, ndryshon në varësi të zonës së kultivimit. Në zona të nxehta, rendimente më të larta se në zona më të ftohta janë të pranueshme, pasi arrijnë parametrat e cilësisë, dhe e kundërta.

Ravaz, propozoi një indeks që njihet dhe përdoret gjerësisht si Indeksi Ravaz, i cili është një tregues orientues për ngarkesën gjatë krasitjes llogaritet si raport midis peshës së prodhimit në momentin e vjeljes dhe peshës së drurit të larguar me krasitjen dimërore për bimë. Një raport afër 5 tregon një ekuilibër të mirë, ndërsa vlera më të larta (> se 8) tregojnë një prodhim të lartë ose një ngarkesë të sythave më të lartë, sikurse vlera më të ulta tregojnë vegjetacion të tepërt ose ngarkesë të ulët (Poni 2007). Për çdo zonë është mirë të gjendet raporti optimal midis rendimentit dhe cilësisë më të mirë të arritura.

### 5.3.6 PJEKJA E PLOTË

Është faza ku përqindja e sheqerit ka arritur nivelet maksimale (pjekja fiziologjike). Në praktikë dallohet nga matjet e sheqerit në intervale kohore midis tyre, kur midis dy matjeve të fundit nuk ka më ndryshime

|                                                                                  |                |                                                             |       |           |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|
|  | Document Name: | Raport: Percaktimi i Zonave te Prodhimit te Rushit per Vere | Page: | 47 of 160 |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|

në matje. Pas kësaj faze, kalohet në tejppjekje, ku sasia e sheqerit nuk rritet si pasojë e grumbullimit nga aktiviteti fotosintetik, por vjen si pasojë e humbjes së ujit në kokërr.

Pjekja e plotë për varietetet e hershme mund të zgjasë 15-20 ditë nga fillimi i pjekjes (verasion), ndërsa për ato me pjekje të vonshme mund të zgjasë deri në dy muaj në varësi të kushteve agroekologjike.

Krahas rritjes së përmbajtjes së sheqerit dhe uljes së nivelit të aciditetit, në frutat e pjekur vrehet një farë pakësimi i lëndëve taninoze ndërsa rritet dukshëm përmbajtja e lëndëve ngjyruese të tretura në lëngun qelizor, veçanërisht në cipën e kokrrës. Nga pikëpamja morfologjike fruti i pjekur dallohet nga pamja duke marrë ngjyrën karakteristike, cipa e kokrrës bëhet më e tejdukshme, tuli zbutet dhe mbushet me lëng, bishti dobësohet dhe krijohet gjithë aromat (veçanërisht në rrushin aromatik). Në pjekjen e plotë në frenjat dhe bishtat e kokrrave nuk gjenden më shënja të amidonit dhe ndërpritet futja e sherit në kokërr.

Bimët pësojnë edhe ndryshime të tjera morfologjike dhe fiziologjike. Ndërpritet pothuajse fare rritja e lastareve dhe bëhet me shpejtësi drunjëzimi i tyre. Po kështu ndërpritet edhe rritja e sqetullorëve. Ndodh gjithashtu grumbullimi i lëndëve ushqyese nga gjethet drejt lastarëve dhe rezervave dimërore. Vazhdon diferencimi i sythave frutorë.

Pjekja e rrushit është në varësi të cilësive të trashëguara të varietetit, por ndikohet dhe nga kushtet e motit dhe të zonës ekologjike. Në zonën e ulët bregdetare (Sarandë, Vlorë, Fier etj), vrietetet Vranac dhe Debinë e bardhë, e arriten pjekjen e plotë që në 10-15 gusht, ndërkoh që këto varietete në Korçë dhe Kolonjë arriten pjekjen në fillim të shtatorit.

Varietetet si Shesh i zi, Merlot, Sangiovese, etj, arriten pjekjen në Sarandë, Delvinë, Vlorë (Dukat fushë, Panaja), Divjakë etj, në 15-20 gusht, ndërkoh që po të njëjtët varietete u poqën në një diferencë me katër pesë ditë më vonë në Berat, Fier, Mallakastër, Lushnjë, Kavajë e Durrës. Pak më vonë ishte pjekja në Gjirokastrë, Përmet, Këlcyrë, Memaliaj, Ballsh, Poliçan, Elbasan, Tiranë, Kurbin Mat, Shkodër dhe Malësi e madhe.

Në zona të tjera më lartësi më të madhe si Kolonjë, Librazhd, Prrenjas, Gramsh, Tiranë, Malësi e madhe (Zagore) etj, pjekja u bë në fillim të shataorit. Zonat më pjekjen më të vonë ishin ato të kukësit, Pukës, Dibrës dhe Korçës, ku në fakt vjelja u bë në fillim të tetorit, por pjekja nuk është se ariti nivele të larta të përqindje së sheqerit.

Nga matjet e bëra në mostrat e marra nga vreshtat eksperimentale, ka rezultuar se ka ndryshime esenciale në përmbajtjen e sheqerit dhe aciditetin e rrushit, që në kushte të një studimi më të organizuar nuk duhet të ishin. Ka ndodhur që në të njëjtën zonë të ketë rezultate të ndryshme sheqeri, 20° Brix, psh dhe 24° Brix, për përmbajtjen e sheqerit. Kjo është ndikuar nga disa faktorë, që lidhen më shumë me shërbimet në vreshta (gjendjen fitosanitare si pasojë e dëmrimit nga vrugu dhe hiri, rrallimin e tepërt të gjethëve dhe këputjen e majës së lastarit, në disa raste) me ngarkesën e lënë të prodhimit, etj. Kishte raste ku vreshtat janë vjelë edhe pa aritur pjekjen e plotë nga poseduesit e vreshtit, por mostrat janë marrë në ditën e vjeljes. Kjo nga njëra anë dhe mungesa e të dhënave disa vjeçare bën që përpunimi statistikor për një zonë të caktuar të mos japë rezultate bindëse në funksion të ndarjes zonale.

Sidoqoftë nga monitorimi i vreshtave eksperimentale, janë marrë të dhëna të rëndësishme sa i takon përshtatjes së varieteteve të ndryshëm në zonat ku janë të kultivuara. Për këtë na ka ndihmuar edhe bashkëpunimi me kantinat e verës. Nga vëzhgimi në rastet kur grupi i punës ka qëlluar të jetë prezent në kantinë kur ka ardhur rrushi për përpunim nga vreshtat jashtë vreshtave eksperimentale, por edhe komunikimi me ekspertët enologë të kantinave, është konstatuar se kantinat përpunojnë vetëm rrushin që është brenda parametrave normal për të bërë verë. Ky është dhe një tregues shumë i mirë për ambicjen e përpunuesve për të rritur cilësinë e verës.

Rezultatet e marra nga monitorimi i vreshtave të përzgjedhura, për ato pak tregues që u morën në studim, na dhanë një pasqyrë të ndryshimeve që ekzistojnë midis varieteteve që kultivohen në Shqipëri dhe sjelljes së ndryshme të tyre në raport me zonën e kultivimit. Nga rezultatet e arritura, konstatohet se kapacitetet përpunuese janë duke u rritur dhe teknologjia e kultivimit të rrushit për verë dhe e përpunimit është duke u përmirësuar ndjeshëm. Megjithatë ka një reduktim të sipërfaqeve me vreshta, interesi i kantinave, kontratat paraprake të kantinave me prodhuesit, po bëjnë që edhe fermat që nuk kanë kapacitete përpunuese, të rrisin cilësinë e rrushit, duke pasur si garanci një çmim më të lartë së vitet e mëparshme.

|                                                                                  |                |                                                            |       |           |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|------------------------------------------------------------|-------|-----------|
|  | Document Name: | Raport: Percaktimi i Zonave te Prodimit te Rushit per Vere | Page: | 48 of 160 |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------|------------------------------------------------------------|-------|-----------|

Duke ditur se cilësia është një koncept kompleks, shumica e autorëve kanë veçuar si elementë të cilësisë së rrushit, të lidhur me territorin e kultivimit përmbajtjen e sheqerit, nivelin e pH-it dhe të aciditetit. Nga rezultatet e analizave kimike të bëra në varietete të ndryshme dhe zona të ndryshme, konstatohet se nëse për zonat e ulëta dhe bregdetare përmbajtja e sheqerit nuk përbën problem për përpunimin, niveli i aciditetit mund të jetë shqetësues në disa raste për të bërë një verë cilësore, për shkak të vlerave të ulëta. Në këto raste edhe pH është më i lartë se normalja.

Ndërkohë që në rastet e kultivimit të disa varieteteve si Shesh i bardhë, Shesh i zi, Vlosh, Sangiovese, etj, në zonat malore (Kukës, Pukë, Dibër, Korçë etj, niveli i aciditetit nuk përbën problem, por përmbajtja e sheqerit është e ulët për të përfutur verë me gradë alkalike të lartë.

#### 5.4 KRAHASIMI I CILËSISË SË VERËS SË PRODHUAR NË ZONA TË NDRYSHME

Në Shqipëri janë të regjistruara mbi 70 kantina, nga të cilat më shumë se 20 janë kantina të mëdha. Disa prej tyre janë të përkushtuara për prodhimin e verës nga varietetet autoktone të rrushit si: Kallmet, Shesh i bardhë dhe Shesh i zi, Serinë, Debinë (e bardhë dhe e zezë), Pulës, Cërrujë, Vlosh etj. Me punën e tyre këto kantina jo vetëm që janë bërë faktorë në prodhimin e verës në sasi, por kanë bërë përparime në teknologjinë e përpunimit dhe prodhimit cilësor, duke fituar popullaritet për vete dhe duke konkuruar në rajon e në botë me aroma të veçanta të verërave tona.

Ashtu sikurse e kemi përmendur, në kantinat që kanë standart për prodhimin e verës, me një shpërndarje pothuajse në të gjithë vendin, kemi marrë mostra të verës së prodhuar nga rrushi vjeljeve të një viti më parë, me qëllim kryerjen e analizave kimike dhe organoleptike. Është insistuar që mostrat e verës të merren vetëm për verën e prodhuar në mënyrë sa më natyrale, dhe kryesisht për varietetet autoktone të pakubazuara.

Verifikimi enologjik luan një rol themelor në projektin e zonimit, pasi në verën e prodhuar në një zonë të caktuar dhe nga rrushi i asaj zone, jepet mundësia për vlerësimin e potencialit që ka kjo zonë brenda një territori specifik të kultivimit, për të prodhuar verë cilësore.

Për 54 kantinat e vizituara, kemi plotësuar pyetësorin dhe nga 42 prej tyre kemi marrë mostra vere. Siç u përmend më sipër, kantinat ishin të vendosura në rajone të ndryshme të Shqipërisë si më poshtë: Tirana (n=4), Durrësi (n=10), Korça (n=5), Fieri (n=3), Lushnja (n=3), Shkodra (n=5), Rresheni (n=1), Vlora (n=8), Berati (n=7), Përmeti (n=4), Gjirokastra (n=1), Elbasani (n=4). Është synuar të merret verë për varietetet autoktone, dhe në mungesë të tyre varieteti Merlot.

Është e kuptueshme që rezultati i marrë nga krahasimi i verës së prodhuar nga vetë kantinat ka në vetëvetë edhe gabimin që mund të vijë në interpretim si rezultat i ndryshimit të teknikës së përpunimit të verës nga enologë të ndryshëm, por tentativa jonë për të bërë pjesë vetëm verat që kanë përdorur teknikat standarte të të bërit verë, mund të ishte e vetmja mënyrë për tu përafëruar sa më shumë gjendjes reale në këtë studim.

Për fermentim në të gjitha kantinat është përdorur ose rrushi i vreshtave të tyre, ose rrush nga zona përreth kantinës. Rrushi i përdorur për verë, është vjelë në kohën e pjekjes së plotë, është shtypor dhe fermentuar në tankera çeliku inoxi, për verën e bardhë në tankera me sistem ftohje, ndërsa për verën e kuqe në shumicën shumicën e rasteve mungonte ftohja e kontrolluar. Gjatë përpunimit për ruajtjen e shëndetit të fermentimit dhe të verës është përdorur sipas shëndetit të rrushit sasi standarde e dioksidit të squfurit, së bashku me një inokulum majash të zgjedhura të rehidratuara më parë.

Nga raportimet e kantinave, rrushi i përdorur për verë ka qenë në gjendje të shëndetshme, me një përmbajtje të mirë sheqeri, dhe aciditet të mirë.


Duke qenë se vera e marrë nga kantinat ishte e një viti më parë, kuptohet që ajo ka kaluar të gjitha fazat e fermentimit, kullimit, filtrimit dhe botilimit sipas procedurave standarte. Verërat deri në kohën e analizave u ruajtën në një mjedis të kontrolluar në 4°C.

Analiza sensoriale e verërave të marra nga kantinat u bë nga një panel prej pesë panilistësh profesionistë dhe një drejtues paneli edhe ky i çertifikuar. Paneli ishte i mirëtrajnuar në lidhje me funksionimin dhe vlerësimin të verërave, për elementët e pamjes, nuhatjes, aromave, shijes dhe elementëve të tjerë që mban formati i vlerësimit. Nga ana jonë është kërkuar që vlerësimi për rastin tonë të bëhej në një format

ndryshe. Panelistët u informuan për kërkesat e veçanta në lidhje me vlerësimin. Atyre ju kërkua të bëjnë vlerësim e rregullt sipas procedurës standarte, por krahas saj në një format të veçantë ju kërkua të japin vlerësime për cilësi që lidhen veçorite e rrushit të përpunuar, difekte që vijnë si pasojë e përpunimit, aftësi që mund të ruheshin nga përpunimi më i mirë, apo që mund të fitoheshin në raport me kohën e vjeljes së rrushit.

Verërat para se të çoheshin për testim, ju hoqën etiketat që kishin nga prodhuesit, u anonimizuan duke përdorur kode të paracaktuara, me qëllim që të mos jepnin asnjë informacion në lidhje me mostrat. Gjatë testimit grupit të panelit ju është dhënë vetëm emri i varietetit, për të ndihmuar grupin në evidentimin e dallimeve të mundshme që lidhen me rrushin e përpunuar, midis verërave të ndryshme në testim.

Para se të vazhdohej me vlerësimin e mostrës, u miratua metodologjia e testimit kolektiv të mostrës së parë për të gjetur një kurs të përbashkët veprimi, duke i lejuar të gjithëve të kalibronin veten.




Në çdo takim, u vlerësuan afërsisht 20 verëra, me të paktën një mostër të vlerësuar në dy kopje për të verifikuar përsëritshmërinë e gjyqtarëve dhe besueshmërinë e të dhënave të mbledhura. Pasi u mbledhën, të dhënat u përpunuan për të verifikuar qëndrueshmërinë e vlerësimit të panelit dhe besueshmërinë e gjyqtarëve, duke krahasuar vlerësimet e tyre për verën në dy kopje

## 5.4.1 REZULTATET E VLERËSIMIT

### 5.4.1.1.1. VERA NGA VARIETETI BIRVOLI


Edhe pse pak i njohur si varietet, me verën e prodhuar prej tij Birvoli dallohet për origjinalitetin dhe veçoritë unike. Është një verë tipike rozë e këtij varieteti me përhapje të kufizuar në Berat, me pamje elegante me reflektime rubin, shumë e mirë vizualisht. Vera ka aroma frutore-lulore (qershë, kumbull, fruta mali, lule të buta), e pastër dhe tërheqëse, e freskët, e balancuar, me trup të lehtë dhe aciditet të gjallë, elegante dhe me potencial për konsum të menjëhershëm por edhe vjetërimi.



Birvoli prodhon verë rozë cilësore, të freskët dhe të rafinuar, me profil aromatik frutor dhe aciditet të balancuar, e aftë për konkurrencë në kategorinë edhe në tregjet europiane.

### 5.4.1.1.2. VERA NGA VARIETETI CERRUJË

Verë e bardhë cilësore dhe e balancuar me karakteristika pozitive. Paraqitet me kthjelltësi shumë të mirë dhe shkëlqim të pastër. Ngjyra është e gjelbër e çelët me nuanca ari dhe kashte të hapur, adekuate për varietin. Aromat janë të pastra por me intensitet mesatar, me nuanca pjeshkë dhe agrumesh. Shija është e pastër me intensitet dhe qëndrueshmëri mesatare, aciditet mesatar, e butë dhe e harmonizuar me freskie të plotë. Verë e lehtë, e freskët dhe e përshtatshme për qarkullim në treg me potencial në plakje.




#### 5.4.1.1.3. VERA NGA VARIETETI DEBINË E BARDHË

Varietetet autoktonë me potencial të lartë cilësor që shfaq dallime dramatike në punimin enologjik. Kur është i punuar profesionalisht, paraqitet me kthjelltësi të shkëlqyer, ngjyrë kashtë/ari të hapur me nuanca të gjelbërta perfekte varietore. Aromat janë shumë të pastra dhe intensive me dominim frutoro-lulor (kajsi, pjeshkë, agrume, ananas, mollë e gjelbër, vanilje). Shija është e pastër me aciditet të shprehur dhe të balancuar, trup mesatar, elegante dhe e freskët.


Kontrasti: Mosrat e punuara nga pakujdesia shfaqin defekte serioze: turbullirë, ngjyrë jo adekuate (roze/salmoni, ari e mbyllur), tone oksidative të forta, aciditet jo të harmonizuar dhe mungon sulfitimi korrekt. Këto verëra nuk kanë potencial për vjetërim dhe kërkojnë konsum të shpejtë.

Përfundimi: Debina e Bardhë mund të arrijë nivele kulminante elegancë dhe harmonie kur zbatohen procedurat enologjike të duhura, duke u bërë verë me potencial shumë të lartë për vjetërim që mund të konkurrojë edhe ndërkombëtarisht.



#### 5.4.1.1.4. VERA NGA VARIETETI DEBINE E ZEZE

Edhe pse rreth 74 % e sipërfaqes që zë ky varietet shtrihet ne territorin e Bashkisë Kolonjë dhe Përmet, vera e pergaritur më vete nga ky varietet është marrë në zonën e Beratit.



Vera e prodhuar nga varieteti Debinë e zezë është vlerësuar vizualisht e pastër, e qartë dhe teknologjikisht e punuar mirë, me ngjyrë të gjallë, të kuqe rubin e çelur, tipike për varietete të kuqe me pjekuri të mirë fenolike, me aroma frutore dhe elegante, që dominojnë aromat nga frutat e kuqe e të zeza (qersh, manaferrë, kumbull), me shije të harmonizuar, trup mesatar, aciditet i ekuilibruar, tanina të buta dhe shije e këndshme frutash.

Varieteti Debina e zezë, përfaqëson një nga varietet premtues autoktonë për të prodhuar një verë me një ekuilibër shumë të mirë mes freskisë, aromës dhe strukturës, një verë elegante dhe të lehtë për konsum, me mundësi të zhvillimit përmes maturimit të mëtejshëm.

#### 5.4.1.1.5. VERA NGA VARIETETI KALLMET

Varieteti Kallmet i vlerësuar nga mostrat e verës së marrë nga kantina me standart të ndryshëm përpunimi, tregon një elasticitet shumë të mirë enologjik, që mund të japë verëra superiore me karakter të veçantë varietor. Vera e tij, shfaq ngjyra që variojnë nga rubin e çelët në rubin të thellë e deri në nuanca vjollcë, shpesh me tonë tullë ose kafe të çelët tek verërat e vjetëruara, tregues për karakter varietal të dallueshëm dhe të qëndrueshëm.


Kompleksiteti aromatik është i lartë me aromat frutore (qershi, kumbull, manaferra, boronicë, mjedër), shpesh të shoqëruara me nuanca të frutave të thata, lisit dhe vaniljes tek verërat e maturuara.

Në disa raste shfaqen tone të lehta oksidative ose acide avulluese, që tregojnë ndjeshmëri gjatë procesit të vinifikimit, por nuk e zbehin karakterin tipik.

Shija paraqet një trup mesatar deri të plotë, me aciditet të balancuar, tanina të pranishme dhe të integruara mirë në shumicën e rasteve.

Në disa mostra vihet re astrigjencë (idhtësi) dhe taninë e papjekur, çka lidhet me momentin e korrjes ose teknikat e vinifikimit, por jo me mungesë potenciali varietal.

Në përgjithësi, vera është harmonike, me strukturë të mirë dhe qëndrueshmëri të gjatë në shije (aftertaste).



Verërat e krahasuara janë vlerësuar me një profil elegant, të balancuar dhe me potencial për vjetërim, që mund të konkurrojnë edhe me verërat evropiane.

Disa mostra kanë intensitet aromatik dhe trup të plotë, të tjera janë më të lehta dhe më të freskëta, duke treguar se varieteti i përshtaten si verërat e reja frutore, ashtu edhe ato të maturuara.

Vera e këtij varieteti përfaqëson një nga varietet më premtues autoktonë që ofron një identitet aromatik dhe strukturor që e dallon në kuadër të varieteteve vendase me vlerë oenologjike. Ai duhet të futet në skemat e cilësisë së lidhur me origjinën, për të rritur konkurrueshmërinë në tregjet e huaja.

#### 5.4.1.1.6. VERA NGA VARIETETI PULËS ZONA E BERATIT


Pulësi në krahasimin e mostrave të verës tregoi një varietet autokton i bardhë me performancë konsistente dhe cilësi të lartë. Vera e tij shfaq kthjelltësi shumë të mirë me ngjyrë që varion nga e verdhë-gjelbër në ari të çelët me shkëlqim karakteristik. Profili aromatik është i pasur dhe delikat me nota agrumesh, lulesh, frutash të bardha (mollë, dardhe, ananas), dhe karakteristika bimore të lehta.


Shija është e balancuar me aciditet mesatar që jep freskie të këndshme, trup mesatar që mund të arrijë nivele të plota, dhe harmoni të shkëlqyer midis komponentëve. Verërat më cilësore shfaqin elegancë të mrekullueshme, finesë të pastër, aromë intensive dhe strukturë të plotë të balancuar.

Pulësi ka potencial shumë të lartë për vjetërim dhe në mostrat kulminante mund të konkurrojë edhe në tregjet evropiane. Është verë elegante, e freskët, aromatike dhe harmonike që përfaqëson një nga varietetet më premtues autoktonë të bardhë.

Verërat me cilësi më të mira kanë rezultuar nga kantinat që ndodhen në zonën e Beratit, por kjo nuk do të thotë se varieteti jashtë kësaj zone nuk e ruan potencialin për të prodhuar verën tipike të tij (ngelet për një studim më të thelluar).

Vera e marrë nga kantinat jashtë zonës së Beratit, në vlerësimin e shijimit kanë rezultuar me performancë më të ulët se ato në rajonin e Beratit, megjithëse edhe në ato zona vera ka ruajtur karaktere të një vere të mirë tavoline.






#### 5.4.1.1.7. VERA NGA VARIETETI SERINË E BARDHË


Vera e testuar është prodhuar nga rrushi i prodhuar në zonën e Beratit dhe Poliçanit. Nga Serina e bardhë ka rezultuar verë e freskët dhe elegante me karakteristika të shkëlqyera. Kthjelltësia është shumë e mirë me ngjyrë ari të çelët karakteristike dhe reflektime kashte. Profili aromatik është kompleks dhe intensiv me fruta të bardha (pjeshkë, mollë e gjelbër, dardhe, limoni) të freskëta dhe të ndezura. Shija është e freskët me aciditet të shprehur. të balancuar në mënyrë perfekte, trup mesatar me dominim frutor dhe harmoni të shkëlqyer. Verë freskuese me karakter të qartë, cilësi të larta, elegancë të veçantë dhe potencial për maturim.

Serina e bardhë ka potencial për vjetërim dhe mund të konkurrojë edhe në tregjet evropiane. Është verë elegante, e freskët, aromatike dhe harmonike që përfaqëson një nga varietet premtues autoktonë të bardhë.



#### 5.4.1.1.8. VERA NGA VARIETETI SERINE E ZEZE

Vera e testuar është prodhuar nga rrushi i prodhuar në zonën e Beratit dhe Poliçanit, ku ky varietet ka rreth 12.9 % të sipërfaqes në shkallë vendi.



Vera e prodhuar nga varieteti Serina e zezë ka një profil të mirëbalancuar midis elegancës dhe intensitetit, me ngjyrë të kuqe rubini të thellë me reflektime vjollcë, me aroma me intesitet të lartë, të pasura, të koncentruara dhe komplekse, me nota të frutave të kuqe e të zeza (qershi, vishnje, boronicë, shegë), të kombinuara me nuanca vaniljeje dhe nuanca minerale.


Shijet variojnë nga trup mesatar në të plotë, me freski dhe aciditet të mirë, tanina të buta e të integruara, me shije harmonike dhe strukturë të kënaqshme.

Për të prodhuar verë të mirë, me harmoni ndërmjet aromës dhe shijes, kërkon aftësi teknike dhe kujdes gjatë vinifikimit.


Serina e zezë ka potencial për verë cilësore, elegante, me karakter frutor, me aftësi të mira për vjetërim dhe mund të konkurrojë denjësisht edhe në tregjet evropiane.

#### 5.4.1.1.9. VERA NGA VARIETETI SHESH I ZI


Duke qenë se është varieteti autokton me sipërfaqen më të madhe dhe i përhapur në të gjithë vendin, Sheshi i zi gjendet sin ë gjendje monovarietale, por edhe i kupazhuar në shumë marka vere.



Varieteti shfaqet me performancë të larmishme dhe potencial të madh cilësor. Në përgjithësi karakterizohet nga ngjyra rubin intensive dhe e thellë me nuanca bordeaux. Profili aromatic dominohet nga frutat e zeza dhe të thata (kumbull, qershi, manaferra) të shoqëruara me nota vaniljeje dhe barikimi. Struktura është e plotë me tanina të shprehura që variojnë nga të buta deri të theksuara.



Në rrushin e prodhuar në zonat më të nxehta, ku pjekja bëhet që në muajin gusht, në vreshta me rrush jo të shëndetshëm të marrë nga vreshtarë të zonave (jo rrush i pronarëve të kantinave) ku aciditeti rezulton i ulët dhe pH i lartë, vera ka treguar intensitet dhe tonalitet më të ulët të aromave dhe të harmonisë së shijes, në më shumë rastë se në zonat më të freskëta.




Difektet e shfaqura në mostrat gjatë shijimit lidhen me cilësinë e rrushit të përpunuar, por edhe me cilësinë e përpunimit. Disa mostra shfaqin probleme me oksidimin dhe aciditet të pabalancuar (tepër i lartë ose i ulët) që kërkojnë ndërhyrje enologjike. Kur është i punuar mirë, Sheshi i Zi arrin kulmin e formës duke u bërë verë elegante, harmonike me potencial të lartë për maturim. Moshat e avaruara tregojnë zhvillim drejt ngjyrave kafe dhe karakteristika plakjeje.


#### 5.4.1.1.10. VERA NGA VARIETETI SHESH I BARDHE

Nga varietetet autoktone për verë të bardhë është më i përhapuri dhe me sipërfaqen më të madhe në vend. Në kantina që kanë standart të lartë teknik dhe përpunues e gjejmë me performancë të lartë pothuajse në të gjithë vendin, panvarësisht nga zona e kultivimit.

Nga mostrat e verës së krahasuara ka rezultuar rrushi i kultivuar dhe përpunuar ng kantinat në brezin më të përshtatshëm të klimës, ka numrin më të lartë të rasteve me verën më të mirë, por jo të vërtetuar statistikisht si verën më të mirë (janë të shumë variablat që duhen konsideruar).




Varietet më i kultivuar autokton i bardhë që shfaq diversitet të madh në cilësi. Në rastet më të mira paraqitet me kthjelltësi të shkëlqyer dhe ngjyrë ari të çelët me nuanca të gjelbërta karakteristike. Profili aromatik dominohet nga frutat e bardha (pjeshkë, mollë e gjelbër, dardhe), agrume dhe nota lulore. Aciditeti i theksuar jep freski dhe karakter.



Sfidat kryesore me defektet e shfaqura në mostrat gjatë shijimit lidhen me cilësinë e rrushit të përpunuar, por edhe me cilësinë e përpunimit. Shumë mostra vuajnë nga oksidimi (ngjyra intensive drejt kafesë/oranzh, tone oksiduese) defekte të përpunimit, aciditet i pabalancuar (tepër i lartë ose i ulët) defekte të aciditetit të rrushit në vjelje, por edhe defekte nga acide avulluese dhe probleme në filtrim/kthjelltësi. Disa mostra janë të turbullta dhe jo të përshtatshme për treg.




Në rrushin e prodhuar në zonat më të nxehta, ku pjekja bëhet që në muajin gusht, ku aciditeti rezulton i ulët dhe pH i lartë, vera ka treguar intensitet dhe tonalitet më të ulët të aromave dhe të harmonisë së shijes, në më shumë rastë se në zonat më të freskëta.



Si përfundim mund të themi se kur është i punuar me kujdes profesional, Sheshi i Bardhë arrin nivele kulminante duke u bërë verë elegante, e freskët, aromatike dhe e balancuar me potencial për maturim. Kërkon vëmendje të veçantë në kontrollin e oksidimit dhe balancimin e aciditetit.

#### 5.4.1.1.11. VERA NGA VARIETETI VLOSH

Vera e krahasuar është marrë nga kantina në zonën e Vlorës. Varieteti është tipik për prodhimin e verës roze.




Në përgjithësi verërat janë vlerësuar si të kthjellëta, me spektër ngjyre që varionte nga e kuqe e çelur deri vjollcë e errët, por përgjithësisht ngjyra është rubin e lehtë me reflektime vjollcë dhe me shkëlqim të mirë

Vera Vlosh është e pasur me aroma me karakter të dallueshëm varietetor, me një dominim të aromave frutore (qershi, kumbull, vishnje), me nota minerale dhe bimore. Në përgjithësi është verë e balancuar, me trup mesatar dhe me tanina të buta, aciditet të ulët deri mesatar dhe balancë të pranueshme.

Vera e Vloshit, cilësisht është e pozicionuar si verë me karakter elegant dhe të harmonizuar, që mund të konsumohet e re, por ka edhe potencial të moderuar për zhvillim në shishe. Në tregun e verës vera e Vloshit mund të gjejë vendin e vet nëse përpunohet me cilësi.

#### 5.4.1.1.12. VERA NGA VARIETETI HF KOLOR

HF Kolor është varietet që rrjedh nga kryqëzimi i varietetit Vlosh me Alikant Bouschet, me qëllim përmirësimin e cilësive përpunuese të Vloshit i cili ka tregues inferioriteti sa i takon ngjyres së tij roze.



Nga intervistat e strukturuar me kantine, janë marrë mostra nga dy kantina, njëra në zonën e Shijakut dhe tjetra në Dimal, që e kanë të etiketuar verën si Vlosh. Nga konsultimet me QTTB Vlorë është konstatuar se varieteti që këto kantina i referohen si klon i Vloshit, është në fakt HF Kolor, pasi klonet e Vloshit të përzgjedhur nga seleksionerët, nuk arrijnë të prodhojnë verë të kuqe. prodhojnë verë roze.

Vlerësimi për verën e varietetit HF Kolor treguan se ai ka një potencial të lartë për prodhimin e verërave të kuqe cilësore, me strukturë, ngjyrë të thellë dhe aromë të pasur frutore. Është një varietet teknikisht i fuqishëm, që mund të përdoret si bazë për verëra të forta të tipit rezervë, për kupazhe (përzjerje) për thellim ngjyre dhe strukturë, ose edhe verë monovarietale me karakter të theksuar, kur vinifikohet me kujdes.


Në krahasim me rrushin Vlosh, HF Kolori ka më shumë intensitet fenolik dhe ngjyrë, por kërkon më shumë kontroll në vinifikim për të shmangur oksidimin dhe për të zbutur taninat.

HF Kolori ka potencial shumë të mirë kolorimetrik, duke dhënë verëra me ngjyrë të thellë rubini dhe intensitet të lartë – tipar që i jep verës një pamje të fuqishme dhe tërheqëse.


Vera e HF Kolor është cilësore, me trup të plotë, tanina të pranishme, aromë e pasur frutore dhe potencial të madh për vjetërsim. Është konkurrense e denjë për tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Fakti që shkon mirë në zonën e ngrohtë të vendit nuk do të thotë detyrimisht se mund të jetë e përshtatshme për tu shtrirë në të gjithë vendin (duhen studime me të thelluara).

#### 5.4.1.1.13. VERA NGA VARIETETI MERLOT


Meqënëse varietetin Merlot, e gjetëm të kultivuar pothuajse në të gjithë vendin, por edhe të përpunuar si monovarietet, e përfshimë në studimin e krahasimit të cilësisë së verës, krahas varieteteve autoktone shqiptare. Për arsyt e zonës së kultimit, por edhe të përpunimit, ai shfaq cilësi shumë të larmishme në mostra. Në rastet më të mira, Merloti paraqitet me ngjyrë rubin të thellë bordeaux, aromë të pastra dhe intensive me fruta të pjekura dhe të ëmbla (boronice, manaferra, kumbull, qershi), tanina të rrumbullaksuara në mënyrë të shkëlqyer dhe balancim perfekt. Verërat cilësore janë elegante, të pasura dhe të plota me finish të mrekullueshëm dhe potencial të lartë për pjekje.




**Problematikat:** Disa mostra vuajnë nga defekte teknike (TCA nga tapa, acide avulluese), oksidim nga mosha e tepërt, ose aromë pak të mbyllura që kërkojnë ajrosje. Kur janë të pastra dhe të punuara mirë, verërat nga Merloti shqiptarë arrijnë cilësi superiore me elegancë dhe karakter të plotë.



### Merlot Kavajë -Durrës




### Merloti - Maliq, Leskovik, Përmet



#### 5.4.1.1.14. VERA NGA VARIETETI MAVRUD

Është përfshirë në studim për të përfaqësuar zonën e Leskovikut, në pamundësi për të gjetur një verë nga rrushi autokton i zonës. Varieteti Mavrud në këtë zonë ka verë superiore me karakter të veçantë varietor. Shfaq kthjelltësi të shkëlqyer dhe ngjyrë rubin shumë të thellë që tenton drejt një kuqe e errët me tone vjollcë ose kafe, me reflektime të errëta. Kompleksiteti aromatik është i lartë me fruta të pjekura të kuqe (boronice, mjeder), nota të forta nga bariku (vanilje, çokolatë), dhe elemente piperi të zi.




Trupi është i plotë me tanina të fuqishme por të integruara në mënyrë perfekte. Ekuilibri midis alkoolit, aciditetit dhe taninave është i shkëlqyer me qëndrueshmëri të gjatë.

Verë në kulmin e formës me finese perfekte dhe cilësi superiore, me potencial të lartë për vjetërsim dhe mund të konkurrojë fuqishëm edhe në tregjet evropiane

#### 5.4.1.1.15. VERA NGA VARIETETI PINO E ZEZE

Edhe kjo verë u mor në konsideratë për të përfaqësuar kantinat në zonën e Leskovikut, në pamundësi për të gjetur një verë nga rrushi autokton i zonës.



Nga Pino e zezë është prodhuar verë elegante dhe aromatike me karakter të butë. Ngjyra varion nga e kuqe e lehtë deri në rubin e thellë, tipike për varietin. Profili aromatik shfaq nuanca të qershisë, luleshtrydhe, vishnjeve dhe frutave të thata mali me kompleksitet barik. Shija është e butë me balancë të mirë, aciditet mesatar-ulët dhe tanina të buta të balancuara. Trupi i lehtë deri mesatar e bën verën elegante dhe të harmonizuar. Potencial i mirë për maturim

#### 5.4.1.1.16. VLERESIM I PERGJITHSHEM

Varietetet me cilësinë më të lartë dhe konsistente rezultuan Kallmet, Serinë e zezë, Mavrud, HF Kolor, Pulës, Serinë e Bardhë Vlosh, Debinë e zezë

Varietetet me potencial të lartë por performancë të variueshme: Debinë e Bardhë, Shesh i Zi, Merlot, Shesh i Bardhë

Sfidat kryesore për prodhimin e verës ngelen kontrolli i oksidimit, balancimi i aciditetit, parandalimi i defekteve nga acide avulluese dhe TCA, përmirësimi i procedurave të filtrimit dhe stabilizimit.

Sfidat kryesore për tregtimin e verës ngelet përfshirja në skemat e cilësisë që janë aktive në Bashkimin Evropian (BE) dhe mund të zbatohen edhe sipas ligjit shqiptar, siç janë Treguesit Gjeografikë të Mbrojtur, Emërtimi i Origjinës së Mbrojtur, termi tradicional, si dhe emërtimi i nën-zonave që mund të përmenden në etiketimin e verërave

#### 5.4.1.1.17. REKOMANDIME

- Varietetet autoktone shqiptare kanë potencial të shkëlqyer për prodhimin e verërave cilësore që mund të konkurrojnë ndërkombëtarisht kur zbatohen praktikatat enologjike profesionale dhe kontrolli i rreptë i cilësisë gjatë të gjithë procesit të vinifikimit.
- Duhet studime më të thelluara dhe në zona më të ngushta për përfshirjen e prodhuesve në skemat e Treguesit Gjeografikë të Mbrojtur, Emërtimi i Origjinës së Mbrojtur, termi tradicional, si dhe emërtimi i nën-zonave që mund të përmenden në etiketimin e verërave

## 5.5 IDENTIFIKIMI KLONEVE

### 5.5.1 HYRJE

Shqipëria falë pozicionit gjeografik, diversitetit gjeotopografik, zonalitetit vertikal dhe trashëgimisë kulturore të brezave, është sot vend origjina e mjaft kultivarëve të hardhisë të cilet në stadin e vazhdueshëm të seleksionimit natyral dhe veprimtarisë dhe aktivitetit njerëzor, janë përshtatur në mënyrë perfekte ekosistemeve konkrete të kultivimit, duke nxjerë në pah mjaft vlera prodhuese e cilësore në konkurrencën e natyrshme me mjaft kultivarë të ardhur nga jashtë.

Evoluimi në kohë i këtij numri mjaft të madh kultivarësh, ka sjellë që një pjesë e tyre me cilësi inferiore të mos i kenë qëndruar kohës dhe rjedhimisht të jenë zhdukur (ose po zhduken gradualisht), ndërsa pjesa tjetër me cilësi superiore të jetë shtuar duke u bërë premisë edhe e një efektiviteti të lartë ekonomik për mjaft vreshtarë.

Kultivarët e shumtë të hardhisë me origjinë autoktone, të evidentuar në vendin tonë karakterizohen nga një ndryshmeri e lartë, pra përfaqsohen nga popullata të cilat përmbledhin biotipe si forma të shpërbërës në kohë dhe hapësirë. Është fakt i njohur se për shkak të shtimit të gjatë dhe të pakontrolluar nga breza të tërë vreshtarësh, të ndikimit të faktorëve të ndryshëm të ambientit nga shpërndarja dhe mbjellja në teritore të ndryshme, si dhe si metodat e ndryshme të kultivimit, varietetet e rrushit me kalimin e kohës kanë pësuar ndryshime fenotipike dhe gjenotipike, të cilat kanë bërë që varietetet që ne kemi të jenë në formën e popullatave.

Tek hardhia, sikurse edhe në të gjithë drufrutorët e tjerë, ndryshimet e ndodhura në pjesë të ndryshme të trupit, të quajtura ‘mutacione gjenetike’ apo ‘shpërthime sythore’, gjatë shumëzimit vegjetativ çojnë në krijimin e variacioneve brenda varietetit, të cilat përfaqësojnë klonet apo varietetet e rinj.

Ky është një proces natyral që ka ndodhur dhe ndodh vazhdimisht në natyrë, por që seleksionimi i njeriut i individëve me karakteristika që atij i ka interesuar, dhe shtimi më pas me mënyrat vegjetative, ka bërë që sot të kemi një shumëllojshmëri kaq të madhe varietetesh hardhie.

Riprodhimi vegjetativ i bërë tek hardhia, zakonisht rezulton në pasardhës që janë gjenetikisht identikë me bimën mëmë. Por shtimi vegjetativ i përsëritur në masë, bashkë me shtimin e individëve të përzgjedhur, mund të shtojë edhe bimë që përmbajnë në vetëvete tipare dhe karakteristika të padukshme nga ana e vreshtarit, por që nuk përfaqësojnë karakteristikat më të mira të dëshiruara për varietetin.

Rruga e vetme e përmirësimit të këtyre varieteteve është çlirimi nga klonet e padëshiruara që popullatat e tyre përmbajnë, dhe shtimi i mëtejshëm vetëm i atyre kloneve që janë biologjikisht dhe ekonomikisht më të çmueshëm. Bimët e të njëjtit klon ndajnë karakteristika identike ndërsa tregojnë ndryshime të vogla nga hardhitë e një kloni të ndryshëm. Këto ndryshime midis kloneve janë përgjithësisht aq të vogla sa ato ende konsiderohen të jenë i njëjti varietet rrushi.

Disa varietete rrushi, duke ekzistuar për një kohë të gjatë, kanë pasur mundësi të mjaftueshme për shumë mutacione gjenetike, duke rezultuar në zhvillimin e kloneve të shumta. Për shembull, Pinot Noir, numëron mbi 1000 klone, Merlot mbi 100 klone, Sangiovese mbi 200 klone, por megjithatë, jo të gjitha janë të disponueshme komercialisht ose lejohen të mbillen në të gjitha rajonet. Për shembull, Franca aktualisht lejon 47 klone Pinot Noir për përdorim komercial, për Merlotin 50, dhe nga Sangiovese janë 20-30 klone më të përdorshmit.

Në raste të rralla, mutacionet gjenetike rezultojnë në ndryshime kaq të rëndësishme saqë ato konsiderohen si një varietet krejtësisht i ri rrushi, edhe pse, në kuptimin e ngushtë të fjalës, ato janë klone të varietetit origjinal të rrushit. Raste të tilla ka me shumicë, p.sh Pinot Blanc dhe Pinot Gris janë shembuj të njohur të këtij fenomeni, duke pasur origjinën si mutacione gjenetike të Pinot Noir.

Një mënyrë tjetër e ndryshimit të cilësive të varieteteve është ajo që vjen nga shtimi me farë i hardhisë ose shtimit seksual. Riprodhimi seksual ndodh kur poleni nga një pjesë mashkullore e lules së një varieteti rrushi fekondon pjesën femërore të lules së një varieteti tjetër rrushi. Lulja e pjalmuar zhvillohet në një rrush me fara. Pjalmimi mund të ndodhë natyrshëm ose të induktohet në një mjedis të kontrolluar për të kryqëzuar dy varietete të zgjedhura. Nëse mbillen farat, do të gjenerohet një varietet i ri rrushi që është gjenetiksht i ndryshëm nga bimët e tij mëmë.

Varietetet e reja të rrushit që vijnë nga riprodhimi seksual quhen ose kryqëzime ose hibride, varësisht nga speciet e prindërve të tyre.

Kryqëzimet janë varietete të reja që vijnë nga fekondimi i kryqëzuar midis dy varieteteve të rrushit të të njëjtit lloj. Për shembull, Pinotage është një kryqëzim i Pinot Noir dhe Cinsault, ose Cabernet Sauvignon është një kryqëzim i Cabernet Franc dhe Sauvignon Blanc. Të gjitha bimët mëmë i përkasin specieve Vitis Vinifera.

Hibridet janë varietete të reja që vijnë nga fekondimi i kryqëzuar midis dy varieteteve të rrushit të specieve të ndryshme. Për shembull, Vidal Blanc është një hibrid i Ugni Blanc (Vitis Vinifera) dhe Rayon d'Or (një varietet hibrid që rezulton nga Seibel 405 dhe Seibel 2007 - Aramon du Gard).

Krijimi i një varieteti të ri rrushi përmes fekondimit të kryqëzuar për përdorim komercial është një proces i kushtueshëm dhe që kërkon kohë. Ai përfshin rritjen e shumë bimëve, pritjen që ato të japin fruta gjatë disa viteve dhe më pas monitorimin e tyre gjerësisht për të vlerësuar vlerën e tyre për përdorim komercial. Nëse konsiderohen të përshtatshme, këto varietete të reja regjistrohen në katalogun OIV si varietete të reja rrushi.

Edhe në Shqipëri është punuar për përzgjedhjen dhe seleksionimin e kloneve, sikurse janë krijuar varietete të reja nëpërmjet kryqëzimit seksual. Nëpërmjet seleksionimit të filluar që në vitin 1969 i drejtuar nga specialisti i mirënjohur Todi Gjermani, u veçua kloni i Kallmetit të përmirësuar, me të vilin u ndërtua një vresht ‘mëmë’ në të cilit furnizoheshin fidanishtet për prodhimin e fidanave pas vitit 1976.

Po kështu nga studimi 10-vjeçar (1980-1990) i kryer nga Instituti i Kërkimeve të Pemë Frutore dhe Vreshtave, IKPFV, për seleksionimin klonal të kultivarëve “Shesh i Zi”, “Shesh i Bardhë”, “Kallmet”, “Serinë e Zezë”, “Serinë e Bardhë”, “Vlosh”, “Pulëz”, “Cërruja”, “Rrush i Dhelprës”, “Debinë e Bardhë”, “Debina e Zezë”, “Tajka e Kuqe”, “Kumbullor” u veçuan klonet tipike me karaktere ampelografike dhe agronomike (Tabela ), që dallohen për prodhimtari të lartë, të qëndrueshme dhe me tregues teknologjike më të larta në krahasim me nivelin mesatar të popullatës (Volpa, 1990).

Tabela Numri i kloneve të përfituara nga seleksionimi klonal

| Nr | Popullata     | Klone | Nr | Popullata   | Klone |
|----|---------------|-------|----|-------------|-------|
| 1  | “Sheshi i Zi” | 30    | 9  | “Dimërak”   | 10    |
| 2  | “Pulës”       | 25    | 10 | “Mana kuqe” | 3     |

|   |                       |    |    |                  |    |
|---|-----------------------|----|----|------------------|----|
| 3 | "Debina e Leskovikut" | 14 | 11 | "Bishtdhelpre"   | 12 |
| 4 | "Debina e Përmetit"   | 12 | 12 | "Kryqëz"         | 6  |
| 5 | "Serina e Bardhë"     | 8  | 13 | "Cërruja"        | 3  |
| 6 | "Serina e Zezë"       | 6  | 14 | "Kumbullori"     | 8  |
| 7 | "Kallmet"             | 8  | 15 | "Tajka e Kuqe"   | 7  |
| 8 | "Vlosh"               | 11 | 16 | "Tajka e Bardhë" | 3  |

Njëkohësisht ka pasur programe përmirësimi të varieteteve nëpërmjet kryqëzimeve në rrugë seksuale, nga të cilat kryqëzimet intraspecifike në mes kultivarëve autoktonë të shquar "Kallmet i Zi", "Vlosh" dhe "Shesh i Zi", që i përkasin (proles pontica Negr.) dhe kultivarët e introduktuar "Cabernet Sauvignon", "Alikante Bouschet" (proles occidentalis Negr.), dhe "Saperavi" (proles pontica, subproles georgica Negr.) kanë dhënë rezultate të shkëlqera. (Sotiri, 1988). Si rezultat i këtyre kryqëzimeve, u veçuan 10 forma të reja, që karakterizohen me efekt të lartë të heterozës në drejtim të vlerave të larta prodhuese dhe kimike-teknologjike (kryqëzimet 3/4, 3/8, 10/6, 10/7, 26 AB, 9/19, 9/5 dhe 22/71). Për këtë program, punimet kanë vazhduar për një periudhë të gjatë kohore (1962-2018), fillimisht nga Universiteti Bujqësor dhe më pas në Institutin e Kërkimeve të Pemëtarisë dhe Vreshtarisë, Akademinë e Shkencave dhe Ekonominë e prodhimit të fidanëve FIDAL (Zejmen-Lezhë).

Nga variantet më të mira të përzgjedhur të kryqëzimeve, janë mbjellë me kohë në parcela me sipërfaqe të konsiderueshme hibridet:

"Kallmet x Al. Bouchet" 9/5; 9/19; 10/4. 10/6.

"Kallmet x Saperavi"  $\frac{3}{4}$ ; 3/8

"KallmetxCab.Sauvignon" 2/4

"Vlosh x Al. Bouchet" 23/75

"Cab.Sauvignon x Vlosh" 13/32

Në Shqipëri pas ndryshimit të sistemit dhe fragmentimit të tokës bujqësore, bashkë me të edhe të vreshtave, ndodhi shkallëtimi i shumë sipërfaqeve me vreshta dhe bashkë me të edhe i vreshtave të ndërtyara me klonet dhe hibridet e seleksionuara.

Ndarja e vreshtave ekzistuese bashkë me ndarjen e tokës, sipas Ligjit 7521, bëri që poseduesit e rinj vreshtave të mos kenë informacionin e duhur për varietetin/klonin që kishin në zotërim, një pjesë e të cilëve nga mungesa e njohurive.

Gjatë punës së bërë në terren për evidentimin e parcelave eksperimentale, grupi I punës ka hasur vështirësi në evidentimin dhe ndarjen saktë sa I takon kloneve të përgjedhura apo hibrideve. Pothuajse në të gjitha rastet fermerët që kishin në vreshtat e tyre hibride të Kallmetit, të përfutuara nga kryqëzimet, e njohnin si kallmet, duke e shitur edhe prodhimin tek kantinat si rrush të varietetit Kallmet, apo në rastin e hibridit të Vloshit, e njehsonin si Vlosh.

Kjo ka sjellë jo vetëm konfuzion në fermerët që kanë investuar në vreshtat e rinj, por edhe në krijimin e problemeve që shkaktohen nga prodhimi i markës së verës dhe marrjes së lejes së etiketave të verës nga disa kantina. Kantinat pretendojnë se kanë varietetet bazë, të njohura dhe të trashëguara nga zonat e origjinës së tyre, ndërkoh që në fakt vreshtat e ndërtuar dhe vera e prodhuar prej tyre janë nga hibridet e krijuara që në vetvete kanë tipare dhe karakteristika nga të dy prindërit nga të cilat janë krijuar, të cilat manifestohen në produktin final, në verën e tregtuar.

Detyra e studimit ishte evidentimi i kloneve dhe kandidatët e kloneve të varieteteve autoktone. Në kuptimin që përfaqëson termi 'klon', vreshtat e kultivuara, për shumë e shumë arsye që u përmendën më lartë, përfaqësojnë sot popullata të varieteteve, prandaj një projekt për seleksionimin e kloneve nga këto popullata është më se i nevojshëm për të ndihmuar sektorin, veçanërisht me investimet në vreshta të reja.

Procedurat që ndiqen për seleksionimin klonal janë tashmë të standartizuara. Hapi i parë është aprobimi i vreshtave me varietetin që do të veçohen klonet, i cilë duhet të bëhet dy javë para se të fillojë vjelja. Seleksionimi klonal bëhet me metodën e zgjedhjes në masë, me zgjedhjen individuale dhe me zgjedhjen dhe shtimin e variacioneve sythore.

Metoda e zgjedhjes në masë konsiston në zgjedhjen e hardhive më të mira (për prodhimtarinë, qëndrueshmërinë, cilësinë e dëshiruar etj) me qëllim që prej tyre të merren copa për shtim të mëtejshëm (nëpërmjet shtimit të drejtpërdrejtë). Kjo metodë bëhet zakonisht bashkë me aprobimin e vreshtit.

Metoda e zgjedhjes individuale konsiston në faktin se zgjedhja bëhet mbi hardhi të veçanta ku meren copa për shtim të mëtejshëm për ti provuar si kandidate për klone. Seleksionimi i variacioneve sythore konsiston në zgjedhjen e sythave më të mirë mbi hardhi të veçanta në kushte dhe agroteknikë të lartë. Si rregull metoda e zgjedhjes individuale dhe ajo e zgjedhjes së sythave, bëhet mbi bimët përfaqësuese të cilat e kanë kaluar testin e metodës së zgjedhjes në masë.

## 5.5.2 METODIKA PER EVIDENTIMIN E VRESHTAVE DHE KLONEVE

Në bazë të hartës së kadastrës së vreshtave dhe në bashkëpunim me kantinat e verës dhe vreshtarët me sipërfaqe të konsiderueshme, do të identifikohen vreshtat sipas kultivarëve ekzistues në terren. Për çdo varietet hardhie në studim, do të identifikohen vreshtat përfaqësuese që do të shërbejnë si vreshta udhëzues mbi të cilat do të bëhen sondazhet e duhura.

Një nga objektivat e studimit ishte identifikimi i strukturës varietore dhe fillimi i punës për identifikimin e kloneve të ndryshme të të njëjtit varietet, të prodhuara në zonat me vreshta me karakteristika homogjene në Shqipëri, duke përfunduar me rekomandime për vendosjen e kultivarëve të veçantë në zonat e tyre më të përshtatshme.

Në situatën dhe gjendjen që ndodhen sot varietete autoktone në vreshtat tona, e vetmja mënyrë për seleksionimin e kloneve është duke filluar me seleksionimin në masë. Metoda e ndjekur nga grupi i punës pikërisht këtë ka bërë në vreshta ekzistues për varietetet Cëruja, Debina e bardhë, Debina e zezë, Kallmeti, Pulës, Shesh i bardhë, Shesh i zi, Serinë e bardhë, Serin i zi dhe Vlosh.


Në vreshtat me këto varietete janë vendosur etiketa në bimët që dalloheshin si përfaqësuese më të mira të varietetit. Kjo nuk mund të quhet akoma seleksionim klonal me përzgjedhje individuale, pasi për të arritur deri tek individët më të mirë, duhet një periudhë seleksionimi tre deri në pesë vjet rresht në të njëjtin vresht, ku këto individë duhet të jenë vlerësuar pozitivisht, duke u bazuar në metodat vlerësuese fushore, laboratorike dhe metodash të tjera më të avancuara.

Vreshtat udhëzuese të identifikuara, kërkojnë etiketimin e bimëve të standardizuara, me të njëjtin numër çepash prodhimi, në mënyrë që të kishin një sipërfaqe gjethore mjaftueshëm homogjene dhe prodhim për hardhi, dhe ku janë marrë të dhëna për:

- kalimin e fazave fenologjike, për përcaktimin e kohës së çeljes së sythave, fillimit të lulëzimit, të lulëzimit, fillimit të pjekjes (veraisonit) dhe pjekjen e plotë;

- vlerësimin sipas metodikës (sipas protocollit CPVO• per përshkrimin e varieteteve) në lastarët e rinj, në lulëzim, gjethe sharmenda dhe fruta të karakteristikave ampelografike;
- analizat e duhura kimike në fruta në fillim të pjekjes, para vjeljes, dhe të mushtit pas vjeljes, duke evidentuar dhe ndryshimet kimike gjatë kinetikës së pjekjes (duke përfshirë fenolet për varietetet me kokrra të kuqe);
- në vjele, përcaktimi i kohës së vjeljes, të sasisë së prodhimit, numrit të bistakëve dhe numrit të lastarëve për hardhi.

Tabela 1 Metoda e përshkrimit të karaktereve për përshkrimin ampelografik

| KARAKTERISTIKAT AMPELOGRAFIKE (sipas protocollit CPVO• per përshkrimin e varieteteve)           |                  |                    |                               |                                                                                                              |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|--------------------|-------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KARAKTERI                                                                                       | NIVELI SHPREHJES |                    |                               | Foto                                                                                                         |
|                                                                                                 | Kodi             | Përshkrimi         | Varietetet referencë          |                                                                                                              |
| <b>CPVO 2 – Lastari i ri</b><br><br><b>: Forma e majes se lastarit</b>                          | 1                | E mbyllur          | Riparia Gloire de Montpellier | <b>Foto n.1</b><br><br>   |
|                                                                                                 | 2                | Pak e hapur        | 3309 Couderc                  |                                                                                                              |
|                                                                                                 | 3                | Gjysmë e hapur     | Kober 5 BB                    |                                                                                                              |
|                                                                                                 | 4                | E hapur            | Cina                          |                                                                                                              |
|                                                                                                 | 5                | Totalisht e hapur  | Pinot noir, Riesling          |                                                                                                              |
| <b>CPVO 6 – Lastari i ri:</b><br><br><b>Ngjyra e pjesës së sipërme të gjethes ( gjethja 4°)</b> | 1                | e verdhë e gjelbër | Furmint                       | <b>Foto n. 2</b><br><br> |
|                                                                                                 | 2                | e gjelbër          | Silvaner                      |                                                                                                              |
|                                                                                                 | 3                | jeshile me njolla  | Riesling                      |                                                                                                              |

|                                                                                                                                                         |   |                              |                     |                                                                                    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|------------------------------|---------------------|------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                                                                                                         |   | antociane                    |                     |  |
|                                                                                                                                                         |   | Ngjyrë bakri                 |                     |                                                                                    |
|                                                                                                                                                         | 4 | e qarte                      | Kober 5 BB          |                                                                                    |
|                                                                                                                                                         | 5 | Ngjyrë bakri<br>e erret      | Chasselas<br>blanc  |                                                                                    |
|                                                                                                                                                         | 6 | E kuqe vere                  | Deckrot             |                                                                                    |
| <b>CPVO 7 - Lastari i ri:<br/>dendësia e qimeve të buta<br/>midis nervaturave<br/>kryesore në sipërfaqen e<br/>poshtme të gjethes<br/>( gjethja 4°)</b> | 1 | mungon ose<br>shumë i rrallë | Rupestris<br>du Lot |                                                                                    |
|                                                                                                                                                         |   |                              | U                   |                                                                                    |


|  |   |                                                  |                             |                                                                                     |
|--|---|--------------------------------------------------|-----------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
|  | 2 | nga shumë i rrallë në të rrallë                  | Muskat i bardhë kokërrvogël |  |
|  |   | të rralla                                        |                             |                                                                                     |
|  | 3 | nga e rralla në mesatare                         |                             |                                                                                     |
|  | 4 | mesatare                                         | Merlot, Riesling            |                                                                                     |
|  |   | mesatare në të dendur                            |                             |                                                                                     |
|  | 5 |                                                  |                             |                                                                                     |
|  | 6 | të dendur                                        |                             |                                                                                     |
|  | 7 | nga e dendur në shumë e dendur<br>Shumë e dendur | Clairrette                  |                                                                                     |
|  | 8 |                                                  |                             |                                                                                     |
|  | 9 |                                                  | Meunier                     | <p><b>Foto n. 3</b></p>                                                             |

|                                   |   |                                                                    |                  |                                                                                     |
|-----------------------------------|---|--------------------------------------------------------------------|------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| CPVO 16 – Lulja: organet seksuale | 1 | thekët e zhvilluar plotësisht dhe mungesa e pistilit               | Rupestris du Lot |  |
|                                   | 2 | thekët e zhvilluara plotësisht dhe pistili i reduktuar             | 3309 Couderc     |                                                                                     |
|                                   | 3 | thekët plotësisht të zhvilluar dhe pistile plotësisht të zhvilluar | Chasselas blanc  |                                                                                     |
|                                   | 4 | thekët e refleksuara dhe pistilit i zhvilluar plotësisht           | Kober 5 BB,      |                                                                                     |

Foto n. 4

|                                            |   |                                   |                  |                                                                                       |
|--------------------------------------------|---|-----------------------------------|------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
| CPVO 20 – Gjethja e rritur: numri i lobeve | 1 | vetëm një                         | Rupestris du Lot |    |
|                                            | 2 | tre                               | Chenin blanc     |                                                                                       |
|                                            | 3 | pesë                              | Chasselas blanc  |                                                                                       |
|                                            | 4 | shtatë                            | Vermentino       |                                                                                       |
|                                            | 5 | më shumë se shtatë                | Hebron           |                                                                                       |
| CPVO 31 - Epoka e fillimit të pjekjes      | 1 | shumë e hershme                   | Perle de Csaba   |  |
|                                            | 2 | nga shumë e hershme në të hershme | Pinot noir       |                                                                                       |
|                                            | 3 | nga e hershme në mesatare         |                  |                                                                                       |
|                                            | 4 | mesatare                          |                  |                                                                                       |
|                                            | 5 | nga mesatare në të vonshme        | Riesling         |                                                                                       |
|                                            |   | e voshme                          |                  |                                                                                       |

|  |   |                                   |                |                                                                                     |
|--|---|-----------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
|  | 7 | nga e vonshme në shumë të vonshme |                |  |
|  | 8 | shumë të vonshme                  | Carignan       |                                                                                     |
|  | 9 |                                   | Olivette noire |                                                                                     |



### 5.5.3 VARIETETET KRYESORE VENDASE TE RRUSHIT

| EMRI I KULTIVARIT                                                                   | CËRRUJA                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|-------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>Sinonimi</b>                                                                     | Grezdë e bardhë                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>Emra të pavërtetë</b>                                                            | -                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <b>Origjina dhe shënime historike</b>                                               | e panjohur                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| <b>Përhapja dhe shpërndarja gjeografike</b>                                         | Mat, Librazhd, Mirditë, Pukë, Shkodër, Tropojë, Kukës                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Përshkrimi ampelografik</b>                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <i>Çelja e re :</i>                                                                 | Forma e majës e hapur, intensiteti i pigmentit antocianik në skajet e majës së rritjes: i pakët, dendësia e qimeve të shtrira (të gjata ) mbi majën e rritjes: mesatare. Dendësia e qimeve të drejta (të shkurtra) mbi nyje: të ralla. Dendësia e qimeve të drejta (të shkurtra) mbi ndëryje: të rallë |
| <i>Lozja</i>                                                                        | Shpërndarja mbi lastar: jo e vazhdueshme                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <i>Gjethja e pjekur</i>                                                             | Madhësia: mesatare, Forma: pesëkëndëshe, Numri i lobeve: pesë Forma e dhëmbëve: me brinjë konvekse Forma e gropëzës së bishtit: e hapur, Dendësia qimeve të shtrira midis nervaturave në anën e poshtme: të ralla, Dendësia qimeve të drejta midis nervaturave në anën e poshtme: të ralla.            |
| <i>Veshuli</i>                                                                      | Madhësia: mesatare. Gjatësia e bishtit: mesatare. Peshë mesatare e veshulit: e vogël.                                                                                                                                                                                                                  |
| <i>Kokrra</i>                                                                       | Madhësia: e vogël në mesatare, Forma: eliptike, Ngjyra e cipës: e gjelbër në të verdhë, Ngjyrimi i tulit: jo i ngjyrosur. Karakteristika të veçanta të shijes: speciale. Prania e farave: të pranishme.                                                                                                |
| <b>Karakteristika agronomike</b>                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <i>Kërkesa ambientale dhe kulturale</i>                                             | Si kultivar me pjekje mesatare- të vonshme, shkon mirë në zonën e ngrohtë dhe atë paramalore , me                                                                                                                                                                                                      |


|                                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                          | ekspozicion jugor ose lindor, ku grumbullon sasi të konsiderueshme sheqeri. Nuk rekomandohet kultivimi në zonat shumë të ftohta, apo në toka të rënda dhe shumë pjellore, sepse ul cilësitë e tij përpunuese. Kërkon kufizim të prodhimit, për rritjen e cilësisë së tij. Forma më e mirë e krasitjes është ajo në kordon "Roaja" ose "Gyjo". |
| <i>Ndjeshmëria ndaj patogjenëve biotikë dhe abiotikë</i> | I ndjeshëm sidomos ndaj patogjenëve biotikë (vrugut, hirit) e shumë i ndjeshëm ndaj kalbëzimit.                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>Karakteristika të mushtit</b>                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <i>Sheqeri</i>                                           | Në vartësi të ngarkesës në prodhim shkon nga 19 – 22%.                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <i>Aciditeti</i>                                         | 6.5 gr/litër.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <i>pH</i>                                                | 3.3                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <b>Karakteristika të verës</b>                           | Verë e bardhë, e lehtë, e balancuar me ngjyrë të gjelbër, me nuanca ari dhe kashte të hapur, adekuate për varietetin. Aromat janë të pastra por me intensitet mesatar, me nuanca pjeshkë dhe agrumesh. Shija është e pastër me intensitet dhe qëndrueshmëri mesatare, aciditet mesatar, e butë dhe e harmonizuar me freskie të plotë.         |
| <b>Përdorimi enologjik</b>                               | Për tavolinë, verë e lehtë, e freskët dhe e përshtatshme për qarkullim në treg me potencial në vjetërim                                                                                                                                                                                                                                       |
| <b>Vernat eventuale me përdorim gjeografik</b>           | Mundësi shumë e mirë për aplikimin e vernave të kontrolluara dhe të garantuara (D.O.C. dhe D.O.C.G.) në zonat e Matit, Pukës, Mirëditës, dhe Librazhdit.                                                                                                                                                                                      |

| EMRI I KULTIVARIT                                                                    | "SHESH I ZI" |
|--------------------------------------------------------------------------------------|--------------|
| Sinonimi                                                                             | -            |
| Emra të pavërtetë                                                                    | -            |
|  |              |

|                                                                                   |                   |                                                             |       |          |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------|-------|----------|
|  | Document<br>Name: | Raport: Percaktimi i Zonave te Prodhimit te Rushit per Vere | Page: | 5 of 160 |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------|-------|----------|

|                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|-----------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Origjina dhe shënime historike</b>   | Kultivar autokton, me origjinë nga zona Shesh (Ndreq-Tiranë)( Baki Dervishi – “ Vreshtaria e Sheshit” 2003).                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>Ndryshueshmëria ndërvarjetore</b>    | Është realizuar seleksionimi klonal, por aktualisht ndodhet vetëm në parcelën e parashumëzimit, pa mundur të shtohet.                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| <b>Sipërfaqja dhe shpërndarja</b>       | Kap rreth 35 % të sipërfaqes totale të vreshtave, rreth 2800 Ha, i shpërndarë kryesisht në zonën e Shqipërisë Qëndërore, bregdetare dhe të jugut                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>Përshkrimi ampelografik</b>          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <i>Çelja e re :</i>                     | Forma e majës e hapur, dëndësia e qimeve të holla në majë: e theksuar, qime të holla e të forta në nyje e ndërnyje: mungojnë ose janë shumë të pakta. Ngjyra e anës barkore dhe kurizore e lastarit :e gjelbër me nuanca të kuqe. Shpërndarja e llozeve në lastar: me shkëputje ( 2 ose më pak)                                                                                                                                |
| <i>Gjethja e pjekur</i>                 | Madhësia : e madhe, forma : pesëkëndëshe, numuri i lobeve : 5, ngjyra e anës së sipërme: e gjelbër, forma e dhëmbëve: të dy anët drejtvizore, forma e sinusit të bishtit: e hapur e shtrirë. Prezenca e qimeve të shtrira dhe të ashpra : mungon ose shumë të pakta, gjatësia e bishtit : e mesme (rreth 14 cm.)                                                                                                               |
| <i>Sharmenda :</i>                      | Seksioni tërthor i prerjes : eliptike, sipërfaqja: e brinjëzuar, ngjyra: e kuqe- kafe.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <i>Lulëria:</i>                         | Seksi i lules: Hermafrodite                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <i>Bistaku në pjekje :</i>              | Madhësia: mesatare, shkalla e ngjeshjes: mesatare-dëndur, gjatësia e bishtit: mesatar( rreth 7 cm.), drunjëzimi i bishtit : i mesëm                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <i>Kokrra në pjekje :</i>               | Madhësia: e mesme –vogël( 3-3.8 gr.), forma: e rumbullakët, seksioni tërthor: i rumbullakët, ngjyra e cipës: blu e zezë, konsistenca e tulit: mesatar-fortë, shënja e bishtit në kokër: lehtësisht e dallueshme, aroma: mungon, shkëputja nga bishti: mesatare, prania e farave: prezente(2.5 fara /kokër )                                                                                                                    |
| <b>Fenologjia</b>                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <i>Fillimi i çeljes së sythave</i>      | 3 prill- 5 prill                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <i>Lulëzimi</i>                         | 20 maj – 25 maj                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <i>Fillimi i larosjes se kokrave</i>    | 25-30.7                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <i>Pjekja</i>                           | 1 shtator – 15 shtator.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>Karakteristika agronomike</b>        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <i>Sjellja ndaj çeljes :</i>            | % e çeljes së sythave mesatarisht 67 %, me tendencë çelje të sythave të majës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <i>Fuqia :</i>                          | Mesatar-madhe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <i>Prodhimi për bimë</i>                | 5.9 kg.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <i>Pesha e bistakut :</i>               | 212 gram                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| <i>Pjelloria e sythave :</i>            | Koeficienti i prodhueshmërisë relative : 1.09, koeficienti i prodhueshmërisë absolute : 1.36. Ka potencial të lartë prodhues edhe nga sythat bazalë                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>Karakteristika të tjera</b>          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <i>Kërkesa ambientale dhe kulturale</i> | Si kultivar me pjekje mesatarisht të vonëshme, shkon mirë në zonën e ngrohtë , me ekspozicion jugor ose lindor, ku grumbullon sasi të konsiderueshme sheqeri. Nuk rekomandohet kultivimi në zonat e ftohta, apo në toka të rënda dhe shumë pjellore, sepse ul cilësitë e tij përpunuese. Kërkon kufizim të prodhimit, për rritjen e cilësisë së tij. Forma më e mirë e krasitjes ka rezultuar ajo në kordon “Roaja”ose “Gyjo”. |

|                                                          |                                                                                                                                                                            |
|----------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>Ndjeshmëria ndaj patogjenëve biotikë dhe abiotikë</i> | I ndjeshëm sidomos ndaj patogjenëve biotikë (vrugut, hirit) e shumë i ndjeshëm ndaj kalbëzimit. .                                                                          |
| <b>Karakteristika të mushtit</b>                         |                                                                                                                                                                            |
| <i>Sheqeri</i>                                           | Në vartësi të ngarkesës në prodhim shkon nga 19 – 23%.                                                                                                                     |
| <i>Aciditeti</i>                                         | 5.1 gr/litër.                                                                                                                                                              |
| <i>pH</i>                                                | 3.3                                                                                                                                                                        |
| <i>Përmbajtja totale e polifenoleve dhe antocianeve</i>  | Nuk ka të dhëna                                                                                                                                                            |
| <b>Karakteristika të verës</b>                           | Mesatare-rëndë, alkolike, pak acide, me buket të qëndrueshëm, me ngjyrë të kuqe jo intensive( cilësi inferiore).                                                           |
| <b>Përdorimi enologjik</b>                               | Për tavolinë, e përshtatëshme për kupazhim për përmirësimin e ngjyrës dhe buketit.                                                                                         |
| <b>Vernat eventuale me përdorim gjeografik</b>           | Megjithë kushtet e krijuara,për arësye të teknologjisë së ulët përpunuese, akoma nuk ka filluar prodhimi i vernave të kontrolluara dhe të garantuara (D.O.C. dhe D.O.C.G.) |

| EMRI I KULTIVARIT                                                                   | “SHESH I BARDHË”                                                                                                                          |
|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Sinonimi</b>                                                                     | -                                                                                                                                         |
| <b>Emra të pavërtetë</b>                                                            | -                                                                                                                                         |
|  |                                                                                                                                           |
| <b>Origjina dhe shënime historike</b>                                               | kultivar autokton, me origjinë nga zona Shesh (Ndroq-Tiranë)                                                                              |
| <b>Ndryshueshmëria ndërvarjetore</b>                                                | Është kryer seleksionimi klonal dhe është krijuar parcela e parashumëzimit.                                                               |
| <b>Sipërfaqja dhe shpërndarja</b>                                                   | Kap një sipërfaqe rreth 700 ha, duke u shpërndarë kryesisht në zonën e Tiranës, Durrësit, Kavajës, Lushnjë, Elbasan, Mat. Lezhë, Shkodër. |
| <b>Përshkrimi ampelografik</b>                                                      |                                                                                                                                           |

|                                                                                   |                |                                                             |       |          |
|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|----------|
|  | Document Name: | Raport: Percaktimi i Zonave te Prodhimit te Rushit per Vere | Page: | 7 of 160 |
|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|----------|

|                                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>Çelja e re :</i>                                      | Forma e majës: e hapur, prezenca e qimeve të holla në majë: mesatare, e qimeve të forta: mungon. Prezenca e qimeve të holla si dhe të forta në nyje e ndërnyje : mungon. Ngjyra e anës barkore të lastarit : e gjelbër me nuanca të kuqe. Shpërndarja e llozeve: me shkëputje( 2 ose më pak).                                     |
| <i>Gjethja e pjekur</i>                                  | Madhësia: e madhe, forma e llapës: 5 këndëshe, numuri i lobeve: 5,ngjyra e anës së sipërme: jeshile, forma e dhëmbëve: të dy anët drejtvizore. Forma e sinusit të bishtit: shumë e hapur. Prezenca e qimeve të ashpra ndërmjet nervaturave kryesore : mungon , prezencë e dobët e qimeve të holla.Gjatësia e bishtit: e shkurtër. |
| 7.3 | S3 Pershtatshmeri e Moderuar                                                   |       |          | 0       | 0.0%   |
| 8   | <b>VLERESIMI I ZONAVE HOMOGENE PER VRESHTARI (PAS PERJASHTIMEVE KUFIZUESE)</b> |       |          |         |        |
| 8.1 | Zone e papershtatshme (Kufizimet Lartesi,Pjerresi, Toke)                       |       |          | 177,813 | 71.4%  |
| 8.2 | Zone e pershtatshme per vreshtari                                              |       |          | 71,305  | 28.6%  |

### 6.3.8 QARKU DURRES

Qarku i Durrësit shtrihet në pjesën bregdetare dhe qëndrore të vendit, ku prezenca e detit influencon dukshëm në zbutjen e klimës, gjë që krijon kushte të favorshme për zhvillimin e të gjitha kulturave bujqësore, e në veçanti, të një numri mjaft të madh të kultivarëve të rrushit, nga ata me pjekje të hershme deri tek ata me pjekje të vonë.

Temperatura mesatare vjetore arrin nga 14-16oC, temperatura minimale 0-3oC dhe temperatura maksimale 35-38oC (në muajt korrik-gusht). Mesatarja vjetore e reshjeve luhetet midis 900–1 200 mm dhe janë të përqendruara në dimër (nëntor–shkurt).

Pjesa më e madhe e sipërfaqes së vreshtave shtrihet në Durrës (65.46 %) dhe Shijak (25.1%), nga ku sigurohet mbi 93% e prodhimit të përgjithshëm të rrushit. Rreth 85% e sipërfaqes është mbjellë me kultivarë për përpunim, si : Shesh i bardhë (17.07%), Shesh i zi (rreth 32.72 %), Merlot (23.25%), Caberne sauvignon (3.8%), Sangioveze(3.01%), Montepulciano (1.30%), etj, dhe rreth 15% është e mbjellë me kultivarë për konsum të freskët, si Italia, Matilde, Black Magic dhe Victoria.

Studimi krahasues i cilësisë së verërave të prodhuara nga kantinat e qarkut të Durrësit, treguan se zona ka potencial për diversifikimin e llojeve të verës nga shfrytëzimi i tokave të kategorive të

|                                                                                   |                |                                                             |       |           |
|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|
|  | Document Name: | Raport: Përcaktimi i Zonave të Prodimit të Rrushit për Verë | Page: | 42 of 160 |
|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|

ndryshme, me cilësi shumë të mira që i japin rrushit profil mineral dhe pjekje të mirë, por edhe nga varietetet e kultivuara krijohen profile të veçanta.

Kërkohen studime më të thelluara dhe të zgjatura në disa vite për të përcaktuar terroire vreshtare në qarkun e Durrësit ku kanë aktivitet të zhvilluar shumë kantina me nivel të teknologjisë dhe traditës së krijuar. Është mundësi e mirë për të përfituar nga aplikimi i skemave të cilësisë së Emërtimit e Origjinës së Mbrojtur – PDO, për Treguesit Gjeografikë të Mbrojtur – PGI dhe termat tradicionale. Sfidat e zhvillimit të vreshtarisë në zonat e ulëta dhe fushore të qarkut, lidhen me menaxhimin e vreshtave, i cili prodhon sasi, por kërkon menaxhim të ujit/lagështisë, të kurorave të vreshtave dhe parandalim të sëmundjeve. Krahas të tjerave, sfidat ekologjike për rrushin e varieteteve që piquen herët, por që në kalimin në tejpkje rrisin përqindjen e sheqerit, lidhen me sigurimin e fermentimit të plotë e të shëndetshëm. Rritja e përqindjes së sheqerit, në përgjithësi shoqërohet me uljen e aciditetit, i cili ka një rol shumë të rëndësishëm në fermentim dhe vjetërimin e verës, që në nivele të ulëta çon në një ulje të cilësisë së aromave.

| QARKU DURRES |                                                             |                |                |                |               |
|--------------|-------------------------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|---------------|
|              | PERSHKRIMI ELEMENTEVE                                       | Vlera Minimale | Vlera Maximale | Sipërfaqe (ha) | Sipërfaqe (%) |
|              | Sipërfaqe e Qarkut (ha)                                     |                |                | 77,572         |               |
| <b>1</b>     | <b>INDEKSI WINKLERIT</b><br><i>Gradë-ditë (GDD)</i>         |                |                |                |               |
| 1.1          | <i>Indeksi Winklerit (Vlerat °DD)</i>                       | 2,007.81       | 2,440.65       |                |               |
| <b>2</b>     | <b>KLASIFIKIMI NE RAJONE/Zona Winkler</b>                   |                |                |                |               |
| 2.1          | <i>Rajoni/Zona I</i>                                        |                |                | 0              | 0.0%          |
| 2.2          | <i>Rajoni/Zona II</i>                                       |                |                | 0              | 0.0%          |
| 2.3          | <i>Rajoni/Zona III</i>                                      |                |                | 0              | 0.0%          |
| 2.4          | <i>Rajoni/Zona IV</i>                                       |                |                | 21,931         | 28.3%         |
| 2.5          | <i>Rajoni/Zona V</i>                                        |                |                | 55,642         | 71.7%         |
| <b>3</b>     | <b>INDEKSI I NETEVE TE FTOHTA</b>                           |                |                |                |               |
| 3.1          | <i>Indeksi I neteve te ftohta (Vlerat °)</i>                | 14.04          | 17.80          |                |               |
| 3.2          | <i>CNI =&lt; 12°C</i>                                       |                |                | 0              | 0.00%         |
| 3.3          | <i>CNI =12–14°C</i>                                         |                |                | 0              | 0.00%         |
| 3.4          | <i>CNI = 14–18°C</i>                                        |                |                | 77,565         | 99.99%        |
| 3.5          | <i>CNI =&gt; 18°C</i>                                       |                |                | 7              | 0.01%         |
| <b>4</b>     | <b>KLASIFIKIMI EUROPIAN I ZONAVE VRESHTARE</b>              |                |                |                |               |
| 4.1          | <i>Zona Vreshtara A</i>                                     |                |                | 0              | 0.0%          |
| 4.2          | <i>Zona Vreshtara B</i>                                     |                |                | 0              | 0.0%          |
| 4.3          | <i>Zona Vreshtara CI</i>                                    |                |                | 0              | 0.0%          |
| 4.4          | <i>Zona Vreshtara CII</i>                                   |                |                | 21,938         | 28.3%         |
| 4.5          | <i>Zona Vreshtara CIII</i>                                  |                |                | 55,634         | 71.7%         |
| <b>5</b>     | <b>KRITERI PERJASHTUES PJERRESI (%)</b>                     |                |                |                |               |
| 5.1          | <i>i=0-20%</i>                                              |                |                | 53,973         | 69.58%        |
| 5.2          | <i>i=&gt;20%</i>                                            |                |                | 23,599         | 30.42%        |
| <b>6</b>     | <b>KRITERI PERJASHTUES LARTESIA MBI NIVELIN E DETIT (m)</b> |                |                |                |               |
| 6.1          | <i>Lartesia mbi nivelin e detit (m)</i>                     | 0.00           | 1,642.40       |                |               |
| 6.2          | <i>Lartesia mbi nivelin e detit ( 0-1000m)</i>              |                |                | 75,939         | 97.9%         |
| 6.3          | <i>Lartesia mbi nivelin e detit ( &gt;1000m)</i>            |                |                | 1,942          | 2.5%          |
| <b>7</b>     | <b>KATEGORIZIMI I TOKES</b>                                 |                |                |                |               |
| 7.1          | <i>S1 Shume I pershtatshem</i>                              |                |                | 77,357         | 99.7%         |

|     |                                                                                |  |  |        |       |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------|--|--|--------|-------|
| 7.2 | S2 I pershtatshem                                                              |  |  | 380    | 0.5%  |
| 7.3 | S3 Pershtatshmeri e Moderuar                                                   |  |  | 0      | 0.0%  |
| 8   | <b>VLERESIMI I ZONAVE HOMOGENE PER VRESHTARI (PAS PERJASHTIMEVE KUFIZUESE)</b> |  |  |        |       |
| 8.1 | Zone e papershtatshme (Kufizimet Lartesi, Pjerresi, Toke)                      |  |  | 23,599 | 30.4% |
| 8.2 | Zone e pershtatshme per vreshtari                                              |  |  | 53,973 | 69.6% |

### 6.3.9 QARKU TIRANE

Rajoni i Tiranës përfshin dy rrethe, Tiranën dhe Kavajën. Larmia e terrenit fushor e kodrinor, deri edhe malor, ka mundësuar zhvillimin e vreshtarisë në këtë qark. Nuk është e rastësishme që në këtë trevë të jetë prejardhja e varieteteve të Sheshit të bardhë e të Sheshit të zi, me përhapje masive në të gjithë vendin, por edhe e ekotipe të tjera më pak të përhapura.

Rrethi i Tiranës ka sipërfaqen më të madhe me vreshta, rreth 50.6%, ndërsa Kavaja ka rreth 23.1 % dhe Rrogozhina 26.22% të sipërfaqes totale. Varietetet kryesore janë Shesh i zi (44.69% ) dhe Shesh i bardhë (34.12 %), por edhe të huaj si Merlot (2.35 %), Kabërnët 2.12 %), etj. Rreth 13 % e sipërfaqes kultivohet me varietete për konsum të freskët.

Në Tiranë mbizotëron një klimë nëntropikale-mesdhetare me rreshje dimërore dhe me temperatura mesatare vjetore në korrik + 24° Celsius dhe në janar +7° Celsius. Në vit bie 950- 1289 mm shi, me shpërndarje kryesisht në dimër (nëntor–shkurt).

Studimi krahasues i cilësisë së verërave të prodhuara nga kantinat e qarkut të Tiranës, treguan se zona ka potencial për diversifikimin e llojeve të verës nga shfrytëzimi i tokave të kategorive të ndryshme, me cilësi shumë të mira që i japin rrushit profil dhe pjekje të mirë, por edhe nga varietetet e kultivuara krijohen profile të veçanta. Megjithatë kërkohet studim më i thelluar, duhet të vlerësohet nga grupet e interesit mundësia për të aplikuar në skemat e cilësisë së Emërtimeve të Origjinës së Mbrojtur – PDO për varietetet Shesh i Bardhë dhe Shesh i zi, por edhe për Treguesit Gjeografikë të Mbrojtur – PGI dhe termat tradicionale.

| QARKU TIRANE |                                              |                |                |                |               |
|--------------|----------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|---------------|
|              | PERSHKRIMI ELEMENTEVE                        | Vlera Minimale | Vlera Maximale | Siperfaqe (ha) | Siperfaqe (%) |
|              | Siperfaqe e Qarkut (ha)                      |                |                | 163,987        |               |
| 1            | <b>INDEKSI WINKLERIT</b><br>Gradë-ditë (GDD) |                |                |                |               |
| 1.1          | Indeksi Winklerit (Vlerat °DD)               | 1,336.86       | 2,629.75       |                |               |
| 2            | <b>KLASIFIKIMI NE RAJONE/Zona Winkler</b>    |                |                |                |               |
| 2.1          | Rajoni/Zona I                                |                |                | 5,048          | 3.1%          |
| 2.2          | Rajoni/Zona II                               |                |                | 12,169         | 7.4%          |
| 2.3          | Rajoni/Zona III                              |                |                | 21,879         | 13.3%         |
| 2.4          | Rajoni/Zona IV                               |                |                | 55,936         | 34.1%         |
| 2.5          | Rajoni/Zona V                                |                |                | 68,955         | 42.0%         |
| 3            | <b>INDEKSI I NETEVE TE FTOHTA</b>            |                |                |                |               |
| 3.1          | Indeksi I neteve te ftohta (Vlerat °)        | 11.42          | 18.10          |                |               |
| 3.2          | CNI =< 12°C                                  |                |                | 2,562          | 1.56%         |
| 3.3          | CNI =12–14°C                                 |                |                | 47,102         | 28.72%        |
| 3.4          | CNI = 14–18°C                                |                |                | 114,273        | 69.68%        |

|     |                                                                         |      |          |         |        |
|-----|-------------------------------------------------------------------------|------|----------|---------|--------|
| 3.5 | CNI => 18°C                                                             |      |          | 50      | 0.03%  |
| 4   | KLASIFIKIMI EUROPIAN I ZONAVE VRESHTARE                                 |      |          |         |        |
| 4.1 | Zona Vreshtara A                                                        |      |          | 5,048   | 3.1%   |
| 4.2 | Zona Vreshtara B                                                        |      |          | 17,810  | 10.9%  |
| 4.3 | Zona Vreshtara C I                                                      |      |          | 25,593  | 15.6%  |
| 4.4 | Zona Vreshtara C II                                                     |      |          | 64,357  | 39.2%  |
| 4.5 | Zona Vreshtara C III                                                    |      |          | 51,179  | 31.2%  |
| 5   | KRITERI PERJASHTUES PJERRESI (%)                                        |      |          |         |        |
| 5.1 | i=0-20%                                                                 |      |          | 80,939  | 49.36% |
| 5.2 | i=>20%                                                                  |      |          | 83,048  | 50.64% |
| 6   | KRITERI PERJASHTUES LARTESIA MBI NIVELIN E DETIT (m)                    |      |          |         |        |
| 6.1 | Lartesia mbi nivelin e detit (m)                                        | 0.00 | 1,821.42 |         |        |
| 6.2 | Lartesia mbi nivelin e detit ( 0-1000m)                                 |      |          | 145,045 | 88.4%  |
| 6.3 | Lartesia mbi nivelin e detit ( >1000m)                                  |      |          | 19,102  | 11.6%  |
| 7   | KATEGORIZIMI I TOKES                                                    |      |          |         |        |
| 7.1 | S1 Shume I pershtatshem                                                 |      |          | 155,926 | 95.1%  |
| 7.2 | S2 I pershtatshem                                                       |      |          | 8,138   | 5.0%   |
| 7.3 | S3 Pershtatshmeri e Moderuar                                            |      |          | 0       | 0.0%   |
| 8   | VLERESIMI I ZONAVE HOMOGENE PER VRESHTARI (PAS PERJASHTIMEVE KUFIZUESE) |      |          |         |        |
| 8.1 | Zone e papershtatshme (Kufizimet Lartesi,Pjerresi, Toke)                |      |          | 83,048  | 50.6%  |
| 8.2 | Zone e pershtatshme per vreshtari                                       |      |          | 80,939  | 49.4%  |

### 6.3.10 QARKU LEZHE

Prefektura e Lezhës shtrihet në zonën veri-perëndimore dhe qendrore të Shqipërisë dhe kufizohet në veri nga rrethi i Shkodrës dhe i Pukës, në lindje nga rrethi i Kukësit dhe Dibrës, në jug kufizohet me rrethin e Matit dhe në perëndim me detin Adriatik.

Temperatura mesatare vjetore varion nga 14-15°C, ndërsa shuma e temperaturave aktive arrin nga 3500-4000°C, me një amplitudë nga 35-36°C gjatë muajve korrik – gusht, deri në minus 4-5°C në muajit janar-shkurt.

Rrethi i Lezhës ka rreth 34.66% të sipërfaqes totale të mbjellë me vreshta, Mirdita rreth 28.0 % dhe Kurbini rreth 37.3 %.

Studimi krahasues i cilësisë së verërave të prodhuara nga kantinat e qarkut të Lezhës, treguan se zona ka potencial për të prodhuar vërëra me cilësi shumë të lartë, që konkurojnë në tregun global, veçanërisht me varietetin Kallmet. Kjo duhet shfrytëzuar për të aplikuar në skemat e cilësisë së Emërtimet e Origjinës së Mbrojtur – PDO, por grupet e interesit të këtij qarku kanë shumë mundësi të aplikojë edhe për Treguesit Gjeografikë të Mbrojtur – PGI dhe termat tradicionale

| QARKU LEZHE |                                       |                |                |                |               |
|-------------|---------------------------------------|----------------|----------------|----------------|---------------|
|             | PERSHKRIMI ELEMENTEVE                 | Vlera Minimale | Vlera Maximale | Siperfaqe (ha) | Siperfaqe (%) |
|             | Siperfaqe e Qarkut (ha)               |                |                | 163,074        |               |
| 1           | INDEKSI WINKLERIT<br>Gradë-ditë (GDD) |                |                |                |               |
| 1.1         | Indeksi Winklerit (Vlerat °DD)        | 1,342.97       | 2,585.28       |                |               |
| 2           | KLASIFIKIMI NE RAJONE/Zona Winkler    |                |                |                |               |

|     |                                                                                |      |          |         |        |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------|------|----------|---------|--------|
| 2.1 | Rajoni/Zona I                                                                  |      |          | 1,751   | 1.1%   |
| 2.2 | Rajoni/Zona II                                                                 |      |          | 70,703  | 43.4%  |
| 2.3 | Rajoni/Zona III                                                                |      |          | 21,106  | 12.9%  |
| 2.4 | Rajoni/Zona IV                                                                 |      |          | 33,218  | 20.4%  |
| 2.5 | Rajoni/Zona V                                                                  |      |          | 36,295  | 22.3%  |
| 3   | <b>INDEKSI I NETEVE TE FTOHTA</b>                                              |      |          |         |        |
| 3.1 | Indeksi I neteve te ftohta (Vlerat °)                                          | 4.98 | 18.21    |         |        |
| 3.2 | CNI =< 12°C                                                                    |      |          | 84,862  | 52.04% |
| 3.3 | CNI =12–14°C                                                                   |      |          | 26,516  | 16.26% |
| 3.4 | CNI = 14–18°C                                                                  |      |          | 50,374  | 30.89% |
| 3.5 | CNI => 18°C                                                                    |      |          | 1,322   | 0.81%  |
| 4   | <b>KLASIFIKIMI EUROPIAN I ZONAVE VRESHTARE</b>                                 |      |          |         |        |
| 4.1 | Zona Vreshtara A                                                               |      |          | 67,215  | 41.2%  |
| 4.2 | Zona Vreshtara B                                                               |      |          | 27,371  | 16.8%  |
| 4.3 | Zona Vreshtara CI                                                              |      |          | 16,791  | 10.3%  |
| 4.4 | Zona Vreshtara CII                                                             |      |          | 15,401  | 9.4%   |
| 4.5 | Zona Vreshtara CIII                                                            |      |          | 36,295  | 22.3%  |
| 5   | <b>KRITERI PERJASHTUES PJERRESI (%)</b>                                        |      |          |         |        |
| 5.1 | i=0-20%                                                                        |      |          | 68,797  | 42.19% |
| 5.2 | i=>20%                                                                         |      |          | 94,277  | 57.81% |
| 6   | <b>KRITERI PERJASHTUES LARTESIA MBI NIVELIN E DETIT (m)</b>                    |      |          |         |        |
| 6.1 | Lartesia mbi nivelin e detit (m)                                               | 0.00 | 1,952.88 |         |        |
| 6.2 | Lartesia mbi nivelin e detit ( 0-1000m)                                        |      |          | 144,679 | 88.7%  |
| 6.3 | Lartesia mbi nivelin e detit ( >1000m)                                         |      |          | 18,557  | 11.4%  |
| 7   | <b>KATEGORIZIMI I TOKES</b>                                                    |      |          |         |        |
| 7.1 | S1 Shume I pershtatshem                                                        |      |          | 159,467 | 97.8%  |
| 7.2 | S2 I pershtatshem                                                              |      |          | 3,793   | 2.3%   |
| 7.3 | S3 Pershtatshmeri e Moderuar                                                   |      |          | 0       | 0.0%   |
| 8   | <b>VLERESIMI I ZONAVE HOMOGENE PER VRESHTARI (PAS PERJASHTIMEVE KUFIZUESE)</b> |      |          |         |        |
| 8.1 | Zone e papershtatshme (Kufizimet Lartesi,Pjerresi, Toke)                       |      |          | 94,277  | 57.8%  |
| 8.2 | Zone e pershtatshme per vreshtari                                              |      |          | 68,797  | 42.2%  |

### 6.3.11 QARKU SHKODER

Qarku i Shkodrës kufizohet në veri me Malin e Zi, në lindje me rrethin e Tropojës dhe Kukësit, në jug me rrethet Lezhë dhe Mirditë dhe në perëndim me detin Adriatik.

Shkodra ka një klimë mesdhetare, dimër i butë e të lagësht, verë e nxehtë e e thatë. Temperaturat mesatare në vit variojnë nga 14,5 °C deri në 16,8 °C. Temperatura në Janar është nga 1,9 °C deri në 9 °C. Është një nga zonat më të lagështa të Shqipërisë, me një mesatare rreth 2000 mm shi në vit, megjithatë vera është e thatë, zakonisht.

Malësia e Madhe, me qendër Koplikun, ka sipërfaqen më të madhe me vreshta, ka rreth 39.5 % e sipërfaqes totale, Shkodra ka 33.22 % , Vau i Dejës 24.52 % dhe Puka (me klimë tipike malore) ka rreth 2 %.

|                                                                                   |                |                                                             |       |           |
|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|
|  | Document Name: | Raport: Percaktimi i Zonave te Prodhimit te Rushit per Vere | Page: | 46 of 160 |
|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|

Varietetet kryesore ne shkllë qarku janë Sheshi i zi (20.08 %), Merlot (15.55 %), Kallmet (14.9 %), Shesh i bardhë (14.2 %), Vranac (12.5 %), Hibridet nga kryqëzimi i Kallmetit (5.3 %), Caberne sauvignon (1.1%), etj.

Studimi krahasues i cilësisë së verërave të prodhuara nga kantinat e qarkut të Shkodrës, treguan se zona ka potencial për diversifikimin e llojeve të verës nga shfrytëzimi i tokave të kategorive të ndryshme, me cilësi shumë të mira që i japin rrushit profil dhe pjekje të mirë, Megjithëse kërkohet studim më i thelluar, duhet të vlerësohet nga grupet e interesit mundësia për të aplikuar në skemat e cilësisë së Emërtimeve të Origjinës së Mbrojtur – PDO për varietetin Kallmet, por edhe klone të tij dhe Hibridet e prodhuara nga kryqëzimi i tij me Alikante Bouschet, Saperavi dhe Caberne Sauvignon. Qarku ka shumë mundësi të aplikojë edhe për Treguesit Gjeografikë të Mbrojtur – PGI dhe termat tradicionale.

| QARKU SHKODER |                                                             |                |                |                |               |
|---------------|-------------------------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|---------------|
|               | PERSHKRIMI ELEMENTEVE                                       | Vlera Minimale | Vlera Maximale | Siperfaqe (ha) | Siperfaqe (%) |
|               | Siperfaqe e Qarkut (ha)                                     |                |                | 352,505        |               |
| <b>1</b>      | <b>INDEKSI WINKLERIT</b><br><i>Gradë-ditë (GDD)</i>         |                |                |                |               |
| 1.1           | <i>Indeksi Winklerit (Vlerat °DD)</i>                       | 920.94         | 2,591.10       |                |               |
| <b>2</b>      | <b>KLASIFIKIMI NE RAJONE/Zona Winkler</b>                   |                |                |                |               |
| 2.1           | <i>Rajoni/Zona I</i>                                        |                |                | 27,078         | 7.7%          |
| 2.2           | <i>Rajoni/Zona II</i>                                       |                |                | 128,481        | 36.4%         |
| 2.3           | <i>Rajoni/Zona III</i>                                      |                |                | 60,091         | 17.0%         |
| 2.4           | <i>Rajoni/Zona IV</i>                                       |                |                | 61,357         | 17.4%         |
| 2.5           | <i>Rajoni/Zona V</i>                                        |                |                | 75,498         | 21.4%         |
| <b>3</b>      | <b>INDEKSI I NETEVE TE FTOHTA</b>                           |                |                |                |               |
| 3.1           | <i>Indeksi I neteve te ftohta (Vlerat °)</i>                | 9.28           | 18.12          |                |               |
| 3.2           | <i>CNI =&lt; 12°C</i>                                       |                |                | 116,889        | 33.16%        |
| 3.3           | <i>CNI =12–14°C</i>                                         |                |                | 106,059        | 30.09%        |
| 3.4           | <i>CNI = 14–18°C</i>                                        |                |                | 129,066        | 36.61%        |
| 3.5           | <i>CNI =&gt; 18°C</i>                                       |                |                | 490            | 0.14%         |
| <b>4</b>      | <b>KLASIFIKIMI EUROPIAN I ZONAVE VRESHTARE</b>              |                |                |                |               |
| 4.1           | <i>Zona Vreshtara A</i>                                     |                |                | 114,207        | 32.4%         |
| 4.2           | <i>Zona Vreshtara B</i>                                     |                |                | 96,300         | 27.3%         |
| 4.3           | <i>Zona Vreshtara CI</i>                                    |                |                | 19,026         | 5.4%          |
| 4.4           | <i>Zona Vreshtara CII</i>                                   |                |                | 47,474         | 13.5%         |
| 4.5           | <i>Zona Vreshtara CIII</i>                                  |                |                | 75,498         | 21.4%         |
| <b>5</b>      | <b>KRITERI PERJASHTUES PJERRESI (%)</b>                     |                |                |                |               |
| 5.1           | <i>i=0-20%</i>                                              |                |                | 121,621        | 34.50%        |
| 5.2           | <i>i=&gt;20%</i>                                            |                |                | 230,884        | 65.50%        |
| <b>6</b>      | <b>KRITERI PERJASHTUES LARTESIA MBI NIVELIN E DETIT (m)</b> |                |                |                |               |
| 6.1           | <i>Lartesia mbi nivelin e detit (m)</i>                     | 0.00           | 2,455.08       |                |               |
| 6.2           | <i>Lartesia mbi nivelin e detit ( 0-1000m)</i>              |                |                | 254,754        | 72.3%         |
| 6.3           | <i>Lartesia mbi nivelin e detit ( &gt;1000m)</i>            |                |                | 98,675         | 28.0%         |
| <b>7</b>      | <b>KATEGORIZIMI I TOKES</b>                                 |                |                |                |               |
| 7.1           | <i>S1 Shume I pershtatshem</i>                              |                |                | 218,554        | 62.0%         |
| 7.2           | <i>S2 I pershtatshem</i>                                    |                |                | 134,433        | 38.1%         |
| 7.3           | <i>S3 Pershtatshmeri e Moderuar</i>                         |                |                | 0              | 0.0%          |

|            |                                                                                 |  |  |         |       |
|------------|---------------------------------------------------------------------------------|--|--|---------|-------|
| <b>8</b>   | <b>VLERESIMI I ZONAVE HOMOGJENE PER VRESHTARI (PAS PERJASHTIMEVE KUFIZUESE)</b> |  |  |         |       |
| <b>8.1</b> | <i>Zone e papershtatshme (Kufizimet Lartesi, Pjerresi, Toke)</i>                |  |  | 230,884 | 65.5% |
| <b>8.2</b> | <i>Zone e pershtatshme per vreshtari</i>                                        |  |  | 121,621 | 34.5% |

### 6.3.12 QARKU KUKES

Tokat e qarkut të Kukësit shtrihen në pjesën veriore dhe verilindore të Shqipërisë. Nga ana klimatike, bëjnë pjesë në nënzonat mesdhetare malore veriore dhe lindore. Janë zonat më të ftohta të vendit ku bien reshje të shumta në formën e shiut dhe borës. Temperatura mesatare vjetore për pjesën e ulët varion nga 7-11°C, ndërsa për pjesët e larta nga 4-6°C (Korabi, Jezerca, etj).

Temperatura mesatare në muajin më të ftohtë të vitit është: në zonat e ulëta nga 0-2°C, ndërsa në pjesë të larta shkon nga -7 deri në -8°C.

Rreth 54% e sipërfaqes me vreshta ndodhet në territorin e rrethit të Kukësit, 27.58% në rrethin e Hasit dhe 18.39 % në rrethin e Tropojës. Varietetet kryesore janë Shesh i zi (rreth 32.79 %), Merlot (17.32%), Shesh i bardhë (11.7%), Vranac (6.74 %), Prokupac (2.49 %) Riesling (1.84 %) etj.

Përpunimi i rrushit në këto zona është akoma në nivel artizanal duke prodhuar verë artizanale në kushte ferme dhe raki, por mundësitë që krijon klima dhe toka duhet të shfrytëzohen në të ardhmen për të zhvilluar sektorin e prodhimit të verës cilësore dhe zhvillimin e zonave rurale në këtë qark.

| QARKU KUKES |                                                     |                |                |                |               |
|-------------|-----------------------------------------------------|----------------|----------------|----------------|---------------|
|             | PERSHKRIMI ELEMENTEVE                               | Vlera Minimale | Vlera Maximale | Siperfaqe (ha) | Siperfaqe (%) |
|             | <b>Siperfaqe e Qarkut (ha)</b>                      |                |                | 240,173        |               |
| <b>1</b>    | <b>INDEKSI WINKLERIT</b><br><i>Gradë-ditë (GDD)</i> |                |                |                |               |
| <b>1.1</b>  | <i>Indeksi Winklerit (Vlerat °DD)</i>               | 1,253.86       | 1,927.87       |                |               |
| <b>2</b>    | <b>KLASIFIKIMI NE RAJONE/Zona Winkler</b>           |                |                |                |               |
| <b>2.1</b>  | <i>Rajoni/Zona I</i>                                |                |                | 3,853          | 1.6%          |
| <b>2.2</b>  | <i>Rajoni/Zona II</i>                               |                |                | 91,698         | 38.2%         |
| <b>2.3</b>  | <i>Rajoni/Zona III</i>                              |                |                | 144,622        | 60.2%         |
| <b>2.4</b>  | <i>Rajoni/Zona IV</i>                               |                |                | 0              | 0.0%          |
| <b>2.5</b>  | <i>Rajoni/Zona V</i>                                |                |                | 0              | 0.0%          |
| <b>3</b>    | <b>INDEKSI I NETEVE TE FTOHTA</b>                   |                |                |                |               |
| <b>3.1</b>  | <i>Indeksi I neteve te ftohta (Vlerat °)</i>        | 9.76           | 13.52          |                |               |
| <b>3.2</b>  | <i>CNI =&lt; 12°C</i>                               |                |                | 105,630        | 43.98%        |
| <b>3.3</b>  | <i>CNI =12–14°C</i>                                 |                |                | 134,542        | 56.02%        |
| <b>3.4</b>  | <i>CNI = 14–18°C</i>                                |                |                | 0              | 0.00%         |
| <b>3.5</b>  | <i>CNI =&gt; 18°C</i>                               |                |                | 0              | 0.00%         |
| <b>4</b>    | <b>KLASIFIKIMI EUROPIAN I ZONAVE VRESHTARE</b>      |                |                |                |               |
| <b>4.1</b>  | <i>Zona Vreshtara A</i>                             |                |                | 61,301         | 25.5%         |
| <b>4.2</b>  | <i>Zona Vreshtara B</i>                             |                |                | 178,872        | 74.5%         |
| <b>4.3</b>  | <i>Zona Vreshtara CI</i>                            |                |                | 0              | 0.0%          |
| <b>4.4</b>  | <i>Zona Vreshtara CII</i>                           |                |                | 0              | 0.0%          |
| <b>4.5</b>  | <i>Zona Vreshtara CIII</i>                          |                |                | 0              | 0.0%          |
| <b>5</b>    | <b>KRITERI PERJASHTUES PJERRESI (%)</b>             |                |                |                |               |

|     |                                                                                |        |          |         |        |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------|--------|----------|---------|--------|
| 5.1 | <i>i=0-20%</i>                                                                 |        |          | 59,889  | 24.94% |
| 5.2 | <i>i=&gt;20%</i>                                                               |        |          | 180,283 | 75.06% |
| 6   | <b>KRITERI PERJASHTUES LARTESIA MBI NIVELIN E DETIT (m)</b>                    |        |          |         |        |
| 6.1 | <i>Lartesia mbi nivelin e detit (m)</i>                                        | 174.36 | 2,473.59 |         |        |
| 6.2 | <i>Lartesia mbi nivelin e detit ( 0-1000m)</i>                                 |        |          | 132,945 | 55.4%  |
| 6.3 | <i>Lartesia mbi nivelin e detit ( &gt;1000m)</i>                               |        |          | 107,875 | 44.9%  |
| 7   | <b>KATEGORIZIMI I TOKES</b>                                                    |        |          |         |        |
| 7.1 | <i>S1 Shume I pershtatshem</i>                                                 |        |          | 176,190 | 73.4%  |
| 7.2 | <i>S2 I pershtatshem</i>                                                       |        |          | 64,310  | 26.8%  |
| 7.3 | <i>S3 Pershtatshmeri e Moderuar</i>                                            |        |          | 0       | 0.0%   |
| 8   | <b>VLERESIMI I ZONAVE HOMOGENE PER VRESHTARI (PAS PERJASHTIMEVE KUFIZUESE)</b> |        |          |         |        |
| 8.1 | <i>Zone e papershtatshme (Kufizimet Lartesi,Pjerresi, Toke)</i>                |        |          | 180,283 | 75.1%  |
| 8.2 | <i>Zone e pershtatshme per vreshtari</i>                                       |        |          | 59,889  | 24.9%  |

## 7. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

### 7.1 PERFUNDIME

Studimi mbi përshtatshmërinë klimatike, pedologjike dhe topografike për kultivimin e vreshtave në territorin e Republikës së Shqipërisë tregon qartë se vendi ka një potencial të lartë për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të verës, me kushte natyrore të favorshme dhe një trashëgimi të pasur varietore. Rezultatet e analizave tregojnë këto konkluzione kryesore:

#### Përshtatshmëria klimatike

- Shumica e zonave të ulëta dhe kodrinore të Shqipërisë (me lartësi <600 m) klasifikohen në rajonet klimatike III–IV sipas indeksit të Winkler (WI-GDD), të cilat janë optimale për kultivimin e varieteteve të rrushit për verë.
- Zonat bregdetare dhe kodrat e buta të Shqipërisë së Mesme dhe Jugut shfaqin kushte shumë të përshtatshme për kultivarët me pjekje të hershme dhe të mesme.
- Indeksi i netëve të ftohta (CI) tregon një bilanc të mirë midis freskisë dhe pjekjes së rrushit, i cili favorizon aromat dhe aciditetin e ekuilibruar në verëra.

#### Përshtatshmëria e tokës

- Tokat aluviale dhe ato me teksturë të ekuilibruar (L, SiCL, CL), pH 6.7–7.3 dhe konduktivitet elektrik <2 dS/m përbëjnë kategorinë më të përshtatshme për vreshtari (klasa S1–S2).
- Toka të cekëta, shumë argjilore apo me drenazh të dobët klasifikohen si më pak të përshtatshme (S3–N), por mund të përmirësohen me masa agroteknike si shtimi i lëndës organike dhe drenazhimi artificial.
- Shumë parcela ekzistuese të vreshtarisë ndodhen në zona që përputhen me klasat S1–S2, çka vërteton përputhshmërinë e rezultateve me realitetin prodhues.

### Përshtatshmëria topografike

- Pjerrësitë midis 5–15% janë ideale për cilësi të lartë të rrushit për verë. Zonat me pjerrësi >20% paraqesin kufizime për mekanizimin dhe për këtë arsye janë përjashtuar nga zonat e rekomanduara për mbjellje të reja.
- Orientimi jugor dhe jugperëndimor favorizon ekspozimin ndaj rrezatimit diellor dhe përmirëson pjekjen e fenolëve dhe aromave në rrush.

### Zonat homogjene të përshtatshme

- Përmes analizave multi-kriteriale (MCE/AHP) janë identifikuar zona homogjene me kushte të përshtatshme për kultivimin e varieteteve autoktone si Kallmet, Sheshi i Zi, Sheshi i Bardhë, Vlosh, Serina dhe Debina.
- Këto zona përkojnë me rajonet tradicionale të prodhimit të verërave cilësore: Shkodra–Lezha, Tirana–Durrësi–Kavaja, Berati–Skrapari, Përmeti dhe Fushë-Kruja.

### Rëndësia strategjike

- Hartimi i këtij studimi përbën hapin e parë për krijimin e një Atlasi Kombëtar të Vreshtarisë, i cili do të mundësojë klasifikimin zyrtar të zonave të prodhimit të rrushit për verë, sipas kërkesave të Ligjit nr. 86/2022 dhe standardeve të BE-së (PGI/PDO).
- Krijimi i bazës shkencore për zonimin do të mbështesë përfshirjen e verërave shqiptare në sistemet e cilësisë evropiane dhe do të përmirësojë imazhin e sektorit në tregjet ndërkombëtare.

## 7.2 REKOMANDIME

Në vijim të rezultateve të studimit dhe analizës së potencialeve natyrore, rekomandohen këto masa strategjike dhe institucionale:

### Hartimi i Atlasit Kombëtar të Vreshtarisë

- Të institucionalizohet procesi i hartimit të Atlasit Kombëtar të Zonave të Vreshtarisë me bazë GIS, që do të përfshijë klasifikimin klimatik, pedologjik dhe topografik për çdo rajon prodhimi.
- Ky atlas të bëhet pjesë e referencave zyrtare për investimet bujqësore, përfshirë aplikimet për PGI/PDO dhe planifikimet e mbjelljeve të reja.

### Përfshirja e verërave shqiptare në skemat e BE-së (PGI/PDO)

- Të krijohet një grup pune ndërinstitutional (MBZHR, AZHBR, QTTB, AKVMB) për identifikimin dhe regjistrimin e zonave që plotësojnë kriteret për Treguesit Gjeografikë të Mbrojtur dhe Emërtimet e Origjinës së Mbrojtur.
- Të përgatitet dokumentacioni teknik sipas kërkesave të BE-së për regjistrimin e verërave shqiptare në skemat e cilësisë.

### Mbështetja e varieteteve autoktone

|                                                                                   |                   |                                                             |       |           |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|
|  | Document<br>Name: | Raport: Percaktimi i Zonave te Prodhimit te Rushit per Vere | Page: | 50 of 160 |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------|-------|-----------|

- Të hartohet një program kombëtar për konservimin dhe certifikimin e varieteteve autoktone të rrushit, duke përfshirë identifikimin e kloneve, koleksione referencash dhe banka gjenetike.
- Institucionet kërkimore (QTTB, Universitetet bujqësore) të angazhohen në karakterizimin morfologjik dhe enologjik sipas protokolleve OIV.

### **Standardizimi i të dhënave dhe krijimi i bazës digjitale**

- Të ngrihet një baza kombëtare e të dhënave klimatiko-pedologjike dhe topografike për vreshtari, e cila do të përditësohet periodikisht dhe do të jetë e aksesueshme për institucionet publike dhe prodhuesit.
- Të përdoret kjo bazë për hartimin e politikave të zhvillimit rural, menaxhimin e investimeve dhe studimet e impaktit mjedisor.

### **Planifikimi i mbjelljeve të reja**

- Investimet në mbjellje të reja të orientohet sipas hartës së përshtatshmërisë, duke shmangur zonat me pjerrësi të theksuar, drenazh të dobët ose tokë shumë alkaline.
- Të promovohen skema mbështetëse që favorizojnë mbjelljen e varieteteve vendase në zonat e tyre tradicionale, për të ruajtur autenticitetin dhe cilësinë e verërave.

### **Trajnime dhe mbështetje teknike**

- Të zhvillohen programe trajnimi për fermerët dhe teknologët e verës mbi praktikat e menaxhimit të vreshtave sipas kushteve klimatiko-pedologjike të zonës.
- Të integrohen shërbimet e këshillimit bujqësor me rezultatet e këtij studimi për të ofruar udhëzime të personalizuara për çdo rajon.

### **Integrimi me politikat e zhvillimit rural**

Rekomandohet që rezultatet e këtij studimi të përdoren si bazë për planifikimet territoriale dhe strategjitë e zhvillimit rural, veçanërisht në programet IPARD dhe në projektet e diversifikimit ekonomik të zonave rurale.

Të sigurohet koordinim ndërmjet institucioneve përgjegjëse për bujqësinë, mjedisin dhe turizmin për të zhvilluar turizmin enologjik dhe agroturizmin në zonat me potencial të lartë vreshtar.

## **7.3 KONKLuzion I PERGjITHSHEM**

Ky studim përbën një bazë të fortë shkencore dhe praktike për orientimin e politikave kombëtare në fushën e vreshtarisë dhe verës.

Zbatimi i rekomandimeve të mësipërme do të mundësojë:

- zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit,
- mbrojtjen e trashëgimisë varietore shqiptare,
- rritjen e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së verërave,
- si dhe integrimin e plotë të Shqipërisë në tregun evropian të verës.